



Nexhmedin Ramadani, prof. * Ismet Lecaj, prof.

NË KËRKIM TË ZOGJVE



Nexhmedin Ramadani, prof.
Ismet Lecaj, prof.

NË KËRKIM TË ZOGJËVE



Autor i fotove dhe karakteristikave të zogjëve: **Nexhmedin Ramadani, prof.**
Autor i poezive: **Ismet Lecaj, prof.**

Redaktorë: **Dr. sc. Ilir Morina**
Recensent: **Mr.sc. Qenan Maxhuni,**

Bashkëpunëtorë OJQ "Finch":

Myzafer Arifi, Enver Arifi, Zenel Asllani, Arsim Xhejlani, Rafet Elezi, Bekim Bytyqi, Azem Ramadani, Alban Arifi, Daut Sinani, Nehat Zyberi, Besim Demiri, Syri Ramadani
AUK & ECDL Kosova.

Bashkëpunëtorë të jashtëm:

Volker Maurhofer, Stefan Shindler, Bo Fogerstrom, Hans Groen

Literatura:

Birds of the World nga Colin Harrison dhe Alan Greensmith
Bird Guide nga: Killian Mullarney, Lars Svensson, Dan Zetterstrom dhe Peter J. Grant

Fotografitë:

OJQ "Finch", miqt nga Web. Flickr: Ahmet Karataş, Ruslou Koorts, Christiana Port, Azem Ramadani, John & Fish, Rivertay, Lynngerald, Hearman, Dave Appleton, Jose Viana, Prairiedog, Doug Lloyd, Charles Lam, Ricmcarthur, Sergey Yeliseev, Namq, Sparcyfaisca, Julio Coldas, Shaban1, etj

Realizimi kompjuterik dhe kopertina:

Ibrahim Tolaj

U shtyp në shtypshkronjën: **Design House.**

I nderuari lexues,



Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës ka vendosur të mbështes botimin e publikimit “Në kërkim të zogjve” të autorëve Nexhmedin Ramadani dhe Ismet Lecaj, për faktin se e vlerëson këtë si një kontribut shumë të rëndësishëm në mbrojtjen dhe njohjen e zogjve të Kosovës.

Zogjtë janë tregues të rëndësishëm të cilësisë së mjedisit të një vendi prandaj informacionet dhe njohurit për përhapjen e tyre janë të nevojshme për të gjithë. Po ashtu mbrojtja e natyrës dhe e biodiversitetit është e lidhur ngushtë me ruajtjen e zogjve. Direktiva e Zogjve është një nga shtyllat kryesore të legjislacionit të Bashkimit Evropian për biodiversitetin andaj për

të zbatuar atë në mënyrë efektive ne kemi nevojë për informacione sa i përket llojeve të zogjëve.

Ky botim përveç faktit që i ofron këto informata për shumicën e zogjve të egër të Kosovës, bëhet edhe më atraktiv sepse për këto lloje ofron edhe fotografi origjinale të zogjve shumica të fotografuar në mjediset e tyre nga vetë autori. Të gjitha këto, gërshetohen mjeshtërisht edhe me poezi që i kushtohen zogjve gjë që e bënë librin të pëlqyer dhe të lehtë për tu kuptuar jo vetëm nga të rriturit por edhe nga fëmijët.

Me këtë rast shpreh falënderimin tim për kontributin dhe punën e palodhshme të Organizatës Joqeveritare “Finch” të udhëhequr nga Nexhmedin Ramadani, në mbrojtjen e zogjve dhe promovimin e vlerave të tyre në shoqërinë tonë. Duke i inkurajuar që të vazhdojnë edhe më tutje aktivitetet e tyre, Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës shpreh gatishmërinë për bashkëpunim me këtë organizatë dhe për mbështetje edhe në ndonjë aktivitet tjetër të kësaj natyre.

Vetëm duke njohur zogjtë, duke mbrojtur ata dhe duke promovuar vlerat e tyre ne tregojmë vlerat e shoqërisë sonë dhe shprehim përkushtimin në rrugën e integritimeve evropiane.

Dr.sc. Ilir Morina,
Kryeshef Ekzekutiv i AMMK-së

Parathënie

Ide e kahmotshme ka qenë që edhe ne kosovarët, madje edhe shqiptarët në përgjithësi të kenë një libër udhëzues për zogjtë e lirë në natyrë. Ky udhëzues mund të quhet libër tredimensional, që nënkuptojmë: poezinë për secilin zog, fotografinë dhe karakteristikat e tij. Poezitë janë thurur nga profesori dhe poeti i njohur Ismet Lecaj, ndërsa dy pjesë tjera janë përmbushur nga OJQ "FINCH".

Të zëvendësosh një mangësi, do të thotë të kontribuosh në një lëmi që tanimë ka qenë e mangët.

Besojmë se zogjtë dhe të gjitha kafshët tjera e pasurojnë jetën tonë dhe të gjitha ato janë shenjë e një mjedisi të shëndoshë. Me përkrahjen e më shumë se 100 dashamirëve, Shoqata "FINCH" mbron dhe përkujdeset për zogjtë e egër; gjithashtu kjo organizatë kujdeset edhe për natyrën dhe vendet ku jetojnë ata.

Për të pasur ndikim më të madh, ne duhet të fokusohemi në llojet më prioritare, vendbanimet e vendqendrimet dhe gjithashtu duhet qartësuar qëllimet dhe aktivitetet. Organizata FINCH punon në bashkëpunim me shumë individë dhe organizata të ndryshme, si në Kosovë ashtu edhe jashtë saj. Kështu është duke arritur suksese të reja dhe efektive. Për të vepruar në mënyrë efikase, organizata FINCH-I angazhohet për të krijuar një klimë të shëndoshë dhe të preferuar për mbarë publikun në përgjithësi. Si organizatë jo qeveritare ajo po mundohet të mbledhë fonde për aktivitetet e saja. Anëtarët e saj po inkurajohen që të sillen në mënyrë pozitive për mbarëvajtjen e aktiviteteve të saja, përmes aksioneve dhe përkrahjeve vullnetare.

FINCHI nuk i kundërvihet progresit material, por ai beson se përparimi duhet të jetë i mbështetur dhe të arrihet përmes përkujdesjes së mbarë të burimeve natyrore. Forcat tona mbështeten në qëllime të qarta, të liruara nga besnikëritë partiake; ato mbështeten edhe në përkrahjen e gjerë të shoqërisë, në atë teknike dhe profesionale. FINCH-i dëshiron të arrijë rezultate më të mira për përkujdesjen e kafshëve përmes diskutimeve dhe marrëveshjeve të përgjithshme.

Bëjmë fushatë për mbrojtjen e zogjve dhe mjedisit në përgjithësi duke rregulluar dhe menaxhuar vendbanimet e zogjeve dhe kafshëve tjera. Gjurmojmë problemet me të cilat përballen zogjtë dhe mjedisi. Mundohemi të bashkëpunojmë me organizatat tjera në nivel Evropian dhe atë botëror. Mundohemi t'i ndihmojmë të gjithë për t'u kënaqur me botën e gjallë dhe të mësojnë më shumë për të. Të jemi sa më aktiv rreth e qark Kosovës si nga aspekti lokal, kombëtar, regjional dhe global – puna e jonë ruan mjedisin e juaj. Puna jonë përcillet nga një besim i pasionuar i antarëve të sajë ku të gjithë e ndiejmë përgjegjësinë për t'i mbrojtur zogjtë dhe mjedisin dhe

mundohemi që këtë përgjegjësi ta përcjellim edhe tek të tjerët. Popullata e zogjve reflekton shëndetin e planetit, në të cilin varet e ardhmja jonë.

Nevoja për t'i mbrojtur zogjtë asnjëherë nuk ka qenë më e madhe. Ndryshimi i klimës, zhvillimi i bujqësisë, zgjerimi i sipërfaqeve urbane dhe infrastrukturat transportuese, gjithashtu edhe tej- eksploatimi i gurëve, shkëmbinjve dhe rërës se lumenjve, të gjitha këto shkaktojnë kërcënim të madh për zogjtë në përgjithësi.

Organizata FINCH nuk do të mund të ekzistonte pa përkrahjen dhe ndihmën e organizatave qeveritare dhe joqeveritare, madje edhe nga anëtarësia e saj. Përkrahja juaj është vitale për të ardhmen e zogjve, e gjithashtu edhe për vendet ku jetojnë ata. Me këtë rast shpreh falënderim të veçantë për Agjencionin e Kosovës për Mbrojtjen e Mjedisit i cili çdoherë mundohet që të na përkrahë aktivitetet tona në mënyrë solide. Përkrahja e këtij botimi është një ndihmesë e madhe prandaj shpresoj që ky lloj bashkëpunimi të vazhdoj edhe në të ardhmën.



Në kërkim të zogjve

Udhëtimi mbi Zaplluxhe

Arave, shkrepave e nëpër lugje,
Në shpatie e nëpër rriba,
Atje n'Limth përmbi Zaplluxhe
Arrin Nexha bashkë me nipa.

Ky është ai fshati ku ti u rrite,
Ku bëre lojërat gjysh n' fëmijëri,
Thoshe shumë miq prite e qite,
Ish' me kanun t'u bëje sajgi?!

Kishim shumë dhenë në tufën tonë,
Plot Qen të Sharrit me gjithë bari,
Qengjat blegërinin shpatit gjithmonë
Kur veç i ruaja me shokë të mi.

Dasmat me sehër bënim atëherë,
Kishim shumë tokë e pasuri,
N'kërcim trehapësh dimër as verë
Kush s'ia kalonte gjyshit Haki.

Vocat buzëqeshen dhe kishin mall
Për kohë të shkuar, gjene të veta,
Kërkonin zogjë që kurrë s'i kanë
parë,
Mos janë diku n'lisa me fleta.



Familja DIOMEDEIDAE,
Lloji *Diomedea exulans*,
ALBATROSS,
ALBATROSI,

gjatësia 135cm, gjinitë e ngajshme,
shtegëtar.

Është shpendi më i madh i detit,
i gjatë 135cm (krahëhapur 3,5 m).
Forma dhe madhësia e krahëve ia
mundësojnë albatrosit të fluturojë
në ajër për një kohë të gjatë.
Zbret në tokë vetëm në kohën
e riprodhimit dhe shquhet për
formimin e çerdheve në ujëdhese.
Është i përhapur në hemisferën
jugore të planetit tonë.

Albatrosi

Rri në qiell e nuk zbret,
Me krahë t' shkathët shkon mbi det,
Vetëm peshq kur sheh Zgalemi,
Mbi ta vrik zbret sqepkalemi.

Albatros o këmbëlopatë,
Sqepverdhë e krahgjatë,
Merr turr nga veriu i ftohtë,
T'bëjë konak në jug të ngrohtë!

Këtu ku eshtrat i nxen dielli,
Këtu i kaltër ku është qielli,
Këtu ku ndez katër motorët,
Ku numëron dhe vizitorët.

Zbrit pusho o Albatros,
Det i pastër s'ka makrosë,
Mbi kala zbret në Ulqin,
S'bashku kafe që të pimë.

Ziebardhi Albatros
Sa kohë zgjat i yti kros?
Kjo rrugë jotja maratonë
Të gjithë zogjve ua shkon.

Veç kur do të lëshojë zoçka,
Zbret në tokë Albatros loçka,
Ndërton çerdhen në ujëdhese,
Ku s'ka zhurmë e mbushet mbresa.

Albatroska e zonja e shpisë
Sa mirë çerdhen e qëndis,
Burrë e grua shtyhen n'gara,
Ta bëjnë çerdhen mjalt me arra.

Paj dëgjo o Albatros,
Edhe deti po u bë kos,
S'do të ketë një lugë për ty,
Ndaç me ha me ata sy!



Babili i rërës

Rendin zonjat shalakaten,
Ikin rëndë si dallëndyshe,
Prit Babil se hallakaten,
Atëherë lehtë e ke përndryshe.

Rendin rërës me ngadalë,
I bëjnë çerdhet në Breg t'Rozit,
Ato besa kanë të ngjarë
Resht si vrima t'mitralozit.

I përhituri Babil rëre
Popo t'shoh si lule vere,
Argjend dukesh kur shkon qiellit.

Rend Babil të pres pranë dere,
Ik dhe lulen prapa merre,
Argjend dukesh n'rreze t'diellit.

Familja HIRUNDINIDAE,
Lloji *Riparia riparia* ,
SAND MARTIN,
BABILI I RËRËS (Dallëndyshja e lumit),
gjatësia 12cm, gjinitë e ngajshme, shtegëtar.

Dallëndyshe e vogël, babili i rërës gjuan insekte përgjatë lumenjëve, dhe liqeneve. Fole e një filxhani e thurur dhe e ndërtuar nga materialet e bimëve dhe puplave në një zgavër të një bregu lumi ose shkëmbi. Është e përhapur në Amerikën Veriore dhe Euroazi. Dimrat i kalon në Amerikën e Jugut, Afrikë, Amerikën e Veriut, Indi dhe Azinë Jug-Lindore. Te ne e gjejmë në rrjedhat e lumejve dhe vende tjera shkëmbore.



Familja HIRUNDINIDAE,
Lloji *Ptyonoprogne rupestris*,
CRAG MARTIN,
BABILI I SKËRKËS,
gjatësia 14-15cm, gjinia e ngjajshme,
shtegëtar i distancave të shkurtëra.

Shumohet nëpër zgavra të sipërfaqeve të shkëmbijëve, rrallë herë nëpër zgavra të shtëpive dhe ndërtesave, mund ta gjejmë madje edhe mbi 2000m lartësi mbidetare. Tek ne e hasim nëpër gryka të lumejve.

Babili i skërkës (I kepit)

Bah, çerdhen e rregullon me baltë
Ashtu siç bëjnë dallëndyshet,
Bre-bre e zbukuron si me daltë,
I zë qoshet si ato bishtdyshtet.

Luan mbi skërkë si shqiponjë,
Ikën qiellit atje mbi mal,
Ikën shpejt Babila zonjë
Se do zbret mbi det ngadalë.

Krahu yt argjend i shkrirë,
Është i bukur anë e mbanë,
Rend te zoçkat moj e mirë!

Krahë të tyre qëndrojnë shtrirë,
Është se duan diçka t'hanë,
S'është vështirë për ty Babilë.

Bajza

Dukesh sikur Pulë e detit
Kur shkon udhës n'gjueti,
I çon fjalë Bajzan mbretit:
Ku të kam Bajloz i zi?!

Këto sonete ku i gjete-
Do të thoshte pastaj ai,
Këtij tenori borgj i mbete
Për cicërrimat n'dashuri.

Edhe ty me pendën futë
N'ballë pudrosur me një balë,
Të çonë fjalë dashnor i urtë:
Hajt se shihemi n'det me valë!

Me zogj tjerë atje përvjet
Bëni plazh e shtrenjta mike,
Hipur n'Mjellma shkoni qetë
Si n'anijet titanike.

Me shikime merreni vesh
Dhe me zemra t'marra n'zjarr,
Të lypë ty moj baroneshë
Me ndërgjegjen qelibar.

Shumë magjepës sharmi yt,
Me sy t'kuqë si fjongo n'kokë,
Mjegull ia bën zotëriut sytë,
Të humbë torruan përmbi tokë.

Si kutia muzikore
E kurdisur mori Bajzë,
Do i belbëzosh dorë për dorë
Notat tua t'shkrira n'gaz.

Në mes lumi me shkopinj
Bëni çerdhen ku do kotesh,
Po u rrit niveli t'zinj,
Mos do keni vërshim lotësh!!!

Ndaj si të shkokërdhuar
Do të dilni n'breg pastaj,
S'mbetet gjë për t'u numëruar,
Shkoi i vdekuri me një vaj!

Ndezur do rrinë shandanët
Për të vegjlit që u treten,
Do ndiheni më ligështanët
Nënë e babë që pa ta mbetet!



Familja PHASIANIDAE,

Lloji *Fulica atra*,

COOT,

BAJZA,

gjatësia 36-42cm, gjinia e ngjajshme, shtegëtar i distancave të shkurtëra.

Shumohen në liqene dhe lumenjë të ngadaltë, me bimësi të bollshme, por edhe fusha të hapura të ujit.

Dimërojnë shumë në brigjet veriore, të tjerët shtegëtojnë në Evropën Perëndimore, kopetë e mëdha gjat dimrit i hasim në disa rezervuare britanike dhe irlandeze. Tek ne e hasim në akumulimet e Hence afer aeroportit të Prishtinës, liqenet tjera artificiale dhe në rrjedhen e lumit Dri. Foleja përbëhet prej një grumbulli të xunkthave të vdekur buzë shtretërve me kallamishte, shpesh është mjaft e dukshme. Mbron territorin në mënyrë të ashpër, u vërsulet armiqve duke notuar vrullshëm.



Familja TURDIDAE,
Lloji *Luscinia megarhynchos*,
NIGHTINGALE,
BILBILI

gjatësia 16.5cm, gjinia e ngjajshme,
shtegëtar.

Është zog shtegëtar, i cili këndon më së bukuri ndër shpendë. Ka trup të vogël (17cm), me ngjyrë hiri në të artë nga ana shpinore, ndërsa në anën barkore i verdhë në të bardhë. Penda bishtore është e gjerë. Çerdhen e ndërton në mesin e bimëve. Femra bën 5-6 vezë, të cilat i ngroh për 14 ditë. Shtegëton në shtator drejt Afrikës dhe kthehet nga mesi i prillit. Kënga e tij dëgjohet anë e kënd Kosovës.

Bilbilit

Unë t'i di synimet e kësaj kënge,
mik,
M'hallakate n'vorbullën e
mbresave t'mia,
Kjo simfoni nga ky zë simpatik
Nuk m'jep udhë të shkoj te shpia.

Artisti i madh është më i plagosuri,
Kot xhelozinë ta tjerrin hollë,
Ky zëri yt është më i përsosuri,
S'di në oktava kush ta zë n' shköllë.

Bukur në degë ia merr pa brenga,
Unë t'fokusoj n'foto të mia,
Sa mirë e ëmbël mik të delë kënga,
Fare s'qan kokën pse vjen pleqëria?!

Këta dy niposha, këta dy bineq
Që për çdo ditë kaq shumë
t'dëgjuan,
T'ndahen nga ti sa u vjen keq,
Si vashë salloni këngën ta duan!

Ah arti yt pasqyrë e jetës
Nga fund i zemrës del n'sipërfaqe,
Gjithmonë ia vë vulën t'vërtetës,
Mërzinë e kthen lot nëpër faqe.

Komunikimi mollë e kafshuar,
Kot që e thonë për mua dhe ty,
Është lloj kontrasti që do gjurmuar
Dhe pse na hedhin hi nëpër sy.

Pranverës vetulla ia vë ylberin,
Me notat tua botën e ndez,
Vetëm kur shkon mua të mjerin,
Më lë në thinja dimër që pres.

Sot flas me ty si n'poezi
O dirigjent i korit në përrua,
Ti dhe pse ikën vjen përsëri,
Kjo nuk vazhdon edhe për mua!

Bilbili mëllenjë

Bilbil, si do zbresësh në solfezhe,
I thua Mëllenjës ty të bashkohet,
Lëri ato llafe se përfundon n'korteze,
Bah, thuaj shkurt të mos alarmohet.

I kam n'kopshtin tim fëmijët me llastik,
Luhaten n'kolovajzë e janë dhe
rojtarë,
Ata me guraleca vrasin çdo armik,
Ti merrja shtruar të më çohet mall!

Medet Bilbil mëllenjë çfarë të t'them
sot,
Ë-ja bjer në gjunj për ato nota,
Llafe sa më pak e këngën derdhe
n'shporta.

E sheh se fëmijët të dalin zot,
Një Gent i vogël që vrojton te porta,
Arianit i thotë-Këngën s'e merr morta!



Familja TURDIDAE,
Lloji *Luscinia luscinia*,
THRUSH NIGHTINGALE,
BILBILI MËLLENJË,
gjatësia 16.5cm, gjinia e ngajshme,
shtegëtar.

Bilbili i Veriut dhe Lindjes, e zëvendëson pak zërin e kënaqshëm të bilbilit të vërtetë të Europes perëndimore dhe asaj jugore. Shumohet në pyje të freskëta dhe të shpeshë, shpesh e ndërton folenë në shkurret e lajthisë madje edhe nëpër shkurre të parqeve dhe kopshteve. Vizitor veror i vëndeve tona, dimror në Afrikë. Endet nëpër Kosovë: prill-qershor-gusht dhe tetor.



Familja **ALCEDINIDAE**,

Lloji *Alcedo atthis*,

KINGFISHER,

BILBILI UJIT,

gjatësia 17-19cm, gjinia e ngjajshme,
pjesërisht shtegëtar.

Është shpend i vogël i rendit të sqepbollëve, me pendla ngjyrë të mbyllët në të kaltër në anën shpinore, ndërsa në anën barkore ka ngjyrë të kuqe. Ka kokë të madhe, sqep të gjatë me skaje të mprehta për kapjen e peshqve. Jeton dhe ushqehet pranë ujit. Peshkun e vogel e pret në një degë të thatë dhe kur ai t'i afrohet sipërfaqes së ujit, ky i fundit me një fluturim të rrembyeshëm a kap ate me sqepin e mprehtë. Femra bën 6-7 vezë, të cilat i ngroh për 18-21 ditë. Jeton në tërë Evropën Veriore. Në vendin tonë e hasim gjatë rrjedhes së lumenjve dhe liqeneve akumuluese.

Bilbili i ujit (Martini peshkatar)

Kush ia thotë me çifteli
Kaq ëmbël, kaq shumë,
Në ujë peshqit bëjnë çudi,
Dalin t'shohin përmbi lumë.

Ja në sqep viktimë e parë,
Spektatori që gaboï,
Mirë t'përcjellë me bisht n'kitarë,
Disi tekstin e harroi!

Bilbil uji kështu ndër mote,
Të tjerët i mashtron?
Karrem qenka kënga jote,
Mbi ato dega kur përgjon!

O kokëmadh me pendën blu,
Që ia thua në kupë të qiellit,
Kuzhinjer pa rrymë e dru
I pjek peshqit n'rreze t'diellit.

Për atë që zuri n'thua,
Sot e hëngre me dëshirë,
Një nderim s'ma bëre mua
Që në varg ta poqa mirë.

Dhe një ditë do vij me ty
O Martini peshkatar,
Me kamerë të mbaj në sy,
T'shoh si gjuhet pa zagarë.

Bishtlëkundësi laraman

Bukuri e rrallë para syve të mi,
I ke ato lara nëpër kokë e gushë,
Shoh si një përparëse lidhur te një fëmijë,
Të mbërthyer n'gjoks kur kullot në
fushë,

Lëre ore lëre por kur rri mbi gur
Është se ti kërcen dy metra përpjetë,
Krahët mirë i shtrin shqipe në flamur,
Uh se ç'rituale çuditet bota vetë.

Nëse s'vjen i dashuri me kë do
hidhëroresh,
Duhet t'i durosh ndonjëherë surprizat,
Ë-ja me dy pikat n'qerpik do lirohet,
Sa kanë bukuri këngët dhe reprizat.

Ikën atje n'dega ta fillosh folenë,
Lëre edhe burrin pakëz të t'ndihmojë,
Ani mori ani mos ta merre dhenë,
Rëndë e mat ti botën me atë bishtpeshojë.

Ashtu bukur thure një çerdhe komode,
Medet pesë të vegjlit mamanë kur e
thërrasin,
Ah moj natyrë sa shumë paske kode,
Ndërtove këtë botë në derë të t'trokasin!



Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Motacilla alba*,
WHITE/PIED WAGTAIL,
BISHT LËKUNDËSI LARAMAN,
gjatësia 17.5cm, gjinia e ndryshme,
pjesërisht shtegëtar.

Ky zog jeton në hapësira të gjëra afër dhe pranë ujit, ushqehet me insekte dhe shpesh e ndërton folenë afër ndërtesave. Folenë në formë filxhani e formëson në zgavër. Është i përhapur në Europë, Afrikë, Azi, Alaskë. Tek ne e hasim përgjatë rrjedhave të lumenjëve dhe liqeneve akumuluese.



Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Motacilla cinerea*,
GREY WAGTAIL,
BISHT LËKUNDËSI I PËRHIMT
gjatësia 19cm, gjinia e ndryshme,
pjesërisht shtegëtar.

Identifikohet me shpinë dhe kokë të përhitur, ky bishtlëkundës shpesh shihet në rrjedhat e lumit duke gjuajtur insekte dhe krustace. Është e dukshme sjellja e tij e bukur me thirrje të njëpasnjëshme. Shihet dhe shumohet edhe në rrjedhat e lumejve brënda për brënda vendbanimeve. Foleja në formë filxhani e ndërtuar nga myshku dhe gjethet e vendosur në zgavra apo në parvaze afër rrjedhës së ujit. Është i përhapur në Europë, Afrikë, Azi. Disa nga popullacioni shtegtojnë në jug.

Bishtlëkundësi i përhitur në rrezik

Bishtlëkundësi i përhirtë
I ra fushës anë e mbanë,
Shtruar shkoi i vogli shpirt
Te një lis gjeti mamanë.

Lëre mami, mëzi shpëtova,
Ëhë si vepronte një Petrit,
Këq disi u ngatërrova,
Ububu kur m'doli n'priti!

Ndër ca degë i dhashë një lak,
Doli ai në anën tjetër,
Është se unë ika për pak,
Si më mësove taktikë t'vjetër!

Iha zemra si më rrah,
I shpëtova sot rrezikut,
Medet mami t'shkojmë dikah,
I zi ish' sqep i armikut!

Përpak mami e qetësoi,
Ë-ja rridhte si një lumë,
Rëndë voglushi sot e pësoi
Hallakatur, lodhur shumë.

Ikën bashkë n'atë vapë korriku,
Renden hijeve n'Lisa t'Vokrrit:
Tani dije ç'është armiku,
Është n'peshojë jeta e t'voglit!

Bishtlëkundësi i verdhë

Bre-bre ç'zogë verdhashe shëtit,
I ka hije ta lëkundë atë bisht,
Shtroja këngës ashtu ditë për ditë,
Ta di mirë kush s'ta bënë me gisht.

Lart në dega si dardha verore
Është se ngjyra tepër më pëlqen,
Kujdes këngën nga Sokoli prore,
Ulet ai e me thonj t'rrëmbenë.

Në livadhe si një zonjë lëviz,
Deri të hasësh në ndonjë kërcell,
Është se sqepi yt si murriz
S'e do lojën shpejt në gojë e merr.

Ike shpejt deri atje n'çerdhe,
Të vegjlit tu të presin gojëhapur,
E shko me radhë magazinë derdhe,
Veç ata rritën nënë për ta kapur.

E të bëhen djem, të bëhen edhe çika,
Rend e merrja në pemë edhe sot,
Dhe rrëmbyesit me radhë t'i rrokë pika,
Ë-ja e vrerosur të derdhë vetëm lot.



Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Motacilla flava*,
YELLOW WAGTAIL,
BISHT LËKUNDËSI I VERDHË,
gjatësia 16.5cm, gjinia e ndryshme,
shtegëtar.

Mjeshter i spikatur gjatë procesit të shumimit në habitatet e tyre, livadhe dhe kullosa. Ky zog duket shumë aktiv kur i ushqen të vegjëlit e tij në tokë, duke i rrembyer pakurrizorët. Folenë e thurur e formëson në zgavër. Shumohet në Euroazi. Dimrat i kalon në pjesën jugore të hemisferës. Puplat e mashkullit dallohen dhe ndryshojnë gjatë shpërndarjes - kokat janë të zeza, të bardhë, blu, apo të verdhë, varësisht nga nënloji. Bishtin e gjatë e lëkund për ta mbajtur barazpeshën gjatë vrapit në kërkim të ushqimit.



Familja CORVIDAE,
Lloji *Nocifraga caryocatactes*,
NUTCRACKER,
BOCËTHYESI, gjatësia 32-35cm,
gjinia e njejtë, pjesërisht shtegëtar.

Shumohen pothuajse ekskluzivisht në zonat me qasje më të lehtë për të gjetur bredhin e pyllit, për ta ngritur folene shtruar dhe për t'i ushqyer të vegjlit dhe kështu për të grumbulluar edhe sa më shumë boca që t'i kenë sa më afër për zahire të dimrit. Arrat dhe farat i mbledhin nëpër sipërfaqe të tokës dhe kështu i deponojnë ato në vënde ku nuk i harrojnë lehtë se ku ndodhen ato gjatë acarit të dimrit, madje shumë shpesh mund të identifikojnë ato edhe sikur të jenë nën borë. Në vëndin tonë i hasim në lartësi mbidetare mbi 1000m në ato pyje ku ka pisha më së shumti. Zakonisht janë shumë të qetë dhe jo të zhurmshëm, por gjatë procesit të çiftimit e lëshojnë një zë si 'krrrrrreh'.

Bocëthyesi

Bocëthyesë më mahnit boçat si i
then,
Obobo si me qysqi a si me qytë,
Cucë laroshe vallë ç'rrëfën,
Ëmbëlsirë zanati yt!

Thënë shkurt gjallon ndër pisha
Yll përmbi boça radhitur shpesh,
Eh n'kafene vallë po të kisha,
Si do i hapje shishet ekspres!

I then ato me sqep të madh,
Zakonisht me t'rëna të forta,
I then nën pisha aty n'livadh
Se ato brenda kanë pastë për torta?!

Qendis dhe art me ato të rëna,
Edhe arrat do i theje ashtu?!
Popo e di çfarë më thotë Lena:
Marrim një n'shpi të na çajë dru!

Aman larike Stërçokë e hirtë
Sqepin e zi ma ke të gjatë,
Ih ato t'rëna t'i mbaj në shpirt,
Vetëm the boça me plot inat!

Bufi(Huti shqiponjë)

T'i dimë Buf ne shikimet tua,
Rëndë e kanë or zogjtë e tjerë,
Obobo nga ky drangua
Jepnju krahëve o të mjerë!

Ai si traktor ka sy të verdhë,
Ai gjilpërë ka edhe sqepin,
Rendni se ai gjakun ua derdh,
Tani kthettrat lëshon si grepin.

I ka krahët vërtetë shqiponjë,
E ndërron natën zërin si zagar,
Huton shpezët, lepuj edhe minj.

I mban veshët Bufi si ulkonjë,
Rend iriq, kusurët s't'i falë,
Ah moj vjeshtë, përzeje me shkopinj!

Hutini shqiponjë

Pse rri ashtu fare pa lëvizur,
Lë përshtypjen në grua me shami?¹
Ky maskim imi kështu i kurdisur
Ma sjell ushqimin në gojë o fëmijë.

Lë përshtypjen se dikë pret,
Mos roje pyelli je vjet për vjet?
Nga kthetra t'mia dhe këta dy sy
Beso askush nuk m'i bën dy!

Kur ndonjë lepur i ndjekur vjen,
Vërtet huton një llavë me qen?
Deri në dega e çoj voglushin,
Ata qajnë poshtë për lepurushin!

Kjo është përralla e rrushit
t'pajjekur
Që ish' i tharbtë për dhel për të
mekur,
Eshtrat ua hedh, vetë ngopëm mish,
Qentë në mes vete bëhen çervish!



Familja STRIGIDAE,
Lloji *Bubo bubo*,
EAGLE OWL,
HUTI SHQIPONJË (BUFI),
gjatësia 70cm, gjinia e njejtë, jo- shtegëtar.

Është shpend i madh (67-75 cm), me qafë të shkurtër e kokë të gjerë. Sytë e mëdhenj janë të vendosur përpara dhe ka sqep të hollë e të kthyer poshtë. Në të dy anët e kokës, mbi sy, gjenden dy pendë në formë të laprës së veshit. Trupin e ka të gjerë e të mbuluar me pendë të gjata të verdhë në të mbyllët dhe me njolla për së gjati. Ushqehet zakonisht natën me shpendë të egër, shpendë të butë, minj, lepuj dhe iriqë. Për këtë qëllim ka kthetra të gjata dhe të mprehta. Femra bën 2-4 vezë që i ngroh për 32-37 ditë. Është i përhapur në Shqipëri dhe Kosovë dhe në pjesën më të madhe të Evropës. Në vjeshtë shtegëton në vise të nxehta. Folenë e bën nëpër të qara të shkëmbinjëve dhe shpella apo edhe në ndonjë fole të braktisur nga shqiponja apo huta.



Bota buluron bjeshkëve

Bredhoi Bilbili brehishtave,
Bukur, butë, bredhoi bahçeve,
Bah, brengën birre Bathishtave,
Burrash brenda baltaqeve!

Bletari bagremave barti bletën,
Bariu berrat bjeshkëve, baçillave,
Bah, Bocëthyesja bleu biletën,
Ballëhapur blofoi bandillave!

Bre-bre Bocëthyesë bukuroshe,
Braktise breshërin, borën,
bezdinë,
Bam-bam bitisje boçat breroshe,
Britje bre, bëje batërdinë!

Bravo Bajzë, balë baldose,
Bukur bandillat bllokove,
Botërisht besën balsamose,
Bajzanin bregdetit burrërove!

Bretku, bobo, bretkocën braktisi,
Borizan bërlloku brofi barkave,
Bleroshja bretkocë botën barisi,
Burrobrenghën belbëzoi brrakave!

Bjeruni bishave- bërtet bariu-
Berrat bre baltosen, bukurinë,
Bah, blegëroi blegroshziu,
Boshatisi baçillën, bobo, berrërinë!

Bezeritet bariu, bërllyket bilbili,
Burrat e botës, bobo, bërtasin,
Bredh Bishlëkundësi, birësohet Babili,
Bota buluron, bjeshkët brohorasin!

Bravo-bërtet bokave bariu bandill-
Boll birove Brezne e Bresanë Babil,
Boll brohorite Buqes e Brrutit Bilbil,
Bishtalecat belhollë, brengosin baç e
baçillë!

Bulurojnë bjeshkët, bulurojnë bashtina,
Bulurojnë bredhave barinj e baresha,
Bah, brezave bërtet Bubulina:
Bashkoni brigjet- buluron burrëresha!

Dy binekë

Dy binekë pak kryeneq
S'e lënë gjyshin të delë n' shëti,
Do secili veç e veç
Në vrojtim të jenë pranë tij.

I merr gjyshi hopa-hop
I vë n'prehër që të dy,
Çarë të bësh që n' teleskop
Duhet vërejtur me një sy!



Cerla e kallamishtave

Cerlë kallami moj kokëzezë,
E mban shallin përreth qafe,
Rend kallameve në Prevezë,
Lehtë qëndron mbi to shpinëkafe!

A t'pëlqejnë ata kërcella
Edhe plot insekte kënetës?
Kënga jote e lum bëftë vera,
Alarmon Cerlonjtë shkorretës!

Llampë të duket gusha jote,
Aty varur në kallame,
Medet fjalët e kësaj bote
I merr moj si nina-nane?!

Sheshit shkon si një zonjushë,
Ta di plas dashnorët e brishtë,
Është se plas dhe çdo vejushë,
Sall këndo Cerlë n'kallamishtë!

Familja EMBERIZIDAE,
Lloji *Emberiza schoeniclus*,
REED BUNTING,
CERLA E KALLAMISHTAVE,
gjatësia 15cm, ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Në pranverë meshkujt e këtij Lloji dupin në maje të kallamit apo ndonjë shkurreje dhe ia japin këngës së tyre tre notëshe. Në dimër cerlat e kallamishteve mblidhen në tufa dhe kështu bashkohen me zogjtë tjerë të cilët ushqehen me fara në tokë dhe kështu bashkarisht e hanë ushqimin e tyre kryesisht insekte. Foleja në formë filxhani e formësuar nga fijet e barit e vëndosur në vegetacion në tokë apo edhe në shkurrë, zakonisht e bëjnë afër ujit. Është i përhapur në Europë dhe kontinente tjera. Gjithashtu e hasim edhe në vendin tonë me një numër të paktë.



Familja CAPRIMULGIDAE,
Lloji *Caprimulgus europaeus*,
NIGHTJAR,
CINGËRRIMI I NATËS,
gjatësia 28cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Ky zog shumë rrallë mund të shihet përveq se kur të filloje aktivitetin para muzgut ose në ag të mëngjesit, aq mirë maskohet sa që ndryshe quhet edhe mbreti i maskimit. Zëri i tij dëgjohet nga larg dhe kështu të lë të kuptosh se mos aty afër ka ndonjë gjenerator. Zogu pushon ditën i maskuar në tokë ose edhe në ndonjë degë druri të thatë, që ta ketë më lehtë të maskohet. Fluturimin e ka shumë të lehtë dhe pazhurmë. Në muzg dhe ag ushqehet me flutura dhe insekte tjera që i rrëmben duke fluturuar. Folenë e ndërton në sipërfaqe të hapur afër drujve apo shkurreve. Është i përhapur në Euroazi. E hasim edhe në vëndin tonë në lartësi mbi 1000m.

Cingërrimi natës

Cingërrim i natës-mbret i maskimit,
Ja si rri n'shkëmb e nuk bën zë,
Gjithë para muzgut, para agimit
I rrëmben fluturat që s'ka me të.

I ha dhe ato që janë në vjersha-
E pyetën Genti e Ariani?
Në natyrë mbahet gjithë baraspesha
Dhe pse fëmijëve u dhemb pak xhani!

Sa kilogram peshon natyra-
Te dy e pyetën si me një gojë?
Mos ju rren hunda edhe fytyra,
Në botë nuk ka të tillë peshojë!

Cërr-cërr-cërr ushton dhe nata,
I shtohen korit dhe shumë kërcella,
Natë e verës me surpriza t'gjata
Gongu bjer për ju fluturmjera!

Ë-ë-ë qajnë grania me çika,
Rron a s'rron dikush të na ndihmojë?!
Ik Cingërrim nate e të raftë pika,
Medet sa shpejt i fut ato në gojë!

Nata e zezë t'i nxiftë pikat larosh,
Ato pika t'bardha e kurrë mos qofsh,
Të hëngshin Skifterët atje në mal!

Eja ore n'vete verën e lë bosh,
Jepja fluturës krahët mos u bëj
rralloshe,
E di pse maskohesh si në karneval!!!

Cinja

Cinja ime e bukur dhe laroshe,
Herë mbi dardhë, herë n'mollë
mahjoshe,
Kreshta jote e gjatë mbi kokë,
Si mustaku i babëslok.

Është si bishti i xhezvës së vogël
Që bën kafe ajo motër,
Dhe shërben me gjithë dëshirë:
Urdhëro gjysh e të bëftë mirë!

Cinjë e bukur laroshake
Pak më dukesh torollake,
Çerdhën n'dhe ashtu që shtron,
Çdokush vezët t'i gllabëronë.

Pse kanë shije vezët tua,
T'i ha dhelpra atje n'përrua,
T'i ha gjarpri si llokum:
Pak janë katra-thotë-bën
mëshumë.


Ç'llogarit për muajin tetor:
Tri bryma bëjnë një borë!
Mblidhi rrobat e ato rraqe
Mbylli dyert në konaqe!

Me plot zhurmë e cicërrimë
Shkoi mbi mua fluturim,
Mirremi vesh-tha-me imell
Deri t'kthehem në pranverë!



Familja CHARADRIIDAE,
Lloji *Vanellus vanellus*,
LAPWING,
GICVILJA,
gjatësia 30cm, e ngajshme nga gjinia,
shtegëtar.

Ka trup të zgjatur, kokë të rrumbullakët e me pendë të gjata si kreshtë, sqep të shkurtër e krahë të gjatë që e mbërrijnë gjatësinë e bishtit. Qafa dhe ana shpinore kanë ngjyrë të zezë, ndërsa anën barkore të bardhë në të verdhë. Në çerdhen që e ndërton në tokë, femra bën zakonisht 4 vezë, të cilat ngrohen nga partnerët për 24-28 ditë. Vezët i ka shumë të shijshme. Gjatë fluturimit bën zhurmë të madhe. Është e përhapur gati në tërë Evropën. Shtegëton në gusht dhe tetor, kurse kthimin e bën në mars. Në vendin tonë e hasim nëpër liqene dhe rezervuare peshqish.



Familja STURNIDAE,
Lloji *Sturnus vulgaris*,
STARLING,
CERLOI I ZI PIKALOSH, *gjatësia*
20cm, e ngajshme nga gjinia, pjesërisht
shtegëtar.

Mahnitet njeriu kur i sheh këta zogjë në tufa të mëdha duke bërë figura në qiellin e hapur, kjo specie vërtetë është adaptuar shumë mire të jetojë në qytete. Shumohet në koloni me të tjerët, mashkulli e mbron folene nga frika so mos i dëmtohet. Tufa të mëdha zogjsh ushqehen me sqepat e tyre gati sa nuk ju mberrijnë në tokë dhe kështu ata të hapur për t'i rrëmbyer insektet dhe krimbat. Folenë e bëjnë në vënde të ndryshme: në zgavrën e lisit, mes shkëmbijve, apo brenda ndërtesave dhe në kutija per folenizim. Mjaft është i përhapur në Europë, Azi, Afrikë madje edhe në Amerikën Veriore dhe Australinë Jugore.

Cerloi i zi pikalosh

O Cerlua, o zog i zi,
Nga i more këto pika n'shpinë?
Nga babë Cerloi o ti njeri
Dhe mamaja atje n'Rudinë.

Sa shpesh n'qiell bëni figura
Kur me mija çoheni n'erë,
Ju do syri mbi ato gurra,
Ju do fëmija dimër-verë.

Kur ne nisëm akrobacionet,
Kush s'përshkonte qiellngratin,
Na kopjuan avionët,
Tash s'na lënë t'ushtrojmë zanatin.

Kur zëmë pritrat, kanë shqetësim,
Vëngër na këqyrin si qyqarë,
Shohin modelet në demonstrim,
Ikin të zhgënjyer me bisht ndër shalë.



Familja BUNTINGS,
Lloji *Emberiza cia*,
ROCK BUNTING,
CERLA E MALIT,
gjatësia 16cm, ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar

Eshtë zog me krahë të shkurtër e bisht të gjatë. Me kokë të përhimtë me vija të zeza, drejtë dhe rreth syve. Ka zë thirrës "tsi, tsi". Kur është i zemëruar lëshon zënë "t'r'r'r'r'r". Ushqehet nëpër brigje të rrëpira dhe shkëmbinjë. Zakonisht jeton në Europë nën 1500m lartësi mbidetare. Folenë e thur me barishta dhe gjethe dhe kështu i jep formë filxhani e vëndosur nëpër shkurra dhe lisa të shpërndarë. Eshtë i shpërndarë në pjesën e Europes jug-perëndimore dhe jug-lindore.



Familja EMBERIZIDAE,
Lloji *Emberica citrinella*,
YELLOWHAMMER,
CERLA VERDHASHE,
gjatësia 16 cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar i herë pas hershëm.

Cerla verdhashe është zog i familjes së cerlës së gardhishtes zhurmëtare. Mashkulli dallohet me kokë të verdhë dhe me këngë monotone tingujsh të hollë. Dieta e këtij zogu përbëhet kryesisht prej insekteve dhe farave të cilat i mbledh nga toka. Folenë e thur nga barishtat në formë filxhani, e thurur me materiale të zbukuruara, e vëndosur në fund te gardhishtave, nëpër shkurre të shkurta apo edhe në tokë. Është i përhapur në pjesën më të madhe të Europës, në disa pjesë të Afrikës Veri-Perëndimore dhe Azisë Qendrore.

Cerla verdhashe

Cerla verdhashe e bukura vashë
Notat e holla i ndan në fije,
Pse në kaçubë fundgardhi t'pashë?
Ndërtoj folenë n'shenjë dashurie.

Ai kokëverdhi dashnor Cerloi
Nuk të ndihmonë t'ndërtosh folenë?
Tash këtu ishte s'e di nga shkoi,
Për të merakut sa shumë më bren.

Ja ku po vjen me penj plot ngjyra,
Në ndërtim t'çerdhes dytë marrim
pjesë,
Dhunti të tillë falka natyra,
T'i rritim t'vegilit me plot kujdes.

Çerdhja n'kaçuba ka shumë rrezik,
Vezët do jenë në dorë të huaj,
Këtë konstaton i juaji mik,
Kështu do e zhdukni shpejt llojin
tuaj!

Herë rrini këtu, herë dhe shtegtoni,
Kjo punë e juaj çfarë do të thotë?
Kur rrimë këtu, këngën na d'gjoni,
Që është një vaj deri në mot.

Kur bëjmë të ikim atje nga dardha
U çojmë të fala bjeshkëve shtatlarta:
Ndaloni borën o ju kokëbardha,
Ne shpëtojmë hapat, do mbetni
t'ngrata!

Iku kokëverdhi, pas tij verdhasha,
Si të na lënë një lamtumirë,
Kështu e ka djali, kështu e ka vasha,
Të jenë pak vetëm këtë kanë dëshirë.



Cerla dimërake

O ku je moj Cerla dimërake,
Cerla e shpirtit dhe syrit tim,
Eja Parkaqit moj Verdhake,
Ruaju rrugës n'fluturim?!

Luaje një valle për mua,
Atje mëshhtëknës a verrit,
Deri ha farat gjoksftua,
I ndruhesh Skifterit?!

Moj Cerlë, çerdhën e bën në bredha,
Ëmbëlsirë në një filxhan,
Rend e shih Cerluan babaxhan!

Atje u dashurova e u kredha,
Këngë e petulla i ndamë në dy pjesë,
E po e dua dimërakun derisa të
vdes!

Familja FRINGILLIDAE,
Lloji *Carduelis spinus*,
SISKIN,
CERLA DIMËRAKE,
*gjatësia 12cm, ndryshon nga gjinia, jo
shtegëtar.*

Hyn në grupin e zogjëve të imtë.
Mashkulli dallohet me balë të zezë në
kokë, femra me ngjyra më të zbehta.
I vogli i përngjanë femrës së rritur,
por më i zbehtë. Ushqehet nëpër pyje
halore e të përziera, kryesisht aty ku
ka më shumë bredh dhe mëshhtëknë.
Ushqehet me fara të verrit dhe
mëshhtëknës. Folenë e ndërton lartë në
lis të bredhit në formë filxhani. Është
i përhapur në Europën Qendrore,
Veriore dhe pak në atë Jugore.



Familja BUNTINGS,
Lloji *Emberiza cirlus*,
CIRL BUNTING,
CERLA GUSHËGJELBËR,
gjatesia 16cm, ndryshon nga gjinia, jo shtegetar.

Cerla gushëgjelbër hyn në grupin e zogjëve të vegjël, është cerlë jugore. Mashkulli ka kokë të përhimtë në të gjelbërt, me vija të zeza e të verdha, shpinë ngjyrë gështënje të mbylltë. Femra me ngjyra më të zbehta. I vogli i tyre i përngjanë femrës. Formëson fole si filxhan, e thur me barishta dhe e vendos poshtë shkurrave dhe në dëllija. Më tepër është i përhapur në perëndim, jug-perëndim dhe jug të Europës. Ushqehet me insekte dhe fara. Mashkulli këndon nga maja e pemëve.

Celebrim i cemtë

Cerluaziu caktoi cenzurdatën,
Cerla ceku celebrimin,
Cerlua cenoi certifikatën,
Cerloverdha copëtoi cungimin!

Cinxërri çek-çek mizat cfilosi,
Cubisht copë-copë i copëtoi,
Cingërrimnateja cinkërrosi,
Ciu-ciu cezmeve celebroi!

Cinjushi cak-cak cungat cokat,
Cucocinja cullufet cupa cullufon,
Cinjushi capërisht cepave cirkat,
Cucocinja cullët cinjçe cucëllon

Cinjushi Citroenin cyti,currikoi,
Cinjat cazë cipciripet curruan,
Cinjushi cepave Citroenin centroi,
Cinjë e Cinjush celebruan, celebruan!

Cullët cemtë currilave culluan,
Cicërrimat cubelçe cinjëzuan,
Cakun cullçe cyten, cilësuan,
Cektë cingërruan, cingërruan!



Çapka e natës

Ariani: Çapkë, Çapkë, Çapkë e natës
Syri yt si dritë e vatrës,
Eja tek ne me gjithë zogi,
Pjekim s'bashku kollomoq.

Ziejmë patate të Pllajnikut,
Zë behonë në sy t'jashikut,
Mos i merr moj gjërat zi,
Ani se t'thonë bythëkusi.

Familja ARDEIDAE,
Lloji *Nycticorax nycticorax*,
NIGHT HERON,
ÇAPKA E NATËS,
gjatesia 65cm, nuk ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegetar.

Qapkë e vogël por e fortë e cila gjuan në kënetë, ligatina, natën, ky zog shpesh e kalon ditën në shoqëri me të llojit të vet diku nën hije. Preja e tij përbëhet prej insekteve, peshkut, bretkocave dhe ndonjëherë edhe ndonjë zog të vogël që e rrëmben nga qerdhja. E lëshon një zë thirrës të thellë gargarisjeje. Folenë e ngjet lartë në lis por jo në dukje serioze, nganjëherë edhe në shkurra apo edhe poshtë kallameve. E hasim në të gjitha kontinentet, përveq në anët veriore të tyre.



Çapka e përhitur

Genti- Çapkë,Çapkë e përhitur
Emrin gabim ta kanë ngjitur,
Je e kaltër qiell vere,
Syri im s'të delë prej dere.

Miellin mirë a e ke situar,
Mysafirë për të na pritur,
Duam pite e byrek,
Nuk shkon peshku darkë e drekë.

Oklogji s'ke marrë n'dorë,
Të janë velur fëmijët e gjorë,
Vetëm peshke peshk e peshk
A s'është turp për një çapkeshkë?!

Familja ARDEIDAE,
Lloji *Ardea cinerea*,
GREY HERON,
ÇAPKA E PËRHIME,
gjatesia 97cm, nuk ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Ka trup të zgjatur e të shtypur anash, qafë të lakuar dhe këmbë shumë të gjata e të holla. Sqepi i gjatë është i dhëmbëzuar në majë për kapjen e gjahut. Ushqehet me peshqi dhe amfibe. Jeton pranë ujit dhe në ujë, duke qëndruar si e shtanguar. Çerdhen e ndërton në drunj afër ujit. Mbi vezë qëndron 25-28 ditë. Është e përhapur pranë lumenjve të Evropës veriore, Qendrore, Lindore dhe Perëndimore. E hasim edhe përgjat lumenjve tonë, sidomos në rrjedhen e lumit Dri dhe Sitnicë gjithashtu edhe nëpër kënetat dhe ligatina. Foleja përbëhet prej një grumbulli shkopinjësh ku secilin vit i shton shkopinjë të tjerë.



Çapka sqeplugë

Ariani- Çapkë, Çapkë moj sqeplugë
Puna jote pak më llugë,
E fut sqepin gjithnjë n'ujë,
E përdor si për grabujë.

Është i mirë si mashë për vetullat
Dhe si lugë në tavë për petullat,
Për goruzhdë bën dhe n'kazan
Kur 'martohet xha Rizan,

Familja THRESKIORNITHIDAE, Lloji
Platalea leucorodia,
SPOONBILL,
ÇAPKA SQEPLUGË,
gjatësia 90cm, nuk ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Zog i madh i bardhë, këmbë të gjata me një kurorë elegante, këtë lloj zogu e gjejmë në ujëra të cekët në sipërfaqe të gjëra uji me baltë dhe rërë. Shpesh e gjejmë të shoqëruar me të familjes së tij por jo në numër të shumtë dhe ate në laguna, liqene, dhe sipërfaqe të vërshuara nga uji. Sqepi dhe qafa e gjatë i nevojitet që ta fut në ujë dhe gjithmonë e mban të hapur me qellim që të gjëlltis gjithë ato krijesa të vogla që arrijnë në dy krahët e sqepit. Ushqehet me krustace dhe insekte ujore. Folenë e nderton nga kallamishtet dhe atë brenda tyre në tokë, madje të njejtin mund ta hasim edhe në lis. Është i përhapur në Europë, Azi, gjat dimrit në Afrikë.



Çapka e verdhë

Genti- Çapکہ,Çapکہ,Çapکہ e verdhë
Shumë helm shpirtit mos i derdh,
Dukesh tepër e mërzitur
Në breg peshkun duke pritur.

Familja ADREIDAE,
Lloji *Ardeola rallodies*,
SQUACCO HERON,
ÇAPKA E VERDHË,
gjatesia 40-49cm, nuk ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Shumohet në koloni të vogla dhe ate në liqene të cekëta, kënetë, ligatina me kallamishte, shkurra dhe lisa. Jashtë periudhës së shumimit zakonisht jetojnë në grupe të vogla dhe të vetmuar. Verës shpesh i shohim në vënde tona, ndërsa dimrit shtegëtojnë në Afrikë. Ushqehen me peshqë të vegjël, insekte dhe amfibe. Janë prej çapkave më të vogla me ngjyrë të verdhë por kur i shohim fluturimthi krahët iu duken të bardhë dhe kështu dominon më tepër e bardha. Zërin e lëshon të ngjirur si ‘kaahk’ bukur të ngjajshëm me atë të roses së egër. Nga tufa dëgjohen edhe zërat ‘kak kak kak...’ madje ndonjëherë edhe më të mprehtë ‘ah ah ah’.

Çapka e bardhë

Ariani- Çapkë, Çapkë, Çapkë e bardhë
Ah t'ju kisha nja dy n'dardhë,
Qafa jote bardhë e gjatë
Si ndërtesa s'di n'sa kat.

Gjyshi- Çapkë, Çapkë sqepin çapë
Në ajër krahët bukur hap,
Mbi moçale ateron,
Si police kontrollon.

Çapkë, Çapkë sqepin kazmë
A s'na fton moj nesër n'dasmë,
Presim miq, shpërndajmë kafe,
Ti pranë dhëndrit hiç pa llafe.

Fjalë e rrokje i le n'shpi,
A t'u shtrydhën n'dashuri,
Sa për shkronja mos pyet fare,
T'i mësojnë shkronjat n'abetare,

T'gjitha llojet bashkë kur janë,
Gjyshi fëmijët kështu i shan:
-Mos m'i ngucni pulat n'lumë
Se me mua keni punë!



Familja HERONS,
Lloji *Egretta garceta*,
LITTLE EGRET,
ÇAPKA E BARDHË E VOGËL,
gjatesia 85-100Cm, me krahë të hapur 145-170cm, nuk ndryshon nga gjinia, pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në koloni të mëdha në liqene dhe ujëra të cekt, i preferojnë kallamishtet, shkurrat dhe drujt. Dimrin e kalojnë në detin Mesdhe dhe në Afrikë. Te ne e shohim në rrjedhat e lumejve dhe liqene akumuluese. Ushqehet me peshqë, insekte ujore sidomos në livadhe të vërshuara nga uji apo edhe në terrene të thata. Në pamje duket si një çapkë e bardhë e madhe, gati sa çapka e përhimtë, por duket më elegante se ajo. Duket të jetë e qetë në vetmi po ma të zhurmëshme janë në koloni. Zerin e lëshojnë si 'kr'r'r'r'ah'.



Familja STERNIDAE,
Lloji *Chidonias leucopterus*,
WHITE-WINGED TERN,
DALLËNDYSHE DETI
KRAHËBARDHË,
gjatesia 20-24cm, me krahë të hapur
50-56cm, nuk ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

I përngjanë dallëndyshes së zezë së detit, shumohet në habitatin e njejtë si ajo. Vizitor veror, dimrin e kalon në Afrikë. Dallon pak nga dallëndyshja e zezë e detit me sqep më të shkurtër por këmbë më të gjata. Zërin më të plotë se e zeza.

Çamëve, çamëve Çamërinë!

Çallmë e Çapkave çalla-çalla,
Çapkojtë çarshisë çapiten,
Çaprazin çuar çara-çara,
Çapkëbardhat çakërriten.

Çapkëhirtat Çapkë çapkenet
Çarravalles çapëlohen,
Çufrra-çufrra çufrrakenet,
Çakërrqejfi çiftëzohen!

Çevren çoje çakërdoje,
Çapkërushë gjerru çliruar,
Çitjanet çitje çfarëdolloje,
Çamarrokët çajnë çetuar.

Çafkëzezi çafkërrit,
Çekmexha Çapko çelet,
Çuditërisht çmallesh-çuçurit,
Çafkëlori çunçe çjerret.

Çafkëlori çapon çamave,
Çuditërisht çrregullohet,
Çafkëlorja çuçet çarave,
Çiltërisht çmallet- çohet!

Çarti çehren çmenduria,
Çapelat çamët çrrënjosen,
Çimenton çështjen Çamera,
Çamët çamçe çeliknosen!

Çamëria çështjen çmonton,
Çamëria çmonton çivinë,
Çamëria Çamërinë çimenton:
Çamëve, çamëve Çamërinë!!!



Familja ANATIDAE,

Lloji *Cygnus olor*,

MUTE SWAN,

MJELLMA ME XHUNGË,

gjatësia 152cm, dallohen pak nga gjinia, jo shtegëtar.

Këtë lloj e gjejmë në liqene me ujra të ëmbla dhe lumej dhe kështu konsiderohet si zogu më i madh dhe më i rëndë në këtë habitat. Tek moshrrituri e shohim sqepin e kuq duke e dalluar atë nga të rinjtë, të cilët sqepat i kan ngjyrë të përhimë. Qafen e ka mjaft të gjat dhe fleksibile sa për t'i arritur bimët nënujore siq janë; bimët ujore dhe rrënjët, të cilat janë ushqimi kryesor i këtij zogu. Dieta e tij gjithashtu përfshinë edhe krimbat, guacat dhe përpjekjet tjera të tija për të arritur gjallesat tjera të imta, thellë e më thellë nën ujë.

Kur del nga uji e shohim duke kullotur, por në tokë të thatë është i ngadalshëm dhe kurr nuk largohet shumë nga uji. Kur fluturon i rrah krahët, ma qafën e shtrirë përpara.

Të qiftuarit i japin besën njëri tjetrit për jetë. Kur nuk janë në procesin e shumimit zogjtë janë të shoqërueshëm dhe kështu formojnë tufë të tyre në liqene, lumej dhe grykëderdhjet e gjëra. Mjellmat e qiftuara e mbrojnë folenë nga zogjtë tjerë të këtij lloji me cdo kusht. Siq lë të kuptojmë edhe nga kuptimi i emrit të tij, kjo specie është e heshtur, përveq kur fërshëllenë, hungërinë dhe kur lëshojnë zëra nga fyti i tyre. Feleja e tyre duket e madhe me mjaft materiale të ndryshme bimore e vëndosur në kallamishte dhe atë në ishuj të vegjël në breg të liqenit apo edhe përgjat shtratit të lumejve dhe rrëkeve. Mjellma me gjungë është e përhapur gjithandej Euroazisë. E gjejmë edhe në Amerikën Veriore, Afrikë Jugore, Australi dhe Zelandë të Re. Edhe në vendin tonë e hasim në liqene natyrale por edhe në ata artificiale.



Dallëndyshja e hirtë e detit

Dukesh si e vizatuar
Atje gurëve përreth detit,
Llampë e ndezur e pashuar
Është kënaqësi për qejf të mbretit.

Nesër do të shkosh n'shëti
Dora-dorës detit blu,
Yll i ndezur dalld i ri
Shandan drite n'guvë diku.

Jepja besën pendëlhirtë,
Ankth i shpirtit do të zbutet,
Edhe zemra rrah e dlirtë
Hënë e natës mos të ngutet.

Ishte kjo një aventurë
Rëndë a lehtë këtë ti e di,
Tani jo më si dikur
Ënjtur lotësh n'dashuri.

Edhe kënga nga gëzimi
Do të jetë jehonë mbi dhe,
E do nis pastaj kllaçimi
Të jesh gati nënë e re.

Intermeco s'durojnë zoçkat,
Tik-tik-tik kujdes për loçkat!

Dallëndyshja e murrme e detit

Dale-dale më ngadalë
A s'po do a s'po më sheh,
Llërën çoje pak mbi valë,
Është kënaqësi për atë që t'njehë!

Ndoshta dalldi kështu të thotë
Dy herë jo s'e përsërit,
Yll i dadës s'e bën kot,
Shkon me tjetrën, pastaj prit.

Jeta qenka helm e vrer,
Ah gatuan me pelin,
Eh tek unë ai dalld i mjerë
Më besoni mbjell shqetësim.

Uh sa shpesh nga unë shutohet,
Rrengje t'ngurta kush duron,
Mendon, aq shumë përvëlohet,
Edhe deti s'i ndihmon!

Erdhi një ditë e kërkoi falje:
Dadë të lutem ishin fora,
E gjithë kjo e ka një dalje,
Ti moj zeshkë m'i heq saora!

Iso këto për dashurinë,
Tani zogj përplot shtëpinë!



Familja STERNIDAE,
Lloji *Chlidonias niger*,
BLACK TERN,
DALLËNDYSHE DETI E ZEZË,
gjatesia 22-26cm, me krahë të hapur
56-62cm, nuk ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Gjatë verës mund ta hasim në tokë, ndërsa gjatë dimrit në det, ky zog fluturon mbi ujë për t'u ushqyer. Lëshohet në ujë për t'i rrëmbyer insektet dhe peshqit e vegjël nga sipërfaqja e ujit pa u zhytur fare. Gjatë procesit të shumimit kolonitë mund t'i hasim në liqene të cekta dhe kënetat të vërshuara nga uji. Folenë e ngre buzë ujit ose edhe brenda tij me bimë uji dhe materiale tjera.



Familja HIRUNDINIDAE,
Lloji *Hirunda rustica*,
BARN SWALLOW,
DALLËNDYSHJA E KOQEKUT,
gjatesia 19cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Është shpend shtegëtar me madhësi deri në 19cm. Ka krahë të gjatë e të mprehtë, bisht të bigëzuar si gërshtë e sqep të hollë për kapjen e kandrrave në ajër. Fluturon shpejt dhe me zhdërvjelltësi të madhe. Ana shpinore ka ngjyrë të mbyllët, kurse ajo barkore ngjyrë të bardhë dhe gushë të kuqe. Çerdhen e ndërton në strehë, tavan, në drurë, etj. Femra bën 5 vezë, të cilat i ngroh për 14-16 ditë. Është paralajmëruese e pranverës, vjen në prill, ndërsa në shtator ose tetor shtegëton për Afrikë.

Dallëndyshja e koqekut

Dallëndyshe hambari apo e koqekut
Varet si të quajnë të folmet shqiptare,
Ty nuk ta ndien për grur të qeshkekut,
Ushqimin kërkon për t'vogat manare.

Me bishtin gërshtë ç'kompletesh pret,
Ç'fustana solemnë servon topmodele,
Zogat i hanë buzët gati n'çdo banket,
Pse je më e bukura misi i çdo vere.

Ajo gusha jote penat sa i ndez,
Në flakë të përmbysura që djegin në
mes,
Për lotët e vjeshtës që i vure n'varg.

Partiturat pyesin me nota pa gjumë,
Sa lule do i sjellësh për një vit më
shumë,
Poetit të vargjeve që e le kaq larg!



Nipat dhe gjyshi

A sheh sa lloje dallëndyshesh paska,
Ruaka deti perla kaq të shtrenjta,
I mban në gji deri te Alaska,
Ato kokëzezat mbi ujëra të njelmta!

Ndoshta t'bardhat me t'hirtat janë vajza
teze,
I sheh mbi gurishtë me sandalle të kuqe,
Eh det i dashur shpirtin sa ma ndeze,
Gent, rrikan dhe zeshkanet me këto
syduqe!

Eh shiko Arian, si hidhen nga lartësia,
Në ujë zhyten si të rrallët peshkatarë,
Të gjitha gjuajnë peshq se ushqim do
fëmija,

I kanë dy a tre mbi çerdhet përmbi zall.
Dhe kur çohen bashkë mbi detin e kaltër,
Eh ç'bukuri paska falur Zoti,
Paj dhe grabitësi jo si mban hatër,
Rend turr e zi ashtu siç prishet moti.

O babëlok pa shih për syrin se ç'bukuri,
Fenerë nate duken bashkë me yje loçkat,
. E mbushen brigjet bardhë e kuq e zi,
Sa të bukura janë kur flenë përmbi
zoçkat!

Obobo i duam te triat përtej mase,
Ruan deti ruan zogj të tillë parajse,
I duam mbi det këto klithma ngasëse.



Familja APODIDAE,
Lloji *Tachymarpis melba*,
ALPINE SWIFT,
DEJKA ALPINE,

gjatesia 22cm, nuk ndryshon nga gjinia, shtegëtar.

Kjo dejkë e madhe shumë lehtë mund të dallohet duke fluturuar në ajër ku shumë vështirë mund të bëhen krahasime në madhësi, barkun e kan të bardhë. Fluturues jashzakonisht i fuqishëm. Shumohen në koloni dhe ate nëpër shkëmbijë dhe ndërtesa të larta. Dallohet nga mënyra e shumimit nga dejka e zakonshme. Lëshon zë të zgjatur dhe shumë të zhurmshëm. Zakonisht ushqehet me insekte dhe ate i zë duke fluturua. Një fole filxhan i mbeturinave bimore dhe pupla, ngjitur me pështymë, në një parvaz ose në një të çarë. Shumohen në Europen Jugore deri në Afrikën Lindore. Dimrit shtegtojnë deri në Indi dhe Afrikë.

Dejka alpine

Deri kur do qëndrosh bjeshkëve të larta
E pa zbritur njëherë në Ulinë?
Jepju atyre fletëve të bukura, të gjata,
Krahapur të pres Dejko në Prishtinë.

Ani se dukesh si dallëndyshe,
Ani se dukesh si korb i zi,
Pikat e bardha hiç pa mëdyshje,
Ulërijnë në sytë e mi.

Sa bukur penda jote shkëlqen,
Medet dukesh vërtet shqiponjë,
E sytë e zezë të shquajnë për zonjë.

Luku yt në fluturim më rrëmben,
Mendo dhe po i re mes për mes kësaj
bote,
Alpet janë vendlindja jote.



Pyetje për vjeshtën

Ariani: Cila manekyre ia rregulloi thonjtë,
Cili piroman ia ndezi kreshtën,
Kush ia mblodhi dardhat edhe ftonjtë,
Cilën shenjë pikësimi , Gent, do vësh për
vjeshtën?

Genti: Presja edhe pika janë për të pushuar,
Shiun e ftohtë asnjëra s'e ndal,
Kënga e shtegëtarit s'di me ç'shkronjë ka
shkuar,
Brenda abetares mbetet për të parë!

Pas çdo përgjigjeje këta dy bineq,
I vënë dy pika siç janë edhe vetë,
-Oj stinë e pemëve sa na vjen keq,
Me saja në krah dimri na pret!

Mbeti pikëçuditja si hu i gardhit,
Pas çdo fjalie të dridhet nga frika,
Pse sytë i kapën borë n'mes t'livadhit,
Dënes me pak zë si "e" me dy pika!



Dimri

Erdhe dimër si me zor këtë vit,
Gjatë e shtyre deri në dhjetor,
Lotët rrëshqasin të ndryshkur në pritë,
Edhe sajat pse nuk ka dëborë!

Ti nuk je akullore e verës,
Ti përzure nga këtu çdo këngëtarë,
Ti je nuse gjithnjë kundër vjehrrës,
Ti klith egër tamam si barbar!

Vetëm Piku ty or të bënë nder,
Me tikërre dhe me t'bukurën ngjyrë,
Ti veç përrallave në palcë u hap derë,
Se përndryshe jo nuk ke fytirë.

Ti or sjell natyrën e vdekur,
M'plagos syrin gati në çdo remb,
Fasho tjetër jo nuk më ka mbetur,
Lidhma plagën aty ku më
dhemb!

Ç'm'u mërzitën Stërçoka e Gala
Plot Laraska edhe Harabelë,
Palltobardhi seç më doli para:
-Do shërohesh- më tha-në
pranverë!



Fajkua i detit

Fajkua i detit tim të kaltër
Ah ç'kthettra të verdha si thika
gërryese,
Je i bukur o grabitçari i pahatër,
Kokëbardhi i familjes rrëmbyese.

Unë për ty një pulë të pjekur e ha,
Ani se ti këngëtarët m'i rrëmben,
I ke peshqit n'ujë, nga dy i çon hava,
Me ta zogjtë e tu ditë e natë ushqen.

Ikën laraska e pse e trembur si
dreni,
Deri e zuri ai Fajkua i zi me një hop,
E unë kënaqem se zogjtë m'i bën
copë-copë!

Ta di pse gjuhën e qet në çerdhe si
qeni,
I forti diell i verës gati sa s'të kopë,
Ta them të drejtën, syrin e ke shkop!

Familja PANDIONIDAE,

Lloji *Pandion haliaetus*,

OSPREY,

FAJKUA DETI, gjatesia 50cm, nuk ndryshon
nga gjinia, shtegëtar.

Shpesh qirret me zë të lartë mbi liqene dhe
brigje deti. Fajkua deti është gjeraqinë-peshku,
vërsulet me shpejtësi nga ajri për ta rrëmbyer
peshkun nga uji. Kjo rënie pikiatë-me këmbët e
para dhekrahëtë ngritur, shpesh mbytur veten
pothuajse tërësisht, për të rishfaqur me
peshk dhe për të vazhduar me fluturimin e
tij. Preja mbahet zakonisht me kokë përpara,
të mbajtur në të dy këmbët, për të ngrënë
në një degë peme ose në fole. Foleja përbëhet
nga nga një grumbull shkopinjesh e vendosur
në lis, në breg të detit, shkrep apo në një
platformë qerdheje artificiale. Është i përhapur
dhe shumohet në Amerikën Veriore, Euroazi,
Afrikë dhe Australi. Dimrit shtegton në
Amerikë Jugore, Afrikë dhe Azi. Femrat janë
më të mëdha se meshkujt. Kangja të gjata për
ta mbajtur peshkun.



Familja PHASIANIDAE,
Lloji *Phasianus colchicus*,
PHEASANT,
FAZANI,

gjatesia 83cm, ndryshon nga gjinia, jo shtegëtar.

Trupin e ka të mbuluar me penda ngjyrash të bukura, më të bukur janë meshkujt. Karakteristikë tjetër është se kanë bishtë shumë të gjatë dhe të ngushtë, që tërhiqet zvarrë. Rreth qafe ka një qafore me ngjyrë të bardhë. Femra në çerdhen e saj bën 8-15 vezë. Fazani ka origjinë nga Kaukazi dhe rëndom jeton nëpër disa vende të Evropës qendrore dhe Jugore. Të ne aty-këtu gjendet në malet e larta, por në numër shumë të reduktuar.

Fazani

Fare-fare s'e di o Fazan
Ato ngjyra të bukura n'harmoni,
Zemra në sy sa t'i mbanë,
Avangardë në pulari!

Në qafë unaza e bardhë mesit,
Bisht i gjatë tokës të shkonë zhag,
Ikën mashkulli herët mëngjesit,
Shkon pas femrës sa tepër larg.

Ti origjinën e ke n'Kaukaz,
Atëdheu yt është Evropa Qendrore,
Gjallon te ne në viset malore.

Aman për zhdukje mos kij maraz,
Ti përplas perlat në shpirt përtej mase,
Iu qepe artit në pendla parajsë!



Finqit

O gojëmbël portokall i verdhë,
Ujin e detit e solle mbi mua,
Tutem nga pema këngën mos ta
derdhë,
Ai që bën krime n'pentagramet tua.

Punë e mbarë o këngëtar i parë,
Që pranverës i mbjell lule përvjetë,
Bakllavës së pjekur gatuan me arrë,
Vërtet sot linjat ia mbushe shërbet.

Mbi cilat agrume këndon në
Mesdhe,
Fol o Finqe mandarinë e butë,
Zemrën time bëre për fole,
Nisja me dy nipat mos prit një
minutë!

Familja FRINGILLIDAE,
Lloji *Carduelis carduelis*,
GOLDFINCH,
GARDALINA,
gjatësia 12cm, jo shtegëtar.

Gardalena shumëngjyrësh i cili gjatë vjeshtës fluturon andej këndeje në tufa të mëdha. Ky zog sillet në fusha të hapura, dhe ushqehet me fara të gjëmbave (therrave), gjithashtu ushqehet edhe në sipërfaqe të tokës. Folenë në formë filxhani e thur në degëza të lisit. Është i përhapur në Europë, Afrikë Veriore, Lindje të Mesme, madje kalon edhe Azinë Qendrore. Tek ne është i njohur si shtigliq, familjet e preferojnë ta mbajnë në kafaze si në Kosovë ashtu edhe në Shqipëri. Është zogu më laraman prej të gjithëve dhe shumë këngëtar. Këndon kor bashkarisht me të tjerët, mashkulli këngën më të mirë ia kushton femrës.



Familja FRINGILLIDAE,
Lloji *Coccothraustes coccothraustes*,
HAWFINCH,
SQEPTRASHI,
gjatësia 17cm, ndryshon pak nga gjinia, jo
shtegëtar.

Finq i madh i majeve të lisave të pyjeve. Ky zog ka sqep masiv, me të cilin mund ta thej faren e qershisë dhe vishnjes për ta ngrënë thelbin e tyre. Ushqimet tjera janë: farat, sythat dhe frutat. Gjat dimrit duken në grupe të vogla. Sqeptrashët gjat tërë kohës janë zogjë shumë të fshehtë. Folenë e bëjnë të cekët në formë filxhani, të rregulluar me krande dhe bimë, e vëndosur në lis. Eshtë i përhapur më së shumti në Europë, pjesën e Afrikës Veri-Perëndimore, Lindje të Mesme, Azi Qendrore, Siberi Jugore dhe Azi Lindore. Gjat dimrave me shumë borë dhe të ashpër vijnë në kopshte në kërkim të farave të qershive dhe vishnjeve. Fluturojnë vullshëm dhe shpesh mund të pësojnë me goditje të xhamit të dritareve, gjat fluturimit pendlat i duken të zgjeruara.

Finqi i murrizit (Sqeptrash)

O Finq murrizi,
Mos po t'kruhet kurrizi,
Tërë ditën rri n'qershi,
Nuk ma lë një kokë për fëmijë.

Kur unë dal me vrull nga shpia,
S'mund të t'gjejë as policia,
Fshihesh shpejt në lisa t'gjatë
Si t'luash "Hujda" me fëmijët
n'fshat!

Me atë sqep masiv që ke,
E rrëzon një kopsht përdhe,
Lë frutat , po dhe farat
I then shpejt si t'përdorë darat.

Kot s'të quajnë dhe sqeptrashë,
Lë përshtypjen në turi dash,
Ndaj ne dy do i prishim punët,
Po të zura t'i thej hundët!

Mburresh për folenë në lis,
Që të thuash në majë ka plis,
Ama ç'fole ndërtur ke,
Sa një filxhan që pimë kafe!

Me të tillë gjyshi çdo mëngjes
Pi makiato ose ekspres,
Ndaj të lutem shumë o Finq
sqeptrash,

Ik sa s't'u turr guri si dashi!

Gala

Ju të zezat ngjyrëvjollcat Gala
Qendroni fushave suri-suri,
Vizitë i bëni kopshtit me arra,
Le që gllabëroni , s'mbani qetësi.

Kur bëni lojë në tokë Stërçoka
Ato dhelprushe tinza përgojnë?
Me gisht në gojë i lëmë mbi boka,
Pa therrë në këmbë qiellin kaptojmë.

Mezi e pritni bujkun në arë,
Ta futë ai plugun të bëjë hulli,
Si dhentë pas kripës cila më parë,
Pirunjte në krimba, t'bëni gosti.

Kur çoheni n'ajër s'bashku me sorrat,
Qiellin e vjeshtës e bëni zi,
E ndiejmë të ftohtin o ne të gjorat,
Po prishet moti o ti zotëri.

Dhe gjatë tërë dimrit me pendla
t'lëshuara
Krrrokatni zi mjerimin tuaj,
Jashtë pa ushqim si të harbuara
Mbetet njeriu për ju të vuaj!



Familja CORVIDAE,
Lloji *Corvus monedula*,
JACKDAW,
GALA,
gjatësia 33cm, pjesërisht shtegëtar.

E tëra është e zezë, e përshkruar me ngjyrë
vjollce. Jeton së bashku me sorrat. Është
e përhapur në Evropën Perëndimore e
Jugore dhe në vendin tonë. Është me
madhësi të njëjtë me sorrën, afër 47cm me
krahë të hapur. Ushqehet me kandrra dhe
fara. Femra bën 4-6 vezë, të cilat i ngroh
për 18-21 ditë. Folenë e vëndos në lis ose
edhe në strehë të shtëpive. Në vjeshtën
e vonë me qindra të tilla fluturojnë në
qiell duke paralajmëruar motin e ftohtë
të dimrit. Klithmat e tyre në fluturim të
rrenqethin. Janë të rrezikshme për bujqit
në fushë, sepse hetojnë bukën e mbështjellë
dhe e zbulojnë saora duke i lënë ata pa një
kafshatë të vetme dhe shumë të zemëruar.



Familja CICONIIFORMES,
Lloji *Botaurus stellaris*,
BITTERN,
GAKTHI,

gjatësia 80cm, pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në shtratin e kallamishteve
Ushqehet me peshqë, bretkoca,
insekte. Foleja me kallame mu në
nivelin e ujit. Shumë është i qetë në
priti të presë. Mundohet të maskohet.
Është më i vogël se qapka e përhime.
Këmbët i ka më të shkurtëra. E lëshon
një zë si tataraaaa, 'graoh'.

Gakthi

Kur e çon kokën përpjetë
Duket ujë që ulëron,
Kur e shtron sikur shigjetë,
Kujdes n'zemër mos të shponë!

Këmbë të gjata kacagjel
Me tri kthetrra si tri degë,
Rëndë kur tokës ngadalë shkel,
Është i ëmbël sikur shegë.

Ca në gjoks kanë gëzof luani
Kur e fryjnë e i japin zor,
Më besoni m'kënaqet xhani,
Nga zë i ëmbël në tenor!

Kur shikon qiellin e retë,
Si raketa që pret startin,
Fluturim hidhet mbi det,
Në ujë peshqit kap si mjaltin.

Pendë e kaftë syrin ta ndjellë,
Me atë sqep sa ëmbël thërret,
Bisht të bukur ,por cubel
Ka gogësimet si sherbet.

Nuk gogësjë i dashuri mik,
Kur fryjë gjoksin sikur bretkun,
Ftoj të dashurën në piknik
Se në trup i dridhet petku!

Gaktha t'vegjël të kuqrremtë
Tre a katër në fole,
Nëna Gakthe jak në mend
Peshq të vegjël sill për ne!

Me atë peshkun kaq të madh
Po na shkon lëngu për goje,
Me atë lukth sa një livadh
Shpejt na qet moj ti prej loje!

Gëk-gëk-gëk dhe Gakth i vogël
Thërret me hove nga ai sqep,
Gakth i madh i thotë në kodër:
Rri më urtë se t'futa n'xhep!



Grifsha

Grifshë sa krah të bukur ke
Resht: kaltër, bardhë kaftë e zi,
I ke pendët o të lumit ne,
Faqe dheut këngën mrekulli.

Shkruaji notat me atë zë të trashë
Ashtu bukur si ma do zemra,
Bukuroshe më e hedhura vashë
Ububu ç'kthetra poshtë te
thembra.

Krrokot tua moj soj korbeshe
Ulërojnë në dega ag e terr,
Ruaje veten nga ata skifterë!

Obobo moj shpirt mikeshe
Shtroja ëmbël nga sqepi maliher,
Eja n'vizitë të shoh dimër-verë.

Familja CORVIDAE,
Lloji *Garullus glandarius*,
JAY,
GRIFSHA,
gjatësia 35cm, gjinitë e ngajshme,
pjesërisht shtegëtar.

Shpesh i kujdesëshëm dhe i dyshimt në sjelljet e tij. Grifsha Euroaziatike më tepër është e njohur për virmen e saj se sa për ngjyrat e puplave. Është zog i drujve gjetrënese dhe pyjeve ku jeton në qifte apo grupe të vogla. Ushqehet me ushqime të llojeve të ndryshme si: arra, fara, pemë, insekte, dhe gitarë. Në vjeshtë mbledh goglena për ta kaluar dimrin, duke i futur dhe mbuluar në tokë dhe kështu pas disa muajsh nuk e ka shumë të vështirë për t'i gjetur. Folenë e formëson me shkopinjë lart në lis. Është i përhapur në Euroazi dhe Afrikë.



Familja TURDIDAE,
Lloji *Luscinia svecica*,
BLUETHROAT,
GUSHËKALTËRTI,
gjatësia 14cm, gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Shumë i përngjanë gushkuqit por jashtzakonisht është shumë i fshehtë, e kalon ditën në vegetacione të ulëta. Shumohet në pyll, rrëzë tyre në dru shelgu. Habitatit i dimrit është shelgu. Ushqehet me insekte. Qerdhen e thur në formë filxhani në vegetacion të shpeshtë. Shumohet në Euroazi dhe Alaskë, ndërsa dimrin e kalon në Afrikë dhe Azi. Rrathët me ngjyra në fyt dhe gjoks varen nga vegetacioni.

Gushëkaltëri

Gongu ra që t'ia fillosh,
Ububu si kërcen gusha me lara,
Shumë e kaltër dhe e kaftë, trimosh,
Ë-ja harroi pikat, të doli përpara.

Kënga jote në kor me bilbilat
Aman si dallohet në atë simfoni,
Lëre atë të bukur përmbi trëndafilat,
Të kënaqet Hira s'bashku me plot
fëmijë,

Është se unë ta barti këngën në shpirt,
Rend e merria shpesh mu te kopështi
im,
Të them o gushëkaltër merria pa
përtim.

Iha gusha jote qielli plot me dritë,
Iha larat tua janë përplot shkëlqim,
Merria t'qeshet Hira ashtu në lazdrim!



Gushëkuqi

Gushën e ke si portokall,
Uh ç'shpërthim duke kënduar,
Shumë sa shumë më shtohet mall,
Ë-ja n'qerpik e çliruar.

Këndo o këngëtar, këndo,
Ule pakëz zërin atje në degë,
Qëllon Gjeraqina rrotull ngado,
I lë mesazhet të kuqe si shegë.

Ia merr notave të holla,
Medet sa kënaqet Troja,
Aman sa kënaqet edhe Arti.

Lum ti për këngën te molla,
I derdh margaritarët nga goja,
Ta them troç, vërtet je më i zjarri.

Familja TURDIDAE,
Lloji *Erithacus rubecula*,
ROBIN,
GUSHËKUQI,

*gjatësia 14cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.*

Femra dhe mashkulli i këtij zogu i mbrojnë territoret e tyre, e ekspozojnë gjoksën e tyre të kuq dhe kështu gati tërë dimrit këndojnë që nga agu i mëngjesit. E paralajmëron agimin e ditës. Gushkuqët vërtetë janë shumë të butë në Evropën Perëndimore por shumë të turpshëm në atë lindore. Ushqehet me krimba dhe insekte, kryesisht i rrëmben nga sipërfaqja e tokës. Fole me plot myshk dhe gjethe, e lidhur me fije floku në një të çarë të murit apo shkëmbit. Është i përhapur në Euroazi, Siberi Perëndimore, Afrikë Veriore dhe Azi Qëndrore. Popullacioni lindor shtegëton në jug gjatë dimrit. Madje dimrin e kalon edhe në kopshte.



Familja ACCIPIDRIDAE,

Lloji *Accipiter gentilis*,

GOSHAWK,

GJERAQINA,

gjatësia 48cm, gjinitë pak ndryshojnë, pjesërisht shtegëtar.

Grabitçar i fuqishëm me krahë të gjerë dhe bisht të gjatë. Femrat janë më të mëdha se meshkujt. Meshkujt e rritur kanë përmasa të krahasueshme me femrat e Gjeraqinës së Euroazisë (*Accipiter nisus*). Zakonisht fluturojnë në lartësinë e majave të pemëve me lëvizje të pakta të krahëve. Ndërtojnë fole masive në pemë, në lartësi rreth 10-20 metra, të cilën e përdorin për disa vjet me radhë. Bëjnë 3-4 vezë. Ngrohja e tyre zgjat 35-38 ditë dhe të vegjlit arrijnë të fluturojnë pas 35-42 ditësh. Ushqehen me shpendë dhe gjitarë me përmasat e lepurit ose të fazanit. Thirrjet dëgjohen kryesisht në agim dhe janë shumë të ngjashme me ato të Gjeraqinës së shkurtës (Eurasian sparrowhawk), por më të forta, me ritëm më të ulët dhe me një kukurisje më të ngadalët “kja-kja-kja”.

Gjeraqina

Sheh Gjeraqina në marketing
Fustane t'bukura me ngjyrën blu,
Nesër do niset të shkojë n'shopping,
Larg në Afrikë n'fisnin Zulu.

Ky mis i zogjve me mendje t'lartë,
Kodin e sjelljes do ta ndryshojë,
Deri atje s'ka kush e bart,
N'oborr mbretërie çështjen do shtroj.

Paneli s'ish i korruptuar,
As presion s'kish politik,
Ia dhanë Hutin për ta shoqëruar
Si Sanço Pançën më t'mirin mik.

Kjo Tanushë mali e fshatit Brezne
Harxhoi të hollat ç'pati n'kuletë,
Bleu për prind halla e teze,
Një fustan t'shtrenjtë për dasmë t'vet.

Ajo bën pallë, palla s'i ha,
Pranë dhëndrit rri shumë e gëzuar,
Vajzat përreth i thonë gjithçka,
N'vargje satirash duke ngacmuar:

“Gurët e malit kisha mbledh’ me bofqe,
E s'i kisha lënë t'gjitha ato shoqe,
Një temena për ne grabitçare
Sot je bërë nuse e nuk ke çare!”

Harroi sfilata, këngë e martesë
Kur pa ca minj në rreze dielli,
Pingul sulmoi me sqepin këmesë,
Ndalet rrufeja kur zbret nga qielli?!

Humbi gëzimi, u tret hareja,
Huti u zu me Gjeraqinë,
Kërciti grushti, filloi beteja,
Dasmë pa mish s'gëzon krushqërinë!

N'Ahishtë të Gurëzve krejt prapa
shpine
Dy emra vendesh populli shënoi:
Njërin e quajti “Lug Gjeraqinë”,
“Fusha e Hutit” tjetrin e shkroi!



Gjeraqina e shkurtës

Gjeraqinat gjëmojnë, gjuajnë,
gjallojnë,
Enden endemitet e erërave enden,
Rëndë rendin, roshanet rëndojnë,
Ato ashtu avansojnë agjendën,

Qëllojnë , qepen, qëmtuese quhen,
Izolojnë ikejaket, injektojnë,
Ndoshta nga ne ndonjëherë ndruhen,
Ato ashtu agjendën avansojnë.

Enden endemitet e erërave enden,
Malit mërrrolur me mendje mazi
migrojnë,
Ato ashtu agjendën avansojnë.

Lehtë lënorin labirintet, legjendën
Ikin, inskenojnë, imitojnë,
Tekefundit turravrap të tërat
teprojnë.

Familja ACCIPIDRIDAE,
Lloji *Acipiter nisus*,
SPARROWHAWK,
GJERAQINA E SHKURTËS, *gjatësia*
28cm, gjinitë ndryshojnë, pjesërisht
shtegëtar.

Jeton në pyje dhe në hapësira të hapura, është zog i vogël i specjeve të gjeraqinave i cili e ka të specializuar kapjen e zogut (harabelat) duke fluturuar. Fluturon shumë në nivele të ulëta, manovron me shpejtësi mes lisave dhe shkurreve dhe kështu e rrëmben pre në pas një fluturimi të shkurtër por të shpejtë. Folenë e ndërton me strukturë të thjeshtë shkopinjësh të lidhur me fije të holla dhe atë lart në lis. Shumohet në Euroazi dhe Afrikë Veriore. Popullacioni i veriut gjatë periudhes së dimrit shkon pak ma në jug të Afrikës së Veriut. Femra është më e madhe se mashkulli.



Familja CALIDTRIS,
Lloji *Calidris ferruginea*,
CURLEW SANDPIPER,
GJELËZA GUSHËKUQE,
gjatësia 21cm, gjinitë ndryshojnë,
shtegëtar.

Shumohet në Siberinë Arktike, dimrat kryesisht i kalon në Afrikë, rrallë ndalet në Mesdhe dhe Europë. Gjatë fluturimit të shtegëtimit ndalet në kënetat, ligatina të përziera me lloje tjera sidomos me gjelëzën gushëzezë. Ushqehet ma pakurrizor. Pak më i madh se gjelëza në fjalë, gjithashtu sqepin e ka pak të lakuar.

Gjelëza gushëkuqe

Gjentele je moj gushëkuqe,
Edhe kokën për merak,
Lëri klithmat përmbi Buqe,
Ëndrra e Gjelkut fshatarak!

Zor e ka ai gjer te ti,
Afër vjen dhe një frajer,
Gongu bjer zallamahi,
Ububu ç'kikboks pa fer!

Shkunden Gjelkuat dhe në ujë,
Është e këndshme gusha jote,
Këngët tua fuqiplote!

Ububu moj mos bën huj,
Qëndro mjalt pëbrenda gote,
E derdhe ëmbël në sy t'kësaj bote!

Gjelëza pikaloshe

Gjelëza ime pikaloshe
E ke bishtin t'zi e t'gjatë,
Lëri hujet bukuroshe,
Ëmbël thuaja çokollatë!

Zi në gushë e kaftë në shpinë,
Ashtu ardhur krem në torte,
Po të presin shokët t'rrinë,
Ik se t'shanë moj nëna jote!

Këngët, britmat kënaqin detin,
Ato thirrje si shërbet,
Lëri forat ai të pretë!

Obobo mahnite mbretin,
Shtohesh koxha për sivjet,
Edhe zogjtë si nëna e vet!
Gjelëza e madhe bishtzeza

Gjelzomadhja këmbëgjata
E kaftë shpinës edhe kokës,
Lëri llafet se t'zu nata,
Ëmbëlsirë mbi faqe t'tokës!

Zure ngushtë atë dashnor,
Atje kënetës duke shkuar,
E pe bregut dorëpërdorë
Me atë Gjelkëzën e harbuar?!

Ah ajo ta prishi jetën
Dhe një ditë do i thuash stop,
E po thuaja të vërtetën,
Boll ma bëre zemrën gropë!

I ke këmbët paterica,
Shumë vrapues i lë n'stihi,
T'gjitha shoqet supanica
Zërin tënd ta kanë zili!

E ke sharmin si rrallëkush,
Zonjat bregut le të plasin,
Kënga jote i bën prush,
Ëmbëlsirë për ty që flasin!



Familja CHARADIIDAE, Lloji *Pluvialis squatarola*,

GREY PLOVER,
GHELËZA PIKALOSHE,
gjatësia 28cm, gjinitë njejtë, shtegëtar.

Gjelëz bardh e zi e tudrave të zdesura, ky zog krahët i ka në formë konike, fluturon në distanca të gjata gjat shtegëtimit. Gjatë dimrit pendët i ka më të përhimë dhe kështu mund të identifikohet me të zezën në pjesë e poshtme dhe me thirrjen si 'thee-oo-vee'. Gjatë dimrit ushqehet nëpër vende të lagëta ku dominon balta. Duke e marrur ushqimin hecin ngadale duke kerkuar krimba në baltë, guaca të vogla, krustace madje edhe pakurrizor tjerë. Folenë e ndërton në një gropë të cekët në tokë të mbështjellur me myshk dhe likene. Shumohet në regjionet e tundrave të Amerikës Veriore dhe Euroazisë Veriore. Dimrat i kalojnë në shumë pjesë të botës, nëpër brigje të detrave dhe oqeanëve.



Familja TETRAONIDAE,
Lloji *Tetrao urogallus*,
CAPERCAILLIE,
GJELI I MALIT, gjatësia 74-90cm.
Mashkulli, 54-63cm. femra, gjinitë e
ndryshme, pjesërisht shtegëtar.

Meshkujt janë me ngjyrë të errët dhe tri herë më të mëdhenj se femrat. Ngjiten në fluturim me zhurmë shumë të madhe të krahëve. Fluturimet janë të shkurtra, të shpejta dhe në vijë të drejtë. Jetojnë në zona malore, në pyje halore ose të përzier, zona me pisha të vjetra në vende shkëmbore. Foletë i ndërtojnë nga fundi i prillit. Femra lëshon 7-11 vezë e inkubimi zgjat 24-26 ditë dhe të vegjlit janë të aftë për fluturime të shkurtra kur mbushin moshën 2-3 javore. Në mbrëmje dëgjohe kënga “ko-krek-korok”. Meshkujt kanë një kakarisje të ngadaltë e të përsëritur “grak”. Në agim kënga përbëhet në tinguj dysh kërcitës, që përshejtohen në një tingull që dëgjohe si “kork-pop”.

Gjeli i egër

Qaq të bukura pendët tua
Kur ti fryhesh si Gjeli deti,
I kap syri n’gjoksin ftua,
Qafë e bisht në veshje mbreti.

Kokën lart e çon si shpesh
Edhe zërin me nota t’trashja,
Mos rivalin e fton n’shesh
A diku të humbi vasha?!

Ko-ko-kotë e ushtojnë malin,
Bas i ëmbël portokall,
Dhëlpres midën ia kallin,
Ti në degë hovin s’e ndal.

Rreth Pulëegrës rrotull shkon,
Ia qite mbi kapuq,
S’je i dehur, por aktron,
Mos u sill si soropuq!

Zëri yt zë Kikireci,
Me bojë dukesh koxha burrë,
Bishti yt mal Monastreci,
Ndaj rivalit kur merr turr.

Kërcen ëmbël breg më breg,
Ligjeron nga sqepi dyll,
Në duel vërtet strateg
Plak me mjekër për zogjtë n’pyll.

Kërkon afër atë zonjushë,
Kënga jote përshkon malin,
T’kërcenë mjekra zi nën gushë
Pse e munde kundërshtarin?!

Ndaj këndon atje n’Pikëllimë
N’shenjë fitoreje urtë e butë,
Gjel i egër s’njeh kufinë,
Ka të drejtë me kushtetutë!



Gjokskuqi

Gjoksi yt i kuq prush
Oi kërcen si portokall,
Këngës kur ia merr babush,
S'ka si mos t'na mbetet mall.

Kënga jote si flutura,
Ushtrohet luleve n'livadhe,
Qepju notave më të bukura,
I pres n'zemër n'fole t'madhe!

Nëse do t'jesh dirigjent,
Është e udhës t'zbrazësh notat,
Plot për plot t'i mbushësh shportat!

Edhe t'jesh pak vigilent,
Mund Skifteri t'shpërthejë portat,
Ë-ja t'i mbushë me gjak notat!

Familja TURDIDAE,
Lloji *Phoenicurus phoenicurus*,
REDSTART,
GJOKS KUQI,
gjatësia 13-14cm., gjinitë e ndryshme,
shtegëtar.

Shumohet nëpër pyje të përziera dhe gjethrënëse, në kopshte dhe parqe. Vizitor të verës, dimrit shtegëtojnë në Afrikë. Zakonisht qenrojnë ne degë të lisit apo shkurre dhe prej andej lëshohen në tokë për ushqim. Folenë e ndërtojnë në zgavër të lisit apo edhe në një kuti të vëndosur për folenizim. Mashkulli ngjyrat i ka më të theksuara me gushë të zezë dhe gjoks të kuq, kokë të përhime.



Familja TURDIDAE,
Lloji *Phoenicurus ochrorus*,
BLACK REDSTART,
GJOKSKUQI I ZI,
gjatësia 15cm, gjinitë e ndryshme,
pjesërisht shtegëtar.

Epëlqen mjedisinshkëmbor, gjithashtu është adaptuar edhe me jetën urbane, ky zog zakonisht qëndron në shkëmb apo në mur. Zakonisht kërcen prej një vendi në tjetrin, gjithmonë duke e mbajtur barazpeshën me lëkundje të bishtit para së të zbret në tokë për ta kapur insektin. Folenë në formë filxhani të formësuar me bimë dhe fije kullosash elegante, flokë dhe pendla, të tillin e hasim në një të qarë shkëmbi apo muri. E hasim në disa pjesë të Europës, Afrikës Veriore dhe ate Lindore, Lindje të Mesme. Gjatë dimrit mund ta hasim edhe më në jug të Afrikës.

Gjokskuqi i zi

Gjokskuq o zeshkan,
O e madhe mandarinë,
Kënga jote anë e mbanë,
Sikur mjalti që të shkrinë.

Kot të thonë Gjokskuq i zi,
Ububu pendël kaltrosh,
Qulli notat n' simfoni,
Ih sa t' dua bukurosh!

Yrysh n'dega, yrysh n'koka,
Nëse do të mbijetosh,
Është të ruhesh kuqalosh!

Ik se Hutat atje n'boka,
Zemrën ta bëjnë shoshë,
Ik se sytë m'i shtjerr zijosh!

Gjypi (Kali i qyqes)

Gjyp, pse të quajnë Kali i qyqes,
Yshtur të kanë plakat për ndonjë barrë?
Popo çfarë t'i them atëherë Shyqes,
Ia barti vezët ndaj e quajtnë Kalë!

Kllasinë t'duken pendqët, ta zënë edhe
ballin,

A s'më thua ore, i kashagit njëherë?
Lëri të qetë zogjtë, këngës t'ia marrin,
I bardhë e i zi Gjypo me krahët në erë.

Iha kur vërsulesh si ndonjë rrebesh,
Qëllon mbi cicërrima, kënga mbushet
vaj,
Yrysh bën Gjypo, kush nuk mund të
t'ndajë!

Qen i pabesë si mund të rrëmbesh,
E mbi të gjitha dikush këtu ka faj,
Sqepi yt i gjatë i kthyer në majë.



Familja ACCIPITRIDAE,
Lloji *Neophron percnopterus*,
EGYPTIAN VULTURE,
GJYP (KALI I QYQES),
gjatësia 63cm., gjinitë e njejtë, pjesërisht
shtegëtar.

Gjyp i vogël me fytyrë tullace dhe qafë të rrudhur me pupla, këtë zog e hasim në fusha të hapura dhe në gjysmëshkretëtira. Nuk mund të krahasohet me gjypa të mëdhej duke u ushqyer tek një kafshë e vdekur. Në anën tjetër, të jesh më i vogël, nuk do të varësh shumë nga rrymat e ajrit të nxehtë për t'u ngritur lartë dhe kështu ky zog fluturon që në agun e mëngjesit për të mbërrirë i pari tek kafsha në fjalë. Lëshohet tek kolonitë e vendfoleve të zogjve tjerë dhe kështu u rrëmben vezët me sqepin e tij. Foleja duket si një platformë e vogël e bërë nga shkopinj, e lyer me bajga, qime dhe të lëkurë, e vendosur mbi një buzë shkëmbi. Është i përhapur në Europen Jugore, Lindjen e Mesme, Afrikë, Azi perëndimore dhe në Indinë subkontinentale. Femrat janë më të mëdha me trup.



Familja PASSERIDAE,
Lloji *Passer domesticus*,
HOUSE SPARROW,
HARABELI I SHTËPISË,
gjatësia 15 cm, ndryshon nga gjinia, jo shtegëtar.

Ky lloj u zhvillua si zog farë ngrënës, por tani jeton në shoqëri me njeriun. Aftësia e tij për t'u ushqyer me cdo gjë, duke filluar prej krimbave dhe pemëve e deri te hedhurinate e kuzhinës, i pamundëson atij që të zhvillohet në vëndet larg origjinës së tij të parë. Folenë e bën të parregulluar mire me fije bari dhe me materiale tjera, shpesh ndërton atë nëpër ndërtesa. Është i përhapur në vëndet Euroaziatike, Afrikën Veriore, Lindje të mesme, dhe në vënde tjera.

Harabeli

Je Harabel më i miri zog,
Ta them me zemër, me gjithë dëshirë,
Pse s' u trosha, s' u lë bërrillog,
Mendon jam fshisa më e mirë?!

Je dhe besnik dimër e verë,
Kur kam mërzi, kur kam dhe gëzim,
Gjithmonë pranë dere me dhjetra tjerë,
Si mos të them je miku im?!

Cicërrimat tua të egra t' shkurtra
Më zgjojnë nga gjumi kur bie borë,
Tani unë dal t' i bëjë të buta,
Koka me grushta të qes n' oborr.

O pendëlhirti voc Harabeli,
O zog shtëpie shpinëkaferem,
Sa m' i kënaq nipat e t' u rritë nderi
Kur bashkë me shokët lodron në pemë.

Kujdes Skifterin shpesh ai sulmon,
Bëhesh në ikje hundë e buzë gjak,
Ai pingul hidhet si avion,
Voglushi im mund t' biesh n' lak!



Harabeli n'akrostik

Harabel eja tek unë ashtu drejt,
A s'i sheh poshtë kokat prush,
Rend si era shpejt e shpejt,
Ani t'kënaqet e vogla gushë!

Bëre ore zemrën gur,
Eja fluturimthi këtu,
Lëre frikën lart he burrë,
I vras lala armiq të tu!

Ikën , e pse ikën ashtu vallë,
Vetëm pse të shërbej?
Obobo Skifterin unë s'e vërej!

Grupin tënd që e kam mall
Është e udhës ta ushqej,
Larg janë vrasësit, s'vijnë këndejl!

Familja PASSERIDIDAE,

Lloji *Passer montanus*,

TREE SPARROW,

HARABELI I FUSHËS,

gjatësia 15 cm, ndryshon nga gjinia, nuk është
shtegëtar.

Zog i vogël dhe i zhdërvjellët. Në ndryshim nga harabeli i shtëpisë (*Passer domesticus*), harabeli i fushës ka një njollë të zezë mbi faqet e bardha dhe një kësulë totalisht kafe. Sqepi i tij është i shkurtër dhe me ngjyrë gri. Meshkujt, femrat dhe të vegjlit ngjajnë shumë me njëri tjetrin. Ndeshet kryesisht gjatë dimrit në zonën fushore, prej ku merr dhe emrin. Qëndron në tufa me harabelë të llojeve të tjera. Është i pëhapur në zonat fushore. Foletë i ndërton në trungjet e pemëve dhe në mure. Lëshon 5-6 vezë nga prilli në gusht. Ngrohja zgjat 11-12 ditësh. Të vegjlit fluturojnë mbas 2 javësh. Kryesisht ushqehen me fara bimësh si dhe insekte. Kënga e tij është mjaft e ngjashme me atë të harabelit të shtëpisë. Kënga e fluturimit "tik-tik" është një shenjë tipike dalluese e tij.



Familja ACCIPITRIDAE,
Lloji *Buteo buteo*,
COMMON BUZZARD,
HUTA,

gjatësia 55 cm, ndryshon nga gjinia, është pjesërisht shtegëtar.

Është fluturues i shkathët i mbifushave, kodrinave, pyjeve të hapura dhe rrëzë pyjeve, ka pendë shpinore me ngjyrë të mbyllët, ndërsa ato barkore me ngjyrë të bardhë në të verdhë dhe me njolla të tërthorta. Fluturon lartë me orë të tëra në kërkim të presë. Ushqehet me kurrizorë dhe pakurrizorë, duke filluar prej brumbullit e deri tek lapuri. Foleja me shkopinjë të grumbulluar dhe të vëndosur në lis apo diku në shkëmb. Mbisqepi është më i gjatë e i kthyer poshtë. Ka kthetra të përshtatshme për rrëmbim të presë. Zakonisht rrëmben shpendët e tjerë. Femra bën 4-5 vezë, që çelin pas 41-49 ditëve. Jeton në tërë Evropën. Shumohet në pjesën më të madhe të Euroazisë. Dimrin e kalon në jug të Afrikës, Indi dhe Azi jug-lindore. Femra është më e madhe se mashkulli.

Huta (*Buteo buteo*)

Bërtet ashpër mbi zogj si një doçe,
Ulesh shpejt me kthetra grabitçare,
Topi t'vraftë se në shpirt i dogje,
Endemite e kreshtave në male.

Obobo ç'gështenjë me sepin
gërremç
Bukur dukesh me pika pëmbi
shpinë,
Uh sa tutet në atë lis ai vremç,
Tej e tej përshkoi atë lëndinë.

E ne çerdhe sa vezë i kllloqit,
Ole t'klithin zoçkat tua n'qiell,
Hutë e rreptë t'i mëkosh me gojë.

Unë t'përcjell tinëza për çdo ditë,
Ti zogushve mishin ua pjek n'diell,
Ankth i madh qenka kjo peshojë!

Hutini i fushës

Hu-hu- huton dhe kallinj të në arë,
Ule pakëz zërin se vera s'vete mbarë!

Të gjithë këngëtarët ia mbathën dikah,
I ke minjtë or ti, ata mos i nga!

I mblodhe të gjitha klithmat në gushë,
Fatkobin ta derdhë lumë gjaku në
fushë!

Ububu atyre ç'ua kalle datën,
Shenjove n'shënjestër zëmadden,
lëngatën!

Ë-ë- si e-të me dy pika mbi,
Se ç'u mbusha vrer,lotët më shkojnë
vijë!

Hutini

O Hutin veshkuti,
S'të do Zgatar i Brruti,
O surrat patate,
O lugat nate,
Se fëmijët po i tutni!

Më mirë shko n'piknik
Diku n'Llopushnik,
O surrat patate,
O lugat nate,
Ani s'tutet i vogli Nik!

Mos gabo të shkosh n'Buzex
Se me një potez xha Elez,
O surrat patate,
O lugat nate
Të bënë çamçakëz!

Edhe po vajte në Trokon,
Gjuetari të shenjon,
O lugat nate,
O surrat patate,
Tikap të qëllonë!

Më mirë shko n'Zaplluxhe,
E huto hutin nëpër lugje,
O i natës lugat,
Hutini veshgjatë,
Ani kush s'të jepë shah-mat!



Familja STRIGIDAE,

Lloji *Otus scops*,

SCOPS OWL,

HUTI I FUSHËS,

gjatësia 20 cm, nuk ndryshon nga gjinia, shtegëtar.

Pendët shumëngjyrëshe e këtij huti të vogël i mundësojnë që të maskohet në ambiente të ndryshme. Zog i krimbave, i klimës së thatë, gjuan në sipërfaqe të hapura, gjat ditës pushon në degë të lisave i maskuar shumë mirë. Fluturon shpejtë me krahrrahje të nivelizuara. Kur gjuan lëshohet nga vendqedrimi me shpejtesi dhe e rrëmben prehtë me kthetrat e tij, nganjëherë i zbretë presë nga ana e pasme, ushqehet me insekte, krimba të tokës, amfibe, zhapina dhe zogj të vegjël. Nganjëherë i zë fluturat e natës në qiell të hapur. Kjo specie zakonisht gjuan natën por mashkull gjuan edhe ditën kur femra është duke i inkubuar vezët apo edhe kur rrin mbi të vegjlit. Fole e parregulluar mirë në ndonjë zgavër apo edhe në ndonjë të qarë të lisit. Është i përhapur në Europën Jugore, Rusi dhe Kinë. Dimrat i kalojnë në Afrikë dhe Indi.



Familja TYDONIDAE,

Lloji *Tyto alba*,

BARN OWL,

HUTI I KOQEKUT,

gjatësia 40 cm, nuk ndryshon nga gjinia, jo-shtegëtar.

Ky zog dallohet me fytyrë “forma e zemrës” qe në kombinim me sytë e arrinë këtë. Fluturon shumë lehtë dhe ngadalë dhe atë shumë afër mbi tokë apo edhe e përcjell prenë nga vendqëndrimi dhe i sulet me një fluturim të pazhurmshëm të cilën ia mundësojnë ca pendla të imta në krahët e tij. Gjuan totalisht në errësirë duke e identifikuar prenë nga zeri apo zhurma e tij. Ushqehet me minjë, apo edhe ca kefshtë tjera te vogla që lëvizin rretherrotull. Zogjtë e till në fole e lëshojnë një zë kërrhatës, apo edhe një thirrje fishkëlluese. Foleja në një të qarë druri, koqek apo edhe në ndonjë ndërtesë tjetër. Është i përhapur në Europë, Amerikën Veriore dhe Jugore, Afrikë dhe gjithandej Azisë dhe Australisë.

Hutini i koqekut (I hambarit)

O Hutin i koqekut

Fytyrën qyreq,

Sygogol atje rreth bregut,

Zogjtë i vret shpirtkeq!

O Hutin i koqekut

Hirtë e kaftë mbi shpinë,

Minj sa t’duash ke rreth bregut,

Zogut nuk të nginë!

O Hutin i koqekut

Fytyrë dordolec,

Bën ç’të duash n’fund të bregut,

Zogjtë mos m’i mrec!

O Hutin i koqekut

Hundën qesh e ngjesh,

Kujdes ore n’fund të bregut,

Mos bjer n’hundë me lesh?!

O Hutin i koqekut

Disa t’ruajnë për mall,

Të çojnë vetë atje rreth bregut,

T’gjuash pa zagarë!

O Hutin i koqekut

Fytyrën lugat,

Ç’type vallë në fund t’hendekut,

Plumbi t’mbeti ngat?!

Hutini veshgjatë

O Hutin veshgjatë
Si ujk ata vesh,
Ikni zogj të ngratë,
Se ju bën përshesh!

Veshët sikur kalë,
Hutini veshgjatë,
Ikni zogj në mal
Se ju bën sallatë!

O Hutin veshgjatë
Me veshët përpyjetë,
Ikni zogj të ngratë
Se s'ktheheni në jetë!

O veshgjatë Hutini
Pse e mpreh sopatën?
Flini këngëtarë, flini
Se minjve ua kall datën!



Familja TYDONIDAE,

Lloji *Asio otus*,

LONG-EARED OWL,

HUTI VESH GJATË,

*gjatësia 31-37 cm, me krahë të hapur
arrinë 96-98cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.*

Shumohet në pyje, në fusha të gjëra, zabele me ara të mbjellura, në parqe të mëdha me bredh dhe arnen. Shtgojnë në distanca të shkurtëra madje edhe andej nga jugu. Ushqehet kryesisht me minjë uji. E shfrytëzon folenë e zogjve tjerë, sidomos të sorrave. Më i vogël se huti vesh shkurtër. Krahët e gjatë por të ngushtë. I rrituri rri shumë qetë.



Familja STRIGIDAE,
Lloji *Asio flammeus*,
SHORT-EARED OWL,
HUTI VESHSHKURTËR,
gjatësia 38 cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.

Huti me krahë të gjatë dhe me pendla të shkurtëra tek veshët, është hut i sipërfaqeve të gjëra, fushave me kullosa, ligatinave dhe kodrave me rërë. Në këto hapësira pa drujë, pushon në tokë apo edhe në ndonjë shtyllë dhe në ndonjë qati të ndonjë koteci. Fluturon lehtë dhe pa zhurmë, duke mos u dëgjuar fare, duke fluturuar krahët e marin formën e shkronjës “V”. Gjuan duke fluturuar dhe sulet me të shpejtë pas presë. E rrëmben prenë me kthetra dhe e bart deri në vendin ku edhe do ta ha. Ushqimi kryesor janë minjtë dhe fluturat e natës, por edhe si shumica e hutave edhe ky ushqehet me kafshë të imta duke filluar prej insekteve, pulë e egër dhe ndonjë iriq. Foleja një gropë në sipërfaqe të tokës, e formësuar nga zogjtë tjerë, e vëndosur në fusha të hapura madje edhe diku nën ndonjë shkurrë të ulët. Më së shumti shumohet në Euroazi, Amerikë Veriore dhe atë Jugore. Popullacioni i veriut shtegëton në Meksikë jugore, Afrikë dhe Indi.

Hutini veshshkurtër

O Hutin veshshkurtër,
Hutin kthetrazi,
Zogjtë i lidh me kulpër
N’fantazmagori.

O Hutin veshshkurtër,
Veshët si kalë Nili,
Zogjtë i rrah me thupër,
S’të dhimbset Bilbili?!

O Hutin veshshkurtër,
Veshët që mban curr,
Zogjtë i han si putër,
Kështu nuk bën he burrë!

Veshët si minuk,
O Hutin veshshkurtër,
Mishin ua bën suxhuk,
I lidh si me kulpër.

Pastërmë do ua thashë
Mishin mbi zjarr në det,
Gjatë dimrit do e hash
Ndoshta vetë i tetë!



Kalorësi

Këmbë të gjata ke si lejkë,
Anës lumit e anës detit,
Lëviz shpejt atje në breg,
Obobo kalorës i mbretit!

Rend mbi ujë me paterica,
Ëmbëlsirë ai sqep i hollë,
Sa dashnore e supanica
I mban afër i bëri horë?!

Ijaaa, Kalorësit bardhë e zi,
Deti kënaqet vërtet me ju,
E pse peshqit bëjnë ku-ku-ku?!

Të gjitha betejat në poezi
I ke fituar në rima e vargje,
Tërhiq tash n'çerdhen me harxhe!

Familja CHARADRIIFORMES,
Lloji *Himantopus himantopus*,
BLACK-WINGED STILT,
KALORËSI,
gjatësia 33-36 cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

E hasim në ujra të ëmbla dhe të cekta, madje edhe në ujra të njelmata, laguna, etj. Është zog shtegëtar, kryesisht dimëronë në Afrikë. Duke iu falënderuar sqepit të gjatë, mund t'i arrijë insektet edhe më thellë në ujë, qe shumica e llojëve ti tij nuk mund të kenë sukses në ato ushqime. Folenë e ngre zakonisht buzë ujrave të cekët aty ku ka vegjetacione. Shumë është kalorës elegant. Me sqep si gjilperë, këmbë të holla, të gjata dhe të kuqe. Gjatë shumimit e lëshon një zë të zhurmshëm, në të kundërtën është shumë i qetë.



Familja PHALACROCORACIDAE,
Lloji *Phalacrocorax pygmeus*,
PYGMY CORMORANT,
KARABULLAKU I VOGËL,
gjatësia 45-55 cm, gjinitë e njejta, jo
shtegëtar.

Shumohet në koloni në ujra të ëmbla, liqene dhe delta detare me vegjetacion të zhvilluar. Noton shumë gjatë nën ujë, qendron në degë ose edhe ngjitet lartë kallamit. Folenë e ndërton poshtë në sipërfaqe të kallamishteve e përbëre nga shkopinjë dhe fije kullose. Sa i përket zërit shumë pak dihet, kur janë në koloni lëshojn thirrjet kroatëse.

Karabullaku i vogël

Karabullak, i vogli Kormoran,
Ah si rri n'degë edhe përgjon,
Ruan e gusha t'levizë m'u në xhan,
Ashtu krahështirë sa bukur qëndron.

Bie në ujë posi shigjetë,
Ububu peshqit nga ti sa tutën,
Llafet harrojnë kur i gërget,
Aty në sqep sa shpejt që futën!

Kënga jote virrmë a krrokamë,
Ushton dhe detin në fluturim,
Ikin dhe valët plot me piskamë,
Valët dhe peshqit në pambarim!

O vogëlushkafti Karabullak,
Godet me virrmë, godet me sqep,
Ëndrra e jote peshku n'kajmak
Lëvarur rri n'zdrongun pa grep!

Kazuari

Kazuar o i madhi Kazuar,
Si një plak ecën ngadalë,
Rrugës shkon si kamion,
I ngarkuar s'di n'sa tonë.

Me formacionin kapelor,
Gjeneral i t'parës dorë,
Gjeneral, por pa ushtarë,
T'vetmin ke një zog me larë.

Qafëcullak si një biban
Ngjyra blu shkon mbi katran,
Dy lapra që mban nën gushë,
T'buta, t'kuqe sikur prush.

Po ç'të duhen ty të shkretit
Kur nuk klith si Gjeli i detit,
Vetëm punën tënde këqyr,
Si një grumbull me qymyr?

Shpesh në kopshtin zoologjik
Andej telave sulmon mik,
Po ti fare s'je fajtor,
Vizitorët shpesh kanë dorë!

Fort ta kënda të bësh plazh
Sidomos kur je me vashë,
Shtrihesh n'ujë si buall i zi,
Të të çojnë e kanë mërzi.

Shpesh me trungje luan kikkoks
Herë me shqelma, herë me gjoks,
Shumë e rëndë goditja jote
Lamtumirë i thua kësaj bote.

Ti e di sa kile ke
Dhe çfarë gara bën n'Guine,
Nëse t'ngucin shpend i butë,
Shtroi përtoke nokaut!

Krahët tu të reduktuar
T'thonë shko rrugës së
pambaruar,
T'fluturosh nuk bën aspak,
Struku-struku i shkreti plak!



Familja CASUARIDAE, Lloji

Cazuarius cazuarius,

CASSOWARY,

KASUARI,

*gjatësia 183 cm, gjinitë pak të ndryshme,
jo-shitegëtar.*

Ka kokë lakurike, ndërsa mbufatja e eshtrave të kafkës i krijon një formacion kapelor në kokë. Penda përbëhet prej dy kërcenjve, prej të cilëve njëri është kryesori. Krahët i ka shumë të zvogëluar, prandaj nuk mund të fluturojë. Gjymtyrët përfundojnë me tre gishta. Jeton në pyjet verilindore të Australisë dhe të Guinesë së Re. Foleja rregullohet e cekët në shtratin e pyllit e rregulluar me gjethe dhe bimë tjera. Nuk fluturon.



Familja FRINGILLIDAE,
Lloji *Carduelis cannabina*,
LINNET,
KËRPNGRËNËSI,
gjatësia 14cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar i pjesshem.

Eshtë i njohur me këngën e tij “twangy” bas, është finq i fushave-kodrinave të hapura, posaqërisht ushqehet me farat e gjinesherit. Kërpngrënësit bëhen të shoqërueshëm në vjeshtë dhe kë dhe kështu formojnë tufa të mëdha bredhëse, të cilat shpesh fluturojnë nga jugu. Ata kryesisht ushqehen me fara dhe insekte. Folene e formesojnë si filxhan i thurur me barishta dhe myshk, i vjerrur dhe i vëndosur posht në shkurrë apo në lis.

Eshtë i përhapur në pjesën më të madhe të Europës dhe Afrikës Veriore; pjesërisht i përhapur në Lindjen e Mesme dhe Azi Qendrore, gjat dimrit mund të fluturojnë andej nga jugu.

Kivi i madh

Pema kivi edhe ti
Dytë njësoj u pagëzuat,
Kush nga cili o zotëri,
Njëri-tjetrin e kopjuat?!

Së largu dukesh si iriq
Që ecën me dy këmbë,
Trupi t'duket shkurtabiq,
T'mungonë bishti me gjithë
dhëmbë.

Gjatë gjithë natës je aktiv
Duke futur sqepin n'tokë,
Çfarë kërkon i madhi Kiv,
Mos vallë krimbat me gjithë
shokë?!

Veza jote kaq e madhe
Sa çereku i peshës femër,
Një argat ushqen n'livadhe,
T'thonë urime me gjithë zemër.

Përse krahët nuk të duken,
Por gjithë shihesh rrumbullak,
N'evolucion ata t'u zhduken,
Ndaj dhe rend si topolak.

Me atë sqepin detektor
Si t'zbulosh mina nën dhe,
Krah nuk ke e s'ke as dorë,
Endemit n'Zelandë të Re.



Familja *APTERYGIDAE*,
Lloji *Apteryxowini austtalis*,
BROWN KIWI,
KIVI I MADH,
*gjatësia 70 cm, të njëjtë nga gjinia, jo
shtegëtar.*

Është vrapues endemit i Zelandës së Re, pa bisht, qafëshkurtër, me sqep të gjatë dhe të hollë. Vrimat e hundës i ka në majë të sqepit, ndërsa krahët nuk i shihen fare. Bën vezë të mëdha (14cm) me peshë sa një e katërta e trupit të femrës. Është aktiv gjatë natës, duke u ushqyer me krimba dhe me larva të kandrrave. Nuk fluturon.



Familja CORVIDAE,

Lloji *Corvus corax*,

RAVEN,

KORBI,

gjatësia 54-67 cm, të njëjtë nga gjinia, jo shtegëtar.

Shumohet në pyje të shkreta në lartësi mbidetare diku mbi 1500m. Zë territore të gjëra. Enden shumë. Qiftet e zënë për jetë. Shumë të turpshëm. Gjatë dimrit vizitojnë kërmat. Folenë e ndërton me shkopinjë në shkëmb, lis. Shumohet herët në pranverë. Në qiell të hapur fluturojnë në qifte, mashkulli i lavdërohet femres duke bërë ekzibicione duke fluturuar. Konsiderohen si të menqura ndër shpendët.

Korbi

Kurrë një fjalë më mos e fol
O i zi, dhelpra të vuri në lojë,
Ra poshtë djathi hiç pa zor,
Bre-bre t'la me gishta n'gojë!

Zijosh, o shpend i tmerrit,
Ikën maleve me krrokamë,
Ububu si t'delë prej ferrit,
Ta kanë frikën anë e mbanë!

Ore disa sqepin t'bardhë e kanë
Rendin qiellit me krro-krro
Oh se ç'valle obobo!

Llafet lëri me krrokamë
Ashtu frikshëm mos qëllo
Krahëve jepju ngado shko!



Korbi sqepbardhë

Korb i zi me sqep të bardhë,
Oshëtin me kr-ra-kr-ra-kr-ra,
Rend çukit aty nën gardh,
Boçat then për mashallah!

I ke pendët vezullimë,
Sqepmasivin si një daltë,
Qëllon fortë e rrapëllin,
E në boça mos gjën mjalt?!

Por o Korb, mos u lavdo,
Bëre uthull atë fabulë,
Ajo skile t' mashtroi, burrë!

Rend pishnajave tufëro
Dhe zanatin përserite,
Ëmbëlsirën në dritë qite!

Familja CORVIDAE,
Lloji *Corvus frugilegus*,
ROOK,
KORBI SQEPBARDHË,
gjatësia 47 cm, të njëjtë nga gjinia, pjesërisht
shtegëtar.

Shpend të mahnitshëm me ngjyrë të zezë dhe shkëlqim blu. Sqepin e kanë të drejtë dhe ngjyrë gri. Lëkura rreth sqepit është e zhveshur nga puplat dhe ka ngjyrë të hirtë. Haset në zonat fushore gjatë dimrit, shpesh në shoqëri me grupe të tjera sorrash dhe korbash. Në dallim nga sorrat, ecin me trup të tendosur drejt dhe pupla të shpupuritura. Balli i tyre është i drejtë, kurora më e lartë, dhe sqepi më i mprehtë. Në fluturim ngatërrohet shpesh me korbin (*Corvus corone*) për shkak të bishtit të gjatë e të rrumbullakosur. Qëndron në toka bujqësore dhe në parqe. Folezon në pemë të larta, në grupe prej dhjetëra deri në qindra çifte. Femra lëshon 3-5 vezë në periudhën mars-prill. Ngrohja e vezëve zgjat 16-18 ditë. Të vegjlit fluturojnë pas 29-30 ditëve. Kryesisht ushqehet me bimë, fara, rrënjë dhe fruta. Ha edhe insekte, krimba toke, ose gjitarë të vegjël. Zakonisht lëshon zërin “kau” ose “kaa”. Këngë është e ngjashme me atë të korbave.



Familja TROCHILIDAE,
Lloji *Colibri coruscans*,
SPARKLING VIOLET-EAR,
KOLIBRI,

gjatësia 12 cm, të njejtë nga gjinia, jo shtegëtar.

E hasim vë vende të hapura me drujë, ky zag aktiv e mbron territorin e tij përreth luleve. E mbledhin nektarin nga lulet dhe zënë edhe insekte të vogla duke fluturuar. Duke qendruar në degë të bimës e përserit zerin përsëritës “tsip”. Folenë në formë filxhani e formëson me myshk rrjetë marimange dhe vendos në degë horizontale jo shumë lartë tokës. Është i përhapur prej Venezuelës deri në Argjentinë.

Kolibri

Kolibër, o zog i bukur me sqep të gjatë,
Obobo sa i vogëlth-o, obobo,
Lëviz krahët si bletë pranë luleve
n’shat,
I shpalos në zemër të bukurat ato!

Bah, rri në ajër me flatra si Petrit,
Rend lule më lule farat ua shkëmben,
I shumëzon ato me sqep kur çukit,
I vogli Kolibër, flutur që shkëlqen.

Vete nëpër lisa çerdhën e mbaron,
Oh se ç’izolim me bar e me baltë,
Grumbull n’dega varur që malit jehon,
Është se puna jote vërtet duket art.

Lëre nëno lëre po sa ke kujdes,
Bukur ushqen zoçkat babaxhanë,
Ububu të vegjlit mëngjes për mëngjes,
Kërkojnë moj nga ti përshesh me tërhanë.

Uh shih ngjyrat tua, ylberin kolorit,
Rëndon nëpër qafë si një medaljon,
Obobo Kolibër syve m’u shton dritë,
Shpirtin ma ushqen shtruar kur vallëzon!

Kolovatesi

Kolovatu-kolovatu
Obobo n'çerdhen si thes,
Luaju si në tra çardaku,
O i vogli Kolovates.

Vërtet art kjo çerdhja jote
Ashtu thurur me mjeshtri,
Të gjithë mjeshtrit e kësaj bote,
E pranojnë këtë mrekulli.

Si n'lavjerës të programuar
I kënaqur kështu përherë,
Në brendi me krah të lëshuar,
Ëndërron jetën me të tjerë.

Desha t'them o Kolovat,
Eh si ia thua nën hije t'lisit,
Grahi këngës pak më gjatë,
Ani hyn n'libër t'Ginisit!



Familja REMIZIDAE,
Lloji *Remis pendulinus*,
PENDULINE TIT,
KOLOVATESI,

*gjatësia 11 cm, të njejtë nga gjinia, pjesërisht
shtegëtar.*

Zog shumë i gjallë dhe aktiv nëpër shtrat
të kallamishteve, kolovatesi ushqehet
me insekte gjatë verës dhe me fara gjatë
dimrit. Emrin e ka marrur "penduline"
për arsye të strolçitës së tij elegante që i
nevoitet me javë të tëra për ta ndërtuar.
Folënë e ndërton nga qimet dhe e vjerrë
atë diku në një degë shëlgju me kokë
teposht. Fole me një rrumbullak, në
formë të dhomës dhe një tub vertikale në
hyrje, është e bashkangjitur në krye
të një dege në një pemë të ulët. Është i
përhapur në pjesët e Europës jugore dhe
lindore dhe gjithandej Lindjes së Mesme
deri tek disa pjesë të Siberisë, Mongolisë
dhe Kinës.



Kormorani në Dri

Kormoran patok i zi,
Ogiq i madh me zilkë në qafë,
Rend si mbret aty në Dri,
Medet peshqit i bën pilaf.

Obobo me atë qafë të gjatë
Rend si Mjellmë mbi ujë të Drinit,
Ai sqep yti kur rropat,
Ndërron taktikën e peshkimit.

I thua peshkut- Të hapa derë,
Në erdhe brenda o i halitur,
Është se hyre pa trokitur?!

Dora-dorës dhe shumë të tjerë
Rendin e hyjnë ashtu papritur,
I do lala oh t'pacilitur!



Pyetje për Kormoranin

Gjysh, jeton te ne Kormorani,
Pyeti gëzueshëm Ariani?
Tërë ditën zhytet n'Dri
Ai qafëgjatë e pendëlzi,
I zë peshqit për merak,
Nga dy a tre i fut në bark,
Bashkë me Bilbilin peshkatar
Bëjnë plane e pazar:

Ai u fishkëllen atje nga shelgu,
Ky i pret gati te bregu,
Por , ata që kërcejnë përpjetë,
Bilbili i ujit i ha vetë.



Familja PHALACROCORACIDAE,
Lloji *Phalacrocorax carbo*,
CORMORANT,
KORMORANI,
gjatësia 91 cm, të njëjtë nga gjinia, pjesërisht shtegëtar.

Ky kormoran i madh haset gjithandej ujrave të rrjedhshëm anë e mbanë botës, duke i përfshirë këtu; liqenet, lumejtë, grykderdhjet e gjëra të lumejve dhe ujrat bregdetare. Për t'u ushqyer noton gati në fund të ujit dhe me një shpejtësi të madhe për ta zanë peshkun. Peshkun e zënë e sjell në sipërfaqe të ujit për ta gëlltatur me gurmazin e madh. Fluturon duke i rrahur krahët deri sa të arrijë lartësinë dhe pastaj merr hov. Gjatë periudhës së shumimit zogjtë dallohen me një balë të bardhë në kokë dhe krah, gjithashtu u vrehët edhe lustër vezulluese në pendla të zeza. Foleja kaba, në formë filxhani e bërë nga alga deti dhe mbeturinat, të vendosur në një shkëmb të sheshtë apo parvaz shkëmbi; ose fole ngjitur në një pemë. Është i përhapur në Euroazi, Amerikë, pjesë të Afrikës, Azi dhe disa pjesë të Australisë.

Kormorani peshkatar

Krahut shtagën me dy Kormoranë
Oj grua kineze të lodhin pak?
Rend n'peshkim si me dy Bibanë,
Medet nëno sa të bëjnë çirak!

Obobo ua lidh qafën peshq të mos
gëlltitin,
Rend me rend i zhyt ujërave n'peshkim,
Ata plot magazinë heu të çuditin,
N'shportë i zbraz, fytyra t'mbushet
gëzim.

I ushtrojnë përditë ngapak zeshkanët,
Pastaj i marrin me barka nëpër det,
E fëmijët të kënaqen me shujtën e vet.

Shkopi lëshon ngadalë Kormoranët,
Këmbët ua lidhin të mos largohen,
Ata vetëm gjuajnë e shportat shtohen.

Tash e di mirë si gjuhet pa grep
Atje tepër larg diku në Kinë,
Ruajnë Kormoranët në një cep,
Ëmbël klithmat ta mbushin shtëpinë.

Duhet të tillë të ketë sa më shumë,
Inkubimi u bëhet mija vezëve,
Kënd me çerdhe u ngrihet mbi lumë,
Ububu veç arapët t'u shtohen kinezëve!

Ngrënë krahët kur ritualin fillojnë,
Ëmbël-ëmbël vallëzojnë në dashuri,
Klithmë e tyre sa sjell pasuri!

I sheh botës kudo sa i shfrytëzojnë,
Në Kinë e Japoni me djem e çika,
Është e bukur jeta pa "e" me dy pika!

Kredharaku kurorëmadh

Mbi kokë mban të zezën kreshtë,
Bishtin pakëz e ka cubel,
Sykuqët si rrushi në vreshtë,
I ashpër me rivalët n'duel.

Si zhytës liqeni a kënete
Është më i miri peshkatar,
I lumi ai o vëlla për vete,
Rezultatet s'kanë të sharë.

Tërë ditën në ujë rri,
E me sqep përse morritet,
Ndoshta do të heqë mërzë,
Pse e dashura s'i avitet,

Ja zonja Kredhe erdhi,
Merreni vesh me kokë përpjetë,
Sharmin si kajmak e derdhi,
Qafat i lidhet gërshet.

Të çoheni mbi ujë ngadalë,
Në këmbë të bëni parakalim,
Uji të bëhet mjegull mbi valë
Ritual për celebrim!


Kridhuni, kridhuni Kredharakë
Pa tupana hidhni valle,
E luani shotën për merak
Mbi liqene a moçale!

Ju rivalët ndaleni dhunën
Muaji i mjaltit do qetësi,
Mos ia prishni zonjës punën
Maji e ndezi n'dashuri!

Pastaj bashkë i nxeni vezët
Në foletë mbi ujë liqeni,
Çudi bëjnë hallat e tezet
Sa të bukura zoçkat keni!

Tre a katër voglushë xhani
Bardhë e zi pendë kamuflazh,
Flenë sa ëmbël mbi shpinë mami
Si n'anije të bëjnë plazh!

Kënaquni, kënaquni Kredharakë
Ju voglushë të mirë llokom,
Mami juaj zëkajmak,
Me ninula ju vë n'gjumë!



Familja PODICIPEDIDAE,
Lloji *Podiceps cristatus*,
GREAT CRESTED GREBE,
KREDHARKU KURORË MADH,
gjatësia 48 cm, të njëjtë nga gjinia, pjesërisht
shtegëtar.

Është Lloji më i njohur i familjes së kredharakëve, me gjatësi 48 cm. Mashkulli në kokë ka kreshtë, bishtë të shkurtër, pendët e dendura dhe këmbët e përshtatshme për notim. Ushqehet me peshq, larva të amfibeve, kandrra të ujit, etj. Çerdhen e formon në ujë në mes të bimëve të kënetës ose të liqenit. Koha e riprodhimit është maji, ndërsa mbi vezë qëndrojnë të dy prindërit. Është zhytës i shkëlqyeshëm dhe noton shumë mirë. Kredharaku e ka qejf ujin, por, nëse ka nevojë, ai fluturon shumë mirë. Jeton në shumicën e vendeve evropiane e posaçërisht në ato veriore. Kredharaku kurorëmadh është i përhapur në Euroazi, Afrikë dhe Australi.



Familja BOMBYCILLIDAE,

Lloji Bombycilla garrulus,

WAXWING,

KRAHDYLLI,

gjatësia 20 cm, pak ndryshon nga gjinia, shtegëtar.

Zakonisht e hasim në pyjet veriore ku për ushqim përdor mana dhe insekte, ky zog jashtazakonisht është i përhapur gjat tërë vitit madje mund ta shohim edhe në qytete dhe kopshte. Folenë e ka në formë filxhani dhe atë e vëndos në një degë të një druni halor, zakonisht të fshehur me gjethe të shpeshta. Është i përhapur dhe shumohet në Kanada, veri-perëndim të SHBA, në veri të Euroazisë. Në jug ka filluar të mos paraqitet për shkak të dimrit.

Krahdylli

Zbritur je si prej xhenetit,
Oh kreshta e vogël të ka hije,
Gufon gusha prej lezetit
Ulur në shenjë dashurie.

Krahu yt me ngjyrë të mjaltit
Rend me viza bardhë e zi,
Aman bishti shkuar artit
Hënë e verdhë në majë të tij.

Dyert hapur n'poezinë time
Yll të presin n'rima t'saj,
Llampë e ndezur e paskajë,

Bobo ruaju nga ato krime,
O portokall në dritë të hënës,
Mjalt me vija n'tortë të nënës.

Bah si gllabëron kokrra,
Yrysh bën me sqep mbi to,
Cicërrim nuk janë dokrra,
I fton t'vegjlit dosido.

Llap e llap si n'pronë të tij,
Aha xhani sa më kënaqet,
Grahju ore pa kufi,
Ashtu shtohen dhe konaqet.

Rron a s'rron o yll vere,
Ulur n'pemë dhe ëmbël këqyr,
Larë në dritë të hënës n'pyll.

Obobo mjalti n'koshere,
Ulur n'pemë sytë mos i mbyll,
Surprizë bën për ne Krahdyll!



Krahthati

Fare dukesh më i bukuri ndër
skifterë,
Ardhur n'pika nëpër t'verdhen
gushë,
Lolo i bën kudo zogjtë e tjerë,
Cok të shohim si sulesh në fushë.

Obobo për qejfi zonjat të ruajnë,
Për t'zënë Fazana o shpend i zi,
E Krahthat kot që të quajnë,
Re e zezë je në stuhi.

Eh ç'këmbë të bukura n'vija tërthor,
Gama e tyre mbi shpinë renditet,
Rëndë këngë e zogjve nga ti
goditet,

Ih si të mbajnë zonjat në dorë,
Në sytë e zinj ëndrra t'vërvitet,
E unë do thoj kalon limitet!

Familja FALCONIDAE,
Lloji *Falco peregrinus*,
PEREGRINE FALCON,
KRAHËTHATI,
gjatësia 38 cm, pak ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Ky gjuetar i fortë dhe shumë i shpejtë e zë zogun duke fluturuar lartë dhe pastaj vërsulet me një shpejtësi marramendës duke e kapur ate në befasi. Në fluturimin final ai arrinë shpejtësinë deri në 400km/h (250mh). Konsiderohet si fluturuesi më i shpejtë i të gjithë zogjve. Krahthati e godet viktimen dhe e rrëmben me kthetrat e tij dhe e dergon në destinacionin e duhur. Folenë e ndërton në vend të hapët buzë shkëmbit. Shumohet në të gjithë kontinentet perveq Antarktikut. Shtegëton gjat dimrit. Femra është më e madhe se mashkulli. Është Lloji kryesore që përdoret në fajkujtari. Gjoksi ngjyrë portokalli të qeltë. Shumë dëmtohet nga pllumbagjinjtë.



Familja TURDIDAE,

Lloji *Turdus iliacus*,

REDWING,

KRAHKUQI,

gjatësia 19-23 cm, i ngjajshëm në gjini, shtegëtar.

Një zog karakteristikë i pyjeve halore të Veriut të Evropës, duke u zgjeruar në pyje mëshstekne, edhe në zonën shelgut është i përhapur; në jug gjithashtu e hasim në pyje të përziëra, shpesh pranë ujit. Gogja i turpshëm. I madhësisë së mëllenjes këngëtare.

Krahkuqi

Të gjithë të quajnë Krahkuq,
Ububu si duken ata krah,
Rend mbi krimba e s'të shkon huq,
Dale-dale mashallah!

Ule zërin atje n'therra
Se Skifterët mos dëgjojnë,
Iha-thotë-Hutë e mjera-
I kam qejf ngado që shkoj.

Lëri llafet o krahbukur,
Ik në dega e merria shtruar,
Ashtu ëmbël pambaruar.

Cili rrëmbyes do zhdukur,
Ububu më thuaj mik,
Se e vras me tak e tik

Krilla

Sa i bukur t'duket luku,
Qafë e kokë dhe shpinë lëmuar,
Prapa dukesh kuku-kuku,
Si kllasinë e çrregulluar!

Bardhë e hirtë penda jote,
Në qafë larat bardhë e zi,
Bishti marrja e kësaj bote,
Si ta fryejë ndonjë stuhi!

-E kam bishtin kurorë pemësh,
Ku mrizojnë zoçkat e mia,
Mund t' shërbejë për hije
dhenesh,
Kur gjatë verës mjel grania.

Burrin e kam zemërdlirë,
Kurrë nga ai nuk bezeritem,
Mbi vezë bën natën e mirë,
Unë mbi to vetë rri tërë ditën!

Meshkujt janë këngëtarë t' vërtetë,
Me kokë prapa u shkon dueti,
Kur u fishkëllen, kur u bërtet,
Të përgjigjen si Gjelushë deti!

Moj bishtzezë si fshisa e oxhakut
Sot të shohim në çdo shtet,
T'ruajmë si lulen e konakut,
Klithma jote ka lezet.

Të do syri Krillë e bukur
S'ia lë mangut metaforës,
Në ajër dukesh posi flutur,
Kur shkon n'valle dora-dorës.

Ti nga veriu vjen n'Shqipëri,
T'pushosh vjeshtës si tranzit,
Prapë kur kthehesh për veri,
N'mars e n'prill ne të bëjmë pritë.

Në Divjak e n'Karavastaj
Je e shpallur doktor nderi,
Në lagunë si në saraj,
T'hiqet mundi, t'hiqet vveri!



Familja GRUIDAE,
Lloji *Grus grus*,
CRANE,
KRILLA,
gjatësia 112 cm, i ngajshem në gjini,
shtegëtar.

Është shpend i madh (140 cm) me qafë dhe këmbë të gjata. Pendët janë të zhvilluara në krahë dhe bisht, ndërsa pjesët e tjera të trupit i ka lakuriq.

Ka ngjyrë hiri në të verdhë. Ushqehet me drithë, kandrra, amfibë dhe lëvore të fidanëve. Femra bën 1-3 vezë, të cilat i ngroh me radhë me mashkullin, për 28-31 ditë. Jeton pranë kënetave. Është e përhapur në Evropën Veriore, ndërsa te ne haset vetëm duke kaluar shtegëtimin (në vjeshtë) për në Afrikë dhe kur të kthehen në mars ose në prill. Shumohet në Euroazi. Dimrat i kalon në Euroazinë jugore, Afrikën veri-lindore, Indi dhe Kinë.



Familja COLUMBIDAE,
Lloji *Streptopelia decaocto*,
COLLARD DOVE,
KUMRI ME QAFORE,
*gjatësia 30 cm, i ngjajshëm në gjini, jo
shategëtar.*

Pëllumb me ngjyrë të zbehtë me qafore të ngusht të zezë mbi qafë, ky zog dallohet duke kënduar me një muzikë monotone prej tre notave. I hasim në pyje të hapura, ferma dhe në kopshte periferike, hanë fara të egra, drithra, mana dhe ushqim blektoral. Duke fluturuar i vërehën vija bardhë e zi nën bisht. Folenë e ndërton në lis apo edhe nëpër kopshte nën strehë ose edhe mbi platforma rrushi dhe pemë tjera. Nuk janë shumë të kujdesëshëm në ndërtimin e folesë. Është i përhapur prej Europës, Lindjes së Mesme, Azisë, Kinës e deri në Kore. Në Ballkan është e përhapur që nga 1930.

Kumria

Krem në torte penda jote,
Ta përgëdhel sa kam dëshirë,
I thotë syrit të kësaj bote,
Në fokus ta mbash më mirë.

Këtë qafore ku e more
Gugulashe mori bijë?
Me Kumroshin dorë për dore
N'fund të Kukit atje n'vijë.

Guguftu moj xhanane
Me atë zërin turra-turra,
Hidhia Gent në pentagrame,
Pentagramet n'partitura!

Arian ,ç' ma hoqi brengën
Maje pemëve me zë t' hollë,
Pa dëgjo ç' ma paska këngën,
Ia hëngsha me gjithë mollë!

Ty ta hoqa vetë si Qyqe
Thërras tërë ditën o lum miku,
M'i qan hallet motra Shyqe,
Më la vetëm manafiku!

Hajt se kthehet si rreze e diellit,
Kur t' shehë ty shkrihet si bryma,
Kish' marrë mësysh e tash vjen qiellit,
Plaka erë tha-Dje i fryna!

Bullfinqi

Bullfinqi ka ngjyra të theksuara,
Uh sa dominon e portokallta nën
gushë,
Llafazan i zabeleve të gjelbruara,
Fyelli sa bukur të ligjëronë në gushë.

I ke merak të gjitha frutat,
Na thuaj, tridhjetë sytha ha për një
minutë?
Qendisur ke çerdhen aty te skutat,
Iha n'shkurre si filxhan të butë!

Kuqalashi qafkëzi

Kënga jote këngë e fyellit,
Ushton malit Kuqalash,
Qendra e jote mesi i pyellit,
Atje n'dega si një pashë!

Leht ia nis me piu-piu,
Ai sqepziu, sqep i trashë,
Shtruar ia merr si bariu,
I thur notat Finqja vashë!

Qafa jote edhe gusha,
Ashtu bukur mandarinë,
Finqe zogë moj të do fusha,
Ë-ja pikat n'tokë i shtrin.

Zure n'thua oj e përhirta,
E ndjell dashnorin me bisht t'zi,
Zemra i thotë sa të prita,
I shpreh t'gjitha n'stil të ri!



Familja FRINGILLIDAE,
Lloji *Pyrrhula pyrrhula*,
BULLFINCH,
KUQALASHI ÇAFKËZI,
*gjatësia 17cm, ndryshon nga gjinia, jo
shitegëtar.*

Kuqalashi çafkëzi dallohet si zog me ngjyra të theksuara. Dominon ajo e portokallta. Ka kokë të madhe dhe sçep të fortë. Jeton nëpër pyje e zabele. Thirrja e tij karakterizohet me tingullin pju-pju, ndërsa kënga e tij i përngjanë muzikës së fyellit të bariut. Bullfinqi ushqehet me fruta dhe me sytha të luleve. Kur shpërthejnë lulet e pemëve për një minut mund të haj deri në 30 sytha. Folenë e bën të cekt në formë filxhani e thurur me rrënjë, e vëndosur në shkurrë të dendur apo dëllinjë. Më së shumti është i përhapur në Europë. Të grumbulluar në tufa kalojnë përtej Azisë Qendrore e deri në Paqësor. OJQ "Finch" ka propozuar që ky zog të jet ikonë e Kosovës.



Familja ANATIDAE,
Lloji *Anas strepera*,
GADWALL,
KUQLA QAFËGJELBËR,
gjatësia 46-56 cm, i ngjajshëm në gjini,
shtegëtar.

Ka trup të shtypur shpinobarkor, qafë jo të gjatë, pendët e dendura dhe zakonisht me ngjyrë të përhitur në të zezë. Sqepin relativisht të gjatë dhe të shtypur, jo të mprehtë, por të lakuar në formë gremçi. Këmbët e shkurtra dhe të përshtatshme për notim. Jeton në ujë dhe ushqehet me amfiba, krimba, kandrra etj. Femra i bën 9-13 vezë, kurse inkubimi zgjat 22-26 ditë. Ka mish të shijshëm, andaj është zbutur dhe është fituar rosa e butë-A. domestica. Është e përhapur në vendin tonë (Shqipëri e Kosovë) dhe në tërë hemisferën veriore të planetit.

Kuqla qafëgjelbër

Ka këmbët si lopatë,
Ulur n'ujëra pandërprerë,
Qeshet ëmbël ditë e natë,
Lahet bashkë me zogj të tjerë.

Ashtu e bukur kokëzeze
Edhe qafën me dy ngjyra,
Leht unaza e ndan n'dy pjesë,
Ih çfarë shpendi dha natyra?!

Qëllon syri krahgatën,
E sheh mbi ujë e do sfilatën,
Nis me shoqet hallakaten.

E bëjnë zhurmë se si rropaten,
Virrmë e tyre ta kallë datën
Edhe ditën, edhe natën!

Kuqla kënaqet në lagunë
Uh moj jetë qenke llokom,
Qepet ëmbël me dashnorë,
Lahet-thahet s'di sa orë!

Ah për këto dashuriçka
E me ato adete n'male,
Lëre moj më shan naniçka,
Ah naniçkë patriarkale!

Ga-ga-ga pse moj zhdrype
Ububu n'livadh me lule,
Na thuaj pse këmbë ngule?!

Aha, vetë naniçkën e lype,
Vetë naniçkën e gjete,
E po mjaltin në lezete!

Laraska (Shkineshka)

Çikër-çikër gjithmonë n'jetë,
Mbi çdo pemë e mbi drithnik,
Zogjtë e pulës m'i lë t'qetë,
Se të gjuaj moj me llastik!

Çikër-çikër ju vjen miku.
Mos na gënje mos bën hajgare,
S'hyn në punë pastaj llastiku,
Bashkë me shokët t'bëj batare!

-S'më quajnë kot
Laraskë, Sorrëshkinë,
Populli m'i di t'këqijat ndër vite,
Nga t'gjithë këta emra do kesh
trishtim,
Se disa krime bëj brenda dite!

Me lara t'bardha si ballë baldose,
Me bisht të gjatë si manekene,
Krimet Grizhël jo kurrë s'i sose,
Dhe pse fryhesh maje peme!

Për ndonjë zënkë sa alarmoni,
Mbi ndonjë kërmë sa ndiheni
shumë,
S'më lëni t'qet, ikni nga t'doni,
M'i zgjoni nipat sa ranë në
gjumë!



Familja CORVIDAE,
Lloji *Pica pica*,
MAGPIE,
LARASKA BISHTGJATË,
gjatësia 48 cm, i ngjajshëm në gjini, jo shtegëtar.

Bishti përfaqëson gjysmën e gjithë gjatësisë së shpendit. Është i pangatërrueshëm për shkak të kontrastit bardh e zi të puplave dhe formës së gjatë dhe elegante. Në distanca të afërta, puplat duken ngjyrë jeshile e shndritshme, vjollcë dhe blu e feksur. I gjen në një shumëllojshmëri habitatesh duke filluar nga tokat bujqësore me gardh të mëdh e të dendur e deri tek parqet pranë qendrave të banuara të qyteteve. Foletë i ndërtojnë në pemë, ose në shkurre të larta. Hapësira brenda i ngjan një dhome ku shpendi lëshon 5-8 vezë. Ngrohja e tyre nis në prill dhe vezët çelin pas 17-18 ditësh. Ushqehen me insekte. Rrallë hanë edhe kafshë të ngordhura, drithëra, fara etj. Lëshojnë zë të fortë dhe të ngjirur, kurse kënga ngjan si: “çatçatçatçatçatçak”.



Familja HAEMATOPODIDAE,
Lloji *Haematopus ostralegus*,
OYSTERCATCHER,
LARASKA E DETIT,
gjatësia 43cm, i ngjajshëm në gjini,
shtegëtar.

Zog i spikatur, me pendla bardhë e zi, sqepin e portokallt duke fishkulluar me të si "kleep" e bëjnë të njohur këtë zog të brigjeve dhe të baltës. Gjat fluturimit i paraqitet një shirit i bardhë në krah dhe në pjesën e pasme. Sqepi tij si xhilet i mundëson që t'i hap butakët dhe t'i shkoq limpat nga shkëmbi. Dieta përbëhet nga butakët, krimbat dhe peshqit e vegjël. Folenë e bën duke e hapur një gropë me trupin e vet në zall apo kullos. Është i përhapur në Europën Veriore, Azi Qendrore dhe Azi verilindore. Dimrat i kalon sa më në jug të Afrikës, Indisë dhe Kinës jugore.

Laraska e detit

Laraskë e detit sa mirë të thonë
Ardhur je trupit bardhë edhe zi,
Rend përmbi zall e çfarë kërkon,
Ashtu kullotni nga dy- nga tri?!

Sqep të kuq ke, të hollë, të gjatë,
Ke edhe pendlat për mrekulli.
Ato këmbë t'kuqe në fund si patë
E duan detin moj bukuri!

Detit shëtiteni si të ndërkryera,
E sqepin mbani hapur nga vapa,
Të gjitha prijësit i shkoni prapa.

I doni guacat zonja t'përkryera,
T'i keni ushqim drekë edhe darkë,
Obobo si ju ndjell ogçi shark!



Larashi ballëbardhë

Lëre balën aty para
Ardhur ballit si baldosë,
Nëpër dega atje n'ara
Ia merr me një melos.

Uh sa bukur që dëgjohesh
Si këngëtare në pranverë,
Ih kur do të dashurohesh,
Ndërron melosin menjëherë,

Ububu po ai dashnor
Bjer e çohet n'leverdi,
Ih laroshe ç'melodi?!

Cucë e bukur bën me dorë,
Urdhëro o djalë i ri,
Sivjet duam përplot fëmijë!

Familja LANIIDAE,
Lloji *Lanius nubicus*,
MASKED SHRIKE,
LARASHI BALLËBARDHË,
gjatësia 17-18cm, i ngjajshëm në gjini,
shtegëtar.

Shumohet në pyje të hapura me
shkurra dhe lëndina, zakonisht rrin
nëpër shkurre të shkurtëra nëpër
kodrina ku ka gur, pisha, bredh
dhe shkurre me gjemba. Zakonisht
shfaqet i fshehur nga majet e lisave
dhe shkurnajave. Dimrat i kalon në
Afrikë. Eshhtë më i vogli ndër larashët
por bishtin e ka më të gjatë.



Familja LANIIDAE,
Lloji *Lanius minor*,
LESSER GREY SHRIKE,
LARASHI I VOGËL BALLZI,
gjatësia 19-21cm, i ngjajshëm në gjini,
shtegëtar.

Shumohet në terrene të hapura ku ka të mbjellura, fruta, kopshte frutore, plepa dhe pemë tjera të shpërndara dhe zabele (por jo në pyje). Shpesh shihet duke ndejur në tel të shtyllave të telefonit. I mdhësisë së larashit kurriz kuq dhe të përhimë. Duket të jet i qetë po nganjehere e lëshon një zë thirrjeje si të laraskës ‘qeqeqqe’.

Larashi i vogël ballëzi

Larash i vogël ballëzi të thonë,
Ashtu kokën para t’zezë,
Renda-renda krahu shkon,
Ashtu bukur si krahnezë!

Shih si duket n’fluturim,
I ka larat bardhë e zi,
Ik Larash në fshatin tim,
Medet t’qesin mish n’tepsi!

Ih si duket gushë e bardhë,
Voc o voc aty nën sqep,
Obobo si bora n’dardhë
Grumbull këngët zihen n’grep!

E po ajo kënga jote,
Lart e mbushi kupën plot,
Bukuria e kësaj bote,
Ashtu notat lanë me lot!

Llërët t’i përveshësh mirë
Ë-ja lë t’pëlçetë nga malli,
Zog i vogël kam dëshirë
Ik n’solfezhe , të do mali!



Larashi kokëkuq

Lara-lara penda jote
Aty n'kokë me ngjyrë flakëruese
Ndër më t'bukurat e kësaj bote,
I rri mirë të voglës nuse.

Ububu e kuqja kokë
Seç i plasi grabitçarët,
I mbajnë sytë mbërthyer n'tokë,
Si të klithin, t'i çajnë malet!

E po larashanja mëmë
Nesër nisja moj folesë,
Ashtu bukur n'mes t'Moresë!

Të vegjlit tu natën me hënë
Opopo me ty do flenë,
Rresht do pyesin për
mëmëdhenë.

Familja LANIIDAE,
Lloji *Lanius senator*,
WOODCHAT SHRIKE,
LARASHI KOKËKUQ,
gjatësia 17-19cm, i ngjajshëm në gjini,
shtegëtar.

Shumohet në sipërfaqe të hapura
pyjesh me lëndina ku ka të mbjellura,
fruta, kopshte frutore. Zakonisht
ekspozohet nga majet e pemëve dhe
nganjëherë fshihet në to. Ngjyrat i ka
shumë të theksuara dhe kështu duket
shumë i bukur. Ndonjëherë mund
ta hasim edhe në terrene me rërë që
e preferon herë pas here. I rrituri
dallohët shumë lehtë me kokë ngjyrë
kafeje dhe me një shirit të zi mbi sy.
Është shtegëtar tropikal (Afrikë).



Familja LANIIDAE,
Lloji *Lanius excubitor*,
GREAT GREY SHRIKE,
LARASHI I MADH I PËRHIM,
gjatësia 22-26cm, i ngjajshëm në gjini,
pjesërisht shtegëtar.

Zog i përhapur në sipërfaqe të gjëra dhe habitate të ndryshme dhe me sjellje të ndryshme të atij të Europës veriore dhe atij të pjesës jugore, shumohet në pyje të larta mështekne dhe pishave të holla në moqale. Është shtegëtar i distancave të shkurtëra dhe të mesme. Ekspozohet dhe gjuan nga shtyllat e ndryshme dhe pemet me pak gjethe. Sqepin e ka të kthyer në maje dhe kështu nuk e ka shumë të vështirë për ta rrëmbyer prenë. Ushqehet me kandrra, krimba toke, madje edhe me zogjë të imtë. Është prej larashve më i madhi dhe më i fuqishmi, ndoshta edhe më i rralli që duhet mbrojtur.

Larashi i madh i përhitur

Lara t'zeza ka rreth syve,
Ashtu n'krah edhe në bisht,
Renda-renda n'mes të dyve
Ashtu shkruar si me gisht.

Shtruar thua ja o Larash,
I ke notat si sherbet,
Ik e merria në Marash,
Medet vera ka lezet!

Atje thua ja në Bresanë
Dhe pastaj ik shko në Shajne,
Ë-ja budallaqe qan,
I do notat n'pentagrame!

Po Larashe gushëpërhitura
Ëmbëlsirë moj vija-vija,
Rëndë e ka me t'përsëritura
Hiti yt përmbi avllia.

I qes koka Larashhirtit
T'i shtoj miqtë kështu çdo vit,
Ububu nota të shpirtit
Rëndë e kam pa ju një ditë!



Larashi kurrizkuq

Lëndon me ato nota o Larsh,
Atë që ka brengë në shpirt,
Rend e thuaj në Marash,
Ah kjo këngë or s'të bënë dritë!

Shtuar merria mbi kala,
Ë-ja lë të derdhë veç lot,
Të do Prizereni si për vëlla,
Kurrizkuq, të do kjo botë!

Ulërin dhe Gjeraqina,
Rrallë që hesht dhe çdo Skifterë,
I ke notat ylber n'Rrihna,
Zog n'kafez or si ia merr?!

Kurrizkuq o zëmjalt,
Unë të ruaj në gjithë këta lisa,
Qëllon krimbat si me daltë
Ëhë t'vegjlit se ç'filiza!

Familja LANIIDAE,
Lloji *Lanius collurio*,
RED BACKED SHRIKE,
LARASHI KURRIZKUQ,
gjatësia 18cm, dallohen në gjini, shtegëtar.

Ky grabitqar sikurse edhe zogjtë këngëtar ekspozohen në shkurrë dhe kaqubë, duke e pritur prenë e tij nga atje, dhe kështu më një fluturim të shkurtër dhe pamund e rrëmben prenë e tij. Është zogu i cili e ka me lehtë të ushqehet. Kryesisht ushqehet me insekte, ndonjëherë edhe me ndonjë zog dhe kafsh tjera të imta. Folenë e ndërton nga kullosa dhe rrënjët të vëndosur në një shkurre me gjethe të dendura, sidomos në dru therre kaqe të përziera me dëllinjë. Shumohet në Euroazi prej Britanisë e deri në Siberi. Shtegëton në jug, disa prej tyre madje arrijnë deri në Afrikën Jugore. Femra i bën 5-6 ve dhe i lëshon të vegjlit për nja dy javë. Ky lloj kthehet i fundit nga shtegëtimi për t'u shumua. Kur të kthehet nuk ka dyshim se dimri ka ikur më.



Familja ALAUDIDAE,

Lloji *Alauda arvensis*,

SKYLARK,

LAURESHA,

gjatësia 18cm, nuk dallohen nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Laureshë e kullotave të cilin e bën të njohur kënga e tij shumë melodike duke fluturuar. Lauresha e pëlqen kullosen e shkurtër siq janë kullotat. Sikurse edhe laureshat tjera edhe ky ec tokës. Kur zbret për t'i ushqyer të vegjlit nuk zbret drejt tek foleja, në vend lëshohet më larg me qëllim që të mos e vërejë kush se ku i strehohen të vegjlit, pastaj hec deri tek strofulla. Ushqehet me bimë, fara dhe insekte. Folenë e ndërtojnë në formë filxhani në një zgavër në tokë, pjesërisht të maskuar me kullosë. Femra i bën 5-6 ve dhe i lëshon për dy javë. Është i përhapur nëpër kullota gjithandej Euroazisë dhe Afrikës Veriore. Popullacioni i veriut shtegëton në jug gjat dimrit.

Lauresha

Ato pendët tua si të Harabelit,
Laureshë këngëtare zërin si llokum,
Ashtu ëmbël thuaja pa fijen e sherrit,
Ulu n'syrin tim që të do kaq shumë!

Dalëngadalë kur lëshon ato
cicërrima,
Ato nota tetëshe, ato nota t'plota,
Athua n'oborr filloi orkestrina,
Rend në harmoni të çuditet bota!

Vendi yt Laurë është këtu në male,
Endu sa të duash dimër edhe verë,
Nuk guxojnë t'afrohen Huta e
Skifterë!

Surprizë për të dashurin kur nis
rituale,
I ulesh e çohesh nga larg me plot
nder,
Sfida shpejt kalohet, mjalti mblidhet
n'verë!



Lauresha me napkë

Lëri fushat, lëri brigjet Laureshë,
Ato këngë janë për mua a s'e di,
Ububu dhe mali digjet moj mikeshtë,
Rend nga unë se m'robërove ti oj ti!

E ngado me ato flatra nga kaptoje,
Shumë tërheqës zëri yt ai zë i hollë,
Ato nota sa të ëmbla, mjalt në hoje,
Mua moj m'i fal ndër ftua dhe ndër mollë!

E po kreshta jote përmbi kokë bukur rri,
Në thotë gjë vetëm era këtë e di,
Ajo këngën posi vera ta sjellë n'gji!

Prandaj çerdhën unë ta bëra mu në shpi,
Kënga jote mos të ndalet n'mal e n'vërri,
Është e bukur më e bukura n'simfoni!

Familja ALAUDIDAE,
Lloji *Galerida cristata*,
CRESTED LARK,
LAURESHA ME NAPKË,
gjatësia 19cm, nuk dallohen nga gjinia,
jo shtegëtar.

Laureshë guximtare dhe e fortë me kurorë të gjatë në kokë, ky zog gjithashtu njihet edhe për nga fluturimi i rënd dhe i zhurmshëm, me thirrje muzikale. E preferon tokën e zhveshur dhe me vegjetacion, tokën e thatë gjithashtu edhe feramat. Jo si laureshtat tjera ky me kurorë rri mbi shkurrë. Ata zakonisht shihen në qifte apo edhe në koloni të vogla, ushqehen me fara, bimë dhe insekte. Gjat dimrit zakonisht i hasim rreth rrugëve brenda në qytet duke kërkuar fara. Folenë në formë filxhani e bëjnë në një zgavër të thellë në tokë e rregullur me kullosë. Është i përhapur në Europë, Lindjen e Mesme, Indinë Veriore, Kinë, Afrikën Veriore deri në Ekuator.



Familja ALAUDIDAE,
Lloji *Eremophila alpestris*,

Horned Lark

LAURESHA E BRIGJEVE,

*gjatësia 17cm, nuk dallohen nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.*

Kjo laureshë ushqehet me fara, bimë dhe insekte, në tokë të thatë, me gurë dhe të punuar. Gjat pranverës mashkulli e lëshon një zë të ulët thirrës me nota të larta duke fluturuar jo shumë lartë sikurse lauresha. Foleja në formë filxhani në një zgavër. Shumohet në Euroazi, në Amerikën Veriore dhe Jugore. Tufat në kokë i humbin gjat dimrit.

Lauresha e brigjeve

Luhet vallja n'katër anë
Ashtu ëmbël, ashtu bukur,
Ulesh-çohesh posi zanë,
Reprizo Laura flutur!

E ka bishtin si pahitëse,
Shumë të bukur kur e shtrin,
Ato gjeste sa mahnitëse
Të tërheqin n'fokusimë.

Endesh qiellit, endesh malit,
Brigjeve ulesh e gëzuar,
Rend e merre pikën e djalit,
Ih ai t'pretë moj e uruar!

Gjallon brigjeve , këngën derdh,
E asaj s'i dihet pesha,
Vetëm gusha jote e verdhë
E zë fronin ndër Lauresha!

Lauresha melankolike

Laureshë melankolike,
A s'të kam më t'shtrenjtën mike?

Ububu pse zemërthyer
Rend ashtu si e ndërkryer?

E po kthjellu moj njëherë,
Shtrydhe stresin dimër-verë!

Ashtu t'hiqen vreri e mërzia,
Me këngë mbytet xhelozia!

E thuaja-thuaja n'Kuklibeg
Le t'jehojë Saraji n'breg!

Ani delikatja thyhet n'bjeshkë
Nga ti tuten Hutë e Shkineshkë!

Kënga jote atje mbi Pllavë
O sherbeti në bakllavë.

Leht sa leht t'shëronë në zemër
I thotë shpirtit thirrme n'emër.

Kënga shkul lulet e vrerit
E mbjell forcë në fushë të nderit.



Familja ALAUDIDAE,
Lloji *Melanocorypha calandra*,
CALANDRA LARK,
LAURESHA MELANKOLIKE,
gjatësia 18-20cm, nuk dallohen nga
gjinia, pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në tokë të mbjellur dhe në
stepa natyrale. Shtegëton në lindje,
kryesisht banorë i perëndimit. Dimrint
shpesh i hasim në tufa të mëdha.



Familja ALAUDIDAE,
Lloji *Calandrella brachydactyla*,
SHORT-TOED LARK,
LAURESHA KËMBESHKURTËR,
gjatësia 14-16cm, nuk dallohen nga
gjinia, pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në sipërfaqe të thata e të hapura në toka të mbjellura apo edhe në rrafshina të thata. E preferojnë tokën e braktisur me rërë, fushat e mbjellura apo edhe brigjet e detrave.

Lauresha këmbëshkurtër

Luan valle poshtë te guri,
Atje n'majë kush të pretë?
Ububu qenka Lauri,
Ruaje zemrën mos t'pëlçetë!

Eh këmbëshkurtri, patulaku,
Shumë të mbushi moj maraz
Aman thirre se të plaku
Këngës merria me avaz!

Është se unë gjithë mbushem vaj,
Medet kush nuk ma di hallin,
Brigjeve endem të paskajë,
Është se këmbët n'shpiert më kallin.

"Xhuxhe" shoqet kur më thërrasin
Unë si Qyqet n'përrua qaj,
Xhupi m'dridhet n'zemër m'plasin,
E prapë derën hapur mbaj!



Lauresha e pyllit

Laje mori goce, laje ti,
Atë shami të beqarit –o,
Ule zërin moj nga Skifter i zi,
Rend të kapë pastaj obobo!

Endu nëpër dega, endu mori ti,
Shamija të teret nga lotët e tu,
Ai Petrit i malit, ai kthetrazi,
E lë dhe pa këngë pyllin ububu!

Pra tinza tij, bëhu moj gati,
Yllin ftoje nga ta do fati,
E ai vjen me krushq t'i plasë nga inati,

Lullën mban ndezur përvëluar nga malli,
Ikën zemërplasar dikah dhe rivali,
Tuten Gjeraqinat se mos digjet mali!

Familja ALAUDIDAE,
Lloji *Lullula arborea*,
WOODLARK,
LAURESHA E PYLLIT,
gjatësia 15cm, nuk dallohen nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Këtë laureshë të vogël zakonisht e hasim nëpër livadhe pyjesh dhe kullosa malesh: habitat i tij ndonjëherë përfshinë drujë të shpërndarë në të cilin e gjejmë duke kënduar. Ushqehet në tokë me fara dhe insekte. Mashkulli këndon nga dega e pemës apo edhe duke fluturuar shumë poshtë. Folenë në formë filxhani e formëson në zgavër shpesh të mshehur me bimë. Është i përhapur në Europë, Afrikën Veriore, Lindjen e Mesme.



Familja CICONIDAE,
Lloji *Ciconia ciconia*,
WHITE STORK,
LEJLEKU I BARDHË,
gjatësia 115cm, nuk dallohen nga gjinia,
shtegëtar.

Ka trup të zhvilluar, i gjatë deri 115 cm. Sqepin dhe këmbët i ka të përshtatshme për gjuajtje në kënetë, kullota e ligatina. Është mjaft grabitqar, ushqehet me bretkosa, kandrra, krimba, larva, peshq të vegjël, etj. Pas perfunditmit të periudhës së shumimit në grupe të mëdha ose të vogla fillojnë shtegëtimin drejt jugut dhe ate në Afrikë. Femra i bën 4-5 ve por në fund mund të fluturojnë deri në tre zogjë. Folenë e ndërtojnë në lis, ndërtesë ose edhe nëpër shtylla dhe oxhaqe të larta. Gjatë verës jeton edhe në vendin tonë, në Evropën Qendrore e Veriore, kurse në vjeshtë shtegëton në Afrikë, Pakistan apo Indi.

Lejlekët

Ariani për Lejlekët krahkuqë:

Flamingo shkon me biçikletë,
Për çdo ditë ia mori dorën,
Cing e ling nëpër bregdet,
Bën një xhiro me qafëhollën.

Si pikëpyetje t'ngritura tok,
Qafëpërpjetë me sqepin plug,
Kur shkon n'tufë me mija shokë,
Si t'ecën fusha me pambuk!

Ecin qetë e pa gërgule,
Klithma t'ëmbra plot në kor,
Si livadhin me shumë lule,
Kuq e bardhë ta kesh në dorë.



Genti për Lejlekun e bardhë:

Pendëlbardhi ka adet,
Kokën prapë mbi shpinë ta shtrijë,
Rropat sqepin në duet,
Këtij krahkuqi t'ia mërdhijë!

Përmbi çerdhe ç'rituale,
Njërin –tjetrin ëmbël joshin,
Dashuri nisu ngadale,
Shtëpinë n'dega bënë sa koshin!



Familja CICONIDAE,

Lloji *Ciconia nigra*,

BLACK STORK,

LEJLEKU I ZI,

gjatësia 110cm, nuk dallohen nga gjinia, shtegëtar.

Shumohet në pyje moçalore me sipërfaqe të mëdha, me kalimin e viteve mund të shumohen edhe nëpër lumenjë dhe kënetë. Folenë e ndërtojnë lart në lis. Rreth folesë duken si të turpshëm. Kthehen nga shtegtimi një muaj pas lejlekut të bardhë, dhe atë në maj. Verës vijnë edhe te na, dimrit shtegtojnë në Afrikë. Kryesisht ushqehen me amfibe dhe insekte. Pak më i vogël se lejleku i bardhë.

Gjyshi për Lejlekët e zinj:

Ku e morët gjithë atë ngjyrë,
Këmbë e krye fytyrqymyr,
Kush e pati për detyrë,
Që për sytë t'ju bëjë mynxyrë?!

Në këtë natyrë laramane
Është e mira e së mirës,
Nga këto lloje lejlekhane
Zgjidh e merr sipas dëshirës!



Tre Lejlekët

Tre Lejlekë mbi Qollopek
Me këmbë t'gjata e krah t'zi,
Fluturojnë me një yrnrek,
Sa i duan ata fëmijë!

Shihni këta tre aeroplana
Që si rrallë na vizitojnë,
Janë të mëdhenj kokha vigana,
Kë vallë poshtë do bombardojnë?!

Që nga lart vëzhgojnë terrenin
Të gjithë poshtë zbresin me radhë,
Zvarranikëve ua bëjnë veremin
Nget bretkoca në livadh.

Minjtë me t'madhe alarmohen,
Futen n'бира plot bërtimë,
Këta sqepmëdhenj jo nuk largohen,
Kush nga ne pa rënë viktimë!

Tre Lejlekë u nginë byrek,
Zunë bretkoca e zunë minj,
Kur u çuan mbi Qollopek,
N'sqep vallëzojnë dhe ca gjarpërinj!

Këta truplart me sqepin daltë
Po t'na vijnë pakëz më shpesh,
U shtrojmë petulla, rrush e mjalt,
Kot i thërret , kur s'marrin vesh!



Familja TURDIDAE,
Lloji *Saxicola torquata*,
STONECHAT,
LLAFAZANI I GURIT,
gjatësia 13cm, dallohen nga gjimia,
pjesërisht shtegëtar.

Ky zog i shëndosh me fytyrë të mbyllt e ka marrur emrin sipas zërit që e lëshon, kur dy gurë i godasim me njëri tjetrin ‘qet qet’. Shumohet në rrafshina me shkurra, ku rrin mbi kaqube para se ta zë insektin në tokë apo ndonjëherë gjuan edhe në ajër. Folenë e ndërton në formë të filxhanit të cilën e vëndos në tokë ose edhe në kaqubë pak mbi tokë dhe ate me materiale bimore. Shumohet në pjesën më të madhe të Europës, Lindjes së Mesme dhe Afrikës. Gjat dimrit shtegëton në jugë.

Llafazani i gurit

Llafe- llafe që s’të kanë hije,
Ato janë tmerr i konakut,
Fole ore një fjalë burrërie,
Ani t’lënë në ballë t’oxhakut!

Zëri yt në Kep t’Kobajës
Ashtu i ëmbël është mrekulli,
Nëse Hutat s’ndalën Ograjës,
Ikin or perlat në varr të zi!

I thua ato me përplot art,
Gur mbi gur të bëhet mur,
Ububu n’kulm me flamur!

Renditi notat bukur në kartë,
I aranzhoj më mirë se kurrë,
T’i duan llafet në gur he burrë!

Mëllenja

Si fëmijë t'kujtoj manare
Se kishe çerdhe diku n'mulli,
Këngën helm që kurrë s'e ndale
Përmbi varr të djalit ri.

Nota t'verdha sikur hëna
Derdhje zi nga sqepi dyll,
Gjithë atë gjamë që bënte nëna
E shpërndaje jehonë n'pyll.

Ajo flakë që i ndizej brenda
S'e shpërthente dot mërzinë,
Kaq të rënda këto legjenda
Ma tronditnin fëmijërinë!

Përse populli s'duronë zinë,
Ty të shpallen zog fajtor,
Ta lanë barrën përmbi shpinë,
Dirigjent në kor mortor!

Jo për ty nuk është morta,
Ti e ke këngën për fis,
I mbërthyer n'kthetra t'forta,
Ligjëron sa bukur n'lis.

Në Zabel këndon Mëllenja,
Besa shpesh n'vreshta me rrush,
Ia thotë ëmbël me plot ndjenja,
Atmosferën e ndez prush!

Edhe dimrit e shohim n'shpi,
Mbi pullaz me gisht në fyt,
Që me nota shkon mbi ski,
Zogu i zi, ai burri yt!



Familja TURDIDAE,
Lloji *Turdus merula*,
BLACKBIRD,
MËLLËNJA,
gjatësia 24cm, dallohen nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Është i gjatë 24cm, me bisht të gjatë dhe këmbë të fuqishme. Mashkulli është i zi me sqep të verdhë, që këndon shumë bukur. Femra është me ngjyrë të përhitur në të arit. Ushqehet me kandrra dhe larvat e tyre, krimba të dheut, butakë etj. Çerdhen e ndërton në therra dhe kaçuba të dendura. Femra bën 4-6 vezë, të cilat i ngroh për 13-15 ditë. Zakonisht jeton në pyjet gjethrënëse dhe në vreshta. Mëllenja dimrit i viziton edhe kopshtet e qyteteve. Mëllenja jeton në vendin tonë. Ajo duket edhe gjatë dimrit. Është e përhapur në Mesdhe dhe në tërë Evropën.



Familja **ALCEDINIDAE**,

Lloji *Alcedo atthis*,

KINGFISHER,

BILBIL UJI,

gjatësia 16cm, nuk dallohen nga gjinia,

pjesërisht shtegëtar.

I vogël por shumë aktiv, ky bilbil i ujit gjuan përgjat rrëkeve dhe brigjeve të lumejve dhe liqeneve. Fluturon shumë shpejt, bën fluturim të drejtë, duke e ekspozuar ngjyrën e kaltërt në pjesën e prapme të trupit. Vrojtton nga dega e drurit, zakonisht e atij të thatit, lëshohet me shpejtësi në ujë për ta kapur peshkun, zakonisht peshkun e vogël apo krustacet, dhe pastaj kthehet në degë për t'i përbi ata. Ka një thirrje cingllimë të shkurtër. Folenë e ndërton në një tunel të pjerrt në breg afër ujit. Është i përhapur në Euroazi, Afrikë Veriore, në lindje deri në Japoni dhe në jug deri në Indonezi dhe në jug-perëndim të Paqsorit.

Martin peshkatori (Bilbil uji)

Martin peshkatori, o Bilbil uji,
Ato larat tua zi e bardhë n'kurore,
Ruan mbi shelg peshqit se të ra huji,
Të hidhesh në lumë, t'i zësh si me dorë.

I mëshon për dege që t'alivanoset,
Në gojë ai i gjori lëviz si llokum,
Presin të vegjlit, cili do qaroset,
E ndan prenë, hidhesh prapë në lumë.

Shih sqepin tënd të kthyer si kosore,
Këndon lart në thepa atë këngën magjike,
Ah ç'fluturim e ç'zhytje fantastike!

Të shoh në shumë ngjyra dhe vija
kuqalore,
Aman ç'peshkatar i viseve tropike,
Rëndë më flenë në zemër kërcimet
simpatike!



Mëllenja e gurit

Merria këngës n'maje t'gurit,
Ë-ja t'i zbrëtë poshtë dy pikat,
Llafe e llafe për qejf të burrit,
Eh kështu i kanë dredhitë çikat!

Një lojë e këndshme e dashurisë
Ah sa e hijeshon edhe kullën,
Ta di Mëllenjë e bukurisë,
Edhe Mëllenji ia vë vulën.

Gurët janë këndi yt,
Ububu nga shpërndan notat,
Rend e thirr Mëllenj te portat!

Është një zë që ata i mbyt,
Vetëm ti ua shëron zemrat,
E vërtet ty s't'interresojnë emrat!

Familja TURDIDAE,
Lloji *Moniticola saxatilis*,
ROCK THRUSH,
MËLLËJNA E GURIT,
*gjatësia 17-20cm, nuk dallohen nga
gjinia, shtegëtar.*

Shumohet nëpër shpatijë të pjerrta shkëmbijsh malor apo edhe nëpër kullosa të larta alpine malore. E hasim në lartësi mbi 1500m dhe atë më në lartësi se mëllenja e kaltërt e gurit. Zakonisht rrin në maje të shkëmbit, thirr dhe këndon. Kthehet nga shtegëtimi në mars, prill e deri në shtator dhe pastaj prap e merr fluturimin për të dimërua në jug të Saharas. Zog i turpshëm. Ushqimi, insektet, materiale bimore, hardhucë të vegjël. Folenë në zgavër të shkëmbit, nën një gur të madh (popël) apo edhe në tokë.



Familja TURDIDAE,
Lloji *Turdus philomelos*,
SONG THRUSH,
MËLLËNJA KËNGËTARE,
gjatësia 23cm, nuk dallohen nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Zogmepikatë zezanën trupin e tij mëllënja këngëtare është zog i shoqërueshëm dhe ate mund ta hasim në parqe të mbjellura dhe kopshte, gjithandej Europës veri perëndimore dhe asaj juglindore. Habitatit i saj konsiderohet, pyjet e hapura nëpër kodrina mbi qytete dhe fshatra. Ushqehet me pakurizor, kërmilla të rëndomt. Femra i bën 5-6 ve dhe i lëshon për 2 javë. Të vegjlit i ushqen shumë mirë, madje e rrezikon trupin e vet për t'i mbrojtur ata. Foleja në formë filxhani vëndoset në shkurrë apo lis dhe ate e formëson me fije bari, baltë dhe tul druri. Është i përhapur në Europë, Afrikën Veriore, Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore.

Mëllenja këngëtare

Merria këngës Mëllenj në lis,
Ëhë të plasim armiq të tu,
Llërët përvishi, këngën ke për fis,
E kujdes mbi t'gjitha se gjuajnë
kuturu!

Një zë që i lyhet pranverës,
Aman sa ta zgjonë për besë
merakun,
Të vjenë afër dritares e derës,
Këngë që djeg kulmin e oxhakun.

Është se notat i ka të arta,
Nga pemët ia merr vjet për vjet,
Gonxhet kënaqen nga ato të zjarrra,
Ë-ja dy pikat poshtë ngadalë i zbret.

Ta dëgjoj këngën herët në mëngjes,
Ashtu kënga jote si e bardha verë,
Rend e thuaja ditën pa përtesë,
E unë do kënaqem edhe nëse vdes!



Mëllenja qafore

Mëllenjë me qafore të thonë,
Ëhë sa i pëlqen Labit,
Llampë e ndezur gusha nën
konë,
E bardhë si bora e Korabit!

Një shoqe xheloze e paskajë
Ah ç' tha në majë të rrapit:
Medet ajo gusha e saj,
E bardhë si bora e Korabit!

Qëlloi oh sa tepër xheloze,
Ah veç pse t'i pa përreth bandilat,
Fokusonte m'u te trëndafilat!

Obobo pse kështu kjo nervoze,
Rresht bëri s'di e s'di sa kthesat,
E veç djemve t'u digjen ndërresat!

Familja TURDIDAE,
Lloji *Turdus torquatus*,
RING OUZEL,
MËLLËNJA QAFORE,
*gjatësia 24-27cm, nuk dallohen nga
gjimia, shtegëtar.*

Shumohet në vende të larta mbidetare
në terrene të pjerrta gurore dhe
shkëmbore, male të zhveshura, në
Europën Kontinentale, në pyje të larta.
I turpshëm. Ushqehet me insekte,
krimba, mana. Folenë e ndërton në të
qara të shkëmbinjëve, zgavra në mure
dhe streha.



Familja TURDIDAE,
Lloji *Turdus viscivorus*,
MISTLE THRUSH,
TUSHA E MADHE E MALIT,
gjatësia 28cm, gjinitë e njejtë, pjesërisht
shtegëtar.

Kjo mëllenjë e madhe me ngjyrë të çelët, me pika të zeza në pjesën e poshtme barkore, të shumtën e kohës shihet në tokë, ndonjëherë e shohim edhe në lis, nga atje duke kënduar. Ushqehet bashkë me partnerin ose edhe me familjen, duke u ushqyer me invertebororë në hapësirë të gjerë dhe me mana nga lisat dhe shkurret. Thirrja gjat fluturimit është e ashpër, madje edhe bërbelit quditshëm, derisa kënga, e cila është e zëshme dhe melodike, përbëhet nga fraza të shkurtëra muzikale. Foleja në formë filxhani e formësuar nga bari, myshku, zakonisht e bëjnë në ftur të lisit, shpesh më lart se mëllenjat tjera. Është e përhapur në Europë, dhe Azi Qendrore. Disa nga popullacionet shtegëtojnë në lindje. Ndonjëherë quhet edhe “gjeli i shtërngatës” sepse e dëgjojmë duke kënduar madje edhe në fërfëllizat e borës së hershme pranverore.

Mëllenji mburravec

Mëllenjë moj Mëllenjkat mëkoji,
Mirë e mbarë mbi Martanesh,
Meqë Mëllenji moj mërgoi,
Mesazhi mbeti-Mirë mbeç
mbretëreshë!

Merr mindilin mshifi mërrolat,
Menjanoje moj mërzinë,
Mblidhi mizat, mbyti morrat,
Mbijeto me melodinë!

Mbase Mëllenjë melankolike
Mbërrini marrëzia mbi mal,
Medet, mbahu mirë moj mike,
Mendjemadhi mbushet mall!

Marramendet mburracaku:
“Medet mbaroi martes!”
Mendon mërrolat mendjepaku:
“Mbeten medaljon me mbresa!”

Mburracaku me madrigale
Marshon majave me mecenë,
Mbetet meit mal mbi male,
Mos mllëfin mbart mehlëm!?

Mburravec maleve merakoset:
Merr Mëllenja Mëllenjanë!
Meket, mbufatet, matufoset,
Mbetet mediokër n’melodramë!

Merrja Mëllenjë Mërturit, Myzeqesë,
Merrja mirë me marifet,
Mënjanoja mërrolat Moresë,
Mbresë e mbytur moj Mesjetë!

Merrja Mëllenjë Mirëditës, Malësisë,
Mbytyja mbretërinë mercenarëve,
Mbyllja mendimet mërisë,
Mënjane mërzinë mërgimtarëve!

Moreja martire matanë mbeti,
Mbeti mllëfi, mbeti marrëzia,
Mbeti mbrenda mbyllur mbreti,
Motër moj, më mbyt mërzia!

Mos më mërgo i madhi mëmëdhe,
Mbetën mërrorur mbretëreshë e mbret,
Meraku më mbyt moj More,
Mbijetoj mezi, medet, medet!

Mbreti i shkurtës

Medet si e thërret Shkurtën,
medet!

Bukuroshja rri heshtur në livadhe,
Rend te ajo vërtet si Mbret,
E ajo gëzohet për dasmën e madhe!

Te tria thirrjet ia thua ashtu shpejt,
I ke të ëmbla obobo si kajmak,
I do dhe vera për shpirtin e vet,
Shkurta t'përgjigjet me tak-mak-mak!

Kënga jote thirrje mbreti,
Ulet ëmbël përmbi lule,
Rend e vëri verës vule!

Tash asgjë tjetër s'të mbeti,
Ë-ja të duket pak kokëtule,
Se shkoi t'nxehët, mule-mule!



Familja ROLLIDAE,
Lloji *Crex crex*,
CORNCRAKE,
MBRETI I SHKURTËS,
gjatësia 87cm, nuk dallohen nga gjinia, shtegëtar.

Në shikim të parë mund të na përzihet me fëllënzat, por ky zog është më i qeltë nga ngjyra, krahët i ka ngjyrë gështenje që vërehen mjaft çiltër duke fluturuar. Eshhtë shtegëtar pranverorë në kullosa të larta, ugare dhe fusha të mbjella me drithëra, zakonisht e hasim në regjione fermash ku sana pritët me kosë. Meshkujt kthehen nga shtegëtimi më hëret dhe atëherë duken më lehtë mbase kullosa ende është e shkurtër për të mos u dukur. Lehtë mund të shihen kur ngriten me qafë lartë për ta gjetur partnerin dhe për ta thirrur ate me zërin "kreks kreks" dhe kështu e josh femren. Shumë lehtë shkon edhe pas zërit të një megafoni të thirrjes së tij. Pastaj folenë e ngrenë në fushë.

Dieta e tyre përbëhet nga krimbat e tokës, insektet, molusqeve, bretkocave, farave dhe sythat e bimëve. Folene në formë filxhani i cekët i formësuar me gjethe dhe bimë të ndryshme e vëndosur në kullosë ose edhe e izoluar në barë me gjëmba. Eshhtë i përhapur dhe shumohet në Europë dhe Azi Qendrore. Dimrat i kalon në regjionin e Mesdheut dhe gjithandej Afrikës.

Mbreti i shkurtës ka mbijetua duke iu falenderua përhapjes së bujqësisë në shekujt e kaluar kur folenë e bënë në sanë, mbase aso kohe kishte mjaft të tilla. Ndërsa tani me fermt bashkëkohore, përpunimi i sanës në forma mekanike u prish folët këtyre zogjve, vezët, madje i rrezikon edhe të vegjlit e tyre, kështu pra ky zog është rralluar me të madhe. Në disa vënde Europiane, për ta mbrojtur këtë zog, ministritë ambientale të tyre vëndosin gjat kohës së riprodhimit të tyre, ndërpritet çdo prerje e livadheve dhe kullosave ku dihet mire se atypari ky zog është në vllugun e shumimit, dhe kështu fermerëve dhe fshatarve u kompenzohet sana.



Familja MUSCICAPIDAE,
Lloji *Ficedula parva*,
RED BREASTED FLYCATCHER,
MIZAKAPËSI GUSHËKUQË,
gjatësia 12cm, dallohen nga gjinia,
shtegëtar.

Mizakapës shumë i vogël, ky zog shumohet në pyje gjetrënëse dhe të përziera, si në ultësira ashtu edhe në male, qendrojnë në gjethnaja të shpeshta. Ushqehet me insekte që i zen në ajër. Gjat dimrit e preferon habitatin e hapur dhe atë, buzë pyjeve dhe në shkurre. Femra e ka merak mashkullin me fyt të portokallt. Foleja në formë filxhani e thurur me fije bari dhe myshku, e lidhur me fije leshi dhe e vëndosur në zgavër, sidomos në trungun e kalbur të pemës. Shumohet në shumë pjesë të Europës Qendrore dhe të asaj Lindore, gjithandej Azisë dhe Japonisë. Dimërojnë në Indi, Kinën Jugore dhe pjesët e Azisë jug-lindore.

Mizakapësi gushëkuq

Miza e miza sa të duash,
I zë ato tepër me lezet,
Zëri ore të mos vuash,
Ani t'vegjëlit bëjnë përjetë!

Kënga jote këngë pranvere,
Ashtu ëmbël përrënje shtyhet,
Prore thuaja o bir vere,
Ëndrra n'tokë nga qejfi shkrryhet.

Si në mal edhe në fushë,
Ia merr me çifteli,
Ih si çohet ajo gushë,
Zi e kuq për mrekulli!

I ke notat mjalt për vesh,
Gurgullojnë si lumi n'përrua,
Ububu buza më qesh,
Shtruar kur ia merr për mua!

Është se çerdhen e bën n'pemë,
Ku të vegjlit n'shpresa mbesin,
Ushqim duan krimbat nënë,,
Që gojëhapur ty të presin.

Mizakapësi i përhitur

Mizat i ke për qejfi o i përhitur,
Ububu si i përgjon ato nëpër dega,
S'ka nevojë për t'i përzhitur,
Cok në gojë shkojnë si shega!

Ih si lëvizin ata në sqep,
Cucull duken në gojë për ty,
Ashtu i zë si me grep,
Prandaj kënaqu me një a dy!

Ah ç'kënge pastaj ia thua,
S'bashku me bilbilat gojë me gojë,
Ta dua atë zë aty në përrua,
Rend disi e duku n'Opojë!

Ih sa shpejt zbret në livadh,
Atje kërcellat kërcenë orë e çast,
Popo, ja të afrohet një i madh,
Atë rrëmbeje e lala të pastë!



Familja MUSCICAPIDAE,
Lloji *Muscicapa striata*,
SPOTTED FLYCATCHER,
MIZAKAPËSI I PËRHIMË,
gjatësia 14cm, nuk dallohen nga gjinia,
shtegëtar.

Këtë zog të vogël ngjyrë kafeje e hasim si shtegëtar të pranverës në periferi të pyjeve. E ka adet që të rrijë në dru apo tel dhe nga atje ngritet dhe e zë insektin duke fluturuar dhe prap kthehet në vendin e mëparshëm. Foleja në formë filxhani e shtypur, e rregulluar me myshk, fije dhe rrjetë marimange. E vendosur prapa një bime kacavjerrëse apo ndonjë trungu të qarë. Shumohet në Europë, Afrikë Veriore dhe Azi Qendrore. Dimrat i kalon në Afrikë, Lindje të Mesme dhe Indi Veri-Perëndimore. E vërejmë edhe nëpër kopshte tona duke e pritur ndonjë mizë duke fluturuar.



Familja MUSCICAPIDAE,
Lloji *Ficedula hypoleuca*,
PIED FLYCATCHER,
MIZAKAPËSI I ZI,
gjatësia 13cm, dallohen nga gjinia,
shtegëtar.

Shtegëtar pranveror në pyje gjethrënëse, pemishte, apo edhe në kopshte, ky mizakapës i zi është më i fshehtë se i përhim. Kur rrin në pritje të insektit diku në lis ose tel, ngritët duke fluturua për ta kapur ate. Foleja në formë filxhani të cekët e përbërë me myshk, lëvore, dhe rrënjë të mbuluara me pendla në një zgaver të një peme. Është i përhapur në Europë, Afrikën Veri-Perëndimore dhe Siberinë Jug-Perëndimore. Dimrin e kalon në Afrikën tropikale. Edhe në vendin tonë e vërejmë gjithandej mbi vendbanime, në pyje të rë rralluara.

Mizakapësi i zi

Mizakapës më i bukuri je ti,
I ke krahët tamam si laraskë,
Zëri yt është si poezi,
Ah dhe lule që shpërthen në
vaskë!

Këngë e ëmbël është kënga jote,
Anëmbanë ushton në mal,
Pra jehon përreth kësaj bote,
Ëmbëlsirë që të heqë mall.

S'ka si bëhet në livadh pa ty,
I ke notat të bukura , të holla,
I ke të gjata në kopësht te molla.

Zi e bardhë sa më bjer në sy,
I bukuri im para të dola,
U ule n'çerdhe aty te shkolla!



Murgëza veshzi

Murgëz të thonë pse je bardhë e zi,
Uha veshët pse i ke ashtu të nxirë,
Rend e na thuaj pse qan si fëmijë,
Gongu i fatit të rrahu pa mëshirë?!

Ëhë, m'u tret dikah voglushi im,
Zifati më ndoqi keq në jetë,
Ah , kënga ime s'është art , po
mallkim
E më kap për fyti e më vret!

Medet zjarri i mërzisë sa më djeg,
Aman dhe çerdhja mori flakë,
Lotët e shpirtit kush do m'i ndal?

Eja o kureshtar e shih si më ndjek,
Voglushi im vrapon me zik-zak,
E erdhie më hoqi mall!

Familja TURDIIDAE,
Lloji *Oenanthe hispanica*,
BLACK-EARED WHEATEAR,
MURGËZA VESHZI,
gjatësia 13-15cm, dallohen nga gjinia,
shtegëtar.

Shumohet në vënde të hapura me shkurre të shpërndara, në lisa dhe gurë, zakonisht nën 600m mbi lartësinë detare por zakonisht mbi vendbanime, dhe atë në lëndina përgjat rrëkeve në pjerrësira shkëmbore. Është zog shtegëtar, dimrit arrinë deri në jug të Saharasë. Ushqehet me insekte. Folenë e ndërton nën një gurë kokoman, në zgavra në tokë ku ka bar me gjemba (gomaterina).



Familja PLOCEIDAE,
Lloji *Montfringilla nivalis*,
SNOWFINCH,

PAROSI I DËBORËS,

gjatësia 17cm, nuk dallohet nga gjinia, jo shtegëtar.

Habitati i tij janë kullosat alpine dhe jopjellore, shkrepë gurore deri në nivelin e linjes së bores. Parosi i dëborës kryesisht ushqehet me fara. Folenë e nderton në formë filxhani, e formësuar me kullosa, gjethe, lesh, dhe pendla dhe kështu është i vëndosur në një të qarë të shkëmbit apo mur. Është i përhapur në brigje të izoluar malore në Europën Jugore, Turqi, Iran, Mongoli Perëndimore, Azi Qendrore dhe regjionet e Himalajeve.

Parosi i dëborës

Paros dëbore të thonë,
Atje bjeshkëve shëtitesh,
Rend ngadalë e nga shkon,
O në grigje do vërvitesh?!

Sa bukur ligjëron malit,
I ke notat kaq të holla,
Ikën lumit pika e djalit,
Deri t'duket faqemolla!

Edhe pendët bardhë e zi
Bobo krahët zbukurojnë,
Oh sa shtruar qiellit shkojnë!

Rend atje Paros i ri,
Ëmbëlsira të pretë n'përrua
Se atje ke mollë e ftua!



Familja ANATIDAE,
Lloji *Anser anser*,
GREYLAG GOOSE,
PATA E EGËR,

gjatësia 90cm, nuk dallohet nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Kjo patë shihet duke notuar në lumejë, liqejë dhe kënetë, madje gjithashtu mund ta shohim duke ecur dhe vrapuar nëpër barishta dhe kullota. E ka trupin e fuqishëm, sqepin e shkurtër me të cilin i këput gjethet dhe kërcejtë e bimëve, madje edhe i shkul rrënjët për t'u ushqyer. Duke fluturuar, shihet i fuqishëm dhe i drejtë, duke e treguar trupin e spikatur me krahë ngjyrë kafeje. Këta zogjë kur fluturojnë në grupe gjithmonë shkojnë në formën e shkronjes V.

Pata e egër është zog alarmi, patë e dyshimt, duke alarmuar për shqetësimin që mund t'i bëj dikush tjetër dhe kështu e lëshon një thirrje të ashpër dhe të zhurmshme. Folenë e ka të cekët, gati shumë natyrale të vëndosur në tokë, e lidhur me gjethe, ndërsa pjesa e brendshme e zbutur me pendla. Është e përhapur përtej Euroazisë, prej Rusisë Veriore dhe Siberisë Veriore. Dimërojnë në pjesen jugore dhe Afrikën Veriore, Iran, Indi dhe Kinë. Patat e fermes zakonisht janë të bardha dhe ato karakterizohen si pata shtëpiake të llojit të patave të egra.



Familja PELECANIDAE,
Lloji *Pelecanus crispus*,
DALMATION PELICAN,
PELIKANI DALLMATIN,
gjatësia 170cm, gjinitë e ngajshme,
shtegëtar.

Ka ndërtim karakteristik të sqepit. Ka mbisqep të gjatë, ndërsa nënsqepi është i pajisur me një strajcë mjaft të madhë për futjen e peshqve. Pelikanët quhen ndryshe edhe të pangopur, ngase e gjuajnë gjahun me afsh të madh. Gishtat e këmbëve(4) janë të kthyer përpara dhe në mes të tyre është e zhvilluar pëlhuja, me anë të së cilës noton dhe lundron mjaft mirë. Nuk ka aftësi të zhytet, por peshqit i zë me sqepin e gjatë. Jeton pranë ujit dhe në ujë. Bën vezë njëherë në vit dhe mbi to qëndron 42 ditë. Është i përhapur në Evropën Jugore e veçanërisht në Shqipëri dhe është shpendi më i madh i vendit.

Pelikani kaqurrel

Pelikani kaqurrel,
Pendëlbardhë e bisht cubel,
Duket shpend koxha i gjatë
Me dy këmbët si lopatë.

E nënsqepin çfarë e ka?
Strajcë të kuqe për hata,
Aty peshqit pushojnë pak,
Deri t'hidhen në stomak!

Jeton n'ujë , jeton n'lagunë,
Dhe amfibet i do shumë,
I shkon ujit rreth e rrotull,
Gjuetari i pangopur!

S'ka aftësi që të zhytet,
Jo që tutet se po mbytet,
Po me atë të madhin sqep,
Gjuan ditën si me greq!

Riprodhohet njëherë n'vit,
Mbi vezë rri mbi dyzet ditë,
Në Shqipëri n'det të paskajë,
Rri n'Divjak e n'Karvastaj.

Ka nënsqepin o moj mike
Strajcë të fshisës elektrike,
Edhe deti e ka për nder
Ta pastrojë kështu përherë!

E do syri plot me mall,
Se e kemi për sugar,
Është më i madhi ndër të tjerë
Këtu tek ne ky kaqurrel!

Papagalli Ara

Papagalli Ara i viseve tropikale
Amerikën e ka si vendlindje të tij,
Pa shih ngjyrën blu sa duket krenare
Ai sqep masiv si dashi me turi.

Gërget kalimtarët, qeshet, pëshpërit,
Ajo ngjyrë e verdhë i shkëlqen në
gushë,
Llampë e ndezur është për pyjet pa
dritë,
I ndriçon ato monogami prush,

I ka katër kthetra si gishta të dorës,
Merr e jep me to si të është njeri,
Andej-këndeje endet, bën akrobaci!

Dhe këngës ia merr, valles edhe
horës,
I çudit përreth shtazë e shpendëri,
Vetëm lë t'jehojë ajo xhungla e tij!

I ndershëm je or ti, zë i së vërtetës,
S'ta do syri tjetrën ngado që kalon,
E mban për grua o besnik i jetës!
Vetëm njëzën zonjë që kurrë s'të
tradhëton!

Edhe të tjerë Ara duken sikur flutura,
Të përhiturit dinë si fëmijët të flasin,
Rendin nëpër kurse të zonjat e bukura,
Oh me lot në sy të qeshin, të plaslin!

Papagall i kaltër o qiell i bukur vere
I kënaqi sytë sa herë që të shoh,
Këngët edhe vallet sa mirë që t'i njoh!

Ara-arra shqiptojë dhe kësaj here,
Lidhe mirë në fyt se je intelgjent,
E bota lë t'çuditet, të mbetet pa mend!



Familja ARARAUNIDAE,
Lloji *Ara ararauba*,
BLUE AND YELLOW MACAW,
PAPAGALLI ARA,
gjatësia 90cm-1m, nuk dallohet nga
gjinia, pjesërisht shtegëtar.

Është shpend i madh (deri 1 m) i Amerikës Jugore dhe Qendrore. Ka pendë me ngjyra të forta dhe mjaft të bukura. Gishtërinjtë i ka të ndarë, dy përpara e dy mbrapa, i nevojitet që më lehtë të kapet dhe zvarritet nëpër drunj, në të cilën i ndihmon edhe sqepi masiv i kthyer dhe i mprehtë. Bashkëshortët nuk ndahen gjatë tërës jetës (monogam). Papagajtë në tërësi shquhen për nga "inteligjenca" dhe ngjyrat e bukura për shkak të të cilave kultivohet nga ana e njeriut në shtëpi. Është i përhapur në pyjet tropikale të Amerikës.



Familja COLUMBIDAE,

Lloji *Columbia livia*,

ROCK DOVE,

PËLLUMBI I GURIT,

gjatësia 32cm, gjinitë e ngjajshme, jo shtegëtar.

Është i gjatë 32-34 cm, ndërsa gjatë hapjes së krahëve arrin deri në 63-69 cm. Si dhe dy pëllumbat e tjerë është përgjithësisht gri me fundet e krahëve në ngjyrë të zezë dhe me një njollë të gjelbër në qafë. Por nuk ka pulla të bardha në krah, as në qafë si pëllumbat e shkëmbit.

Mund të ndeshën në tufa të mëdha, por në përgjithësi tufat etyre janë më të vogla në numër se sa në rastin e pëllumbave të tjerë. Edhe pse i njohur si shpend i fushave dhe parqeve, ndeshet poaq shpesh edhe në shkëmbinj edhe në bregdet.

Folenë e ndërton në zgavrat e pemëve dhe në të çarate shkëmbinjve. Lëshon dy vezë në muajin mars dhe më pas. Të dy prindët marrin pjesë në ngrohjen e tyre, proces i cili zgjat 16-18 ditë. Të vegjlit fluturojnë pas katër javësh. Ushqehet me drithëra, fara, gjethe jeshile, rrënjë etj. Zëri i tij është i fortë dhe ritmik, rrokjen e dytë të shkurtër: “uuu-uuu”. Kjo këngë dëgjohet kryesisht nga shkurti në korrik.

Pëllumbi i egër

Pëllumb i egër kot të thonë,
Kur tërë ditën rri n'pullaz,
Gu-gu-gu ia bën n'ballkon,
Me gu-gu dhe unë kur t'thërras.

Pendëlhirti i kaltër-o
Që rri qiellit n'fluturim,
Je në mal e fushë kudo,
Qengi i butë për shpirtin tim.

Me Kumrinë e Turtulleshën
Gjithë në trio pse ia thua?
Jam hidhëruar me pëllumbeshën,
Mbretëreshë që shumë e dua!

Si piano n'mes t'violinave
Me Gugushet mirë ia çoj,
Larg në Lug të Gjeraqinave
Lum kush është të na dëgjojë!

Dhe ashtu siç sillet bota,
Në pullaz shkon rrotullimë,
Jo gugutë nuk janë të kota,
Duhet shtuar pëllumbërinë!

Nga shënmitri në shëngjergj
Në Sharr dimri t'vretë si plumb,
Zbute dhembjen mos u dergj
Me gugutë i egri Pëllumb!

Kur merr qiellin tufë e hirtë
Dhe përcjell fëmijët për shkollë,
I thotë dimrit-A ke shpirt,
Ku e çon gjithë këtë dëborë?!



Familja COLUMBIDAE,
Lloji *Columbia palumbus*,
WOOD PIGEON,
PËLLUMBI I PYLLIT (gugashi),
gjatësia 42cm, gjinitë e ngajshme, pjesërisht
shtegëtar.

Pëllumb i madh dhe i rëndë, me bisht dhe krahë të gjatë dhe me një krahëror shumë të dalë. Gugashi dallohet nga vija e bardhë e krahëve, brezi i gjerë e i zi në fund të krahëve dhe nga njollat e bardha në anët e qafës. Në vjeshtë dhe në dimër, specia grumbullohet në tufa që arrijnë në qindra individë. Është i përhapur në toka bujqësore afër pyjeve, parqeve, pemëve halore, pyjeve gjethërrënës dhe plantacioneve. Foletë i ndërtojnë në shkurre, gardhishte, pemë, shkëmbinj, etj. Lëshojnë dy vezë kryesisht në prill ose maj. Që të dy partnerët marrin pjesë në ngrohjen e vezëve, proces që zgjat 17-19 ditë. Ushqehen kryesisht me fara. Kënga më e njohur guu-guu-guu-guu-guu! Edhe tek ne është shumë i përhapur, në vjeshtë mblidhen në tufa të mëdha dhe ate nëpër tela të lartpërquesve elektrik.



Familja COLUMBIDAE,

Lloji *Goura victoria*,

KING PIGEON,

PËLLUMBI MBRETEROR,

gjatësia 32cm, gjinitë e ndryshme, jo shtegëtar.

Është shumë i bukur, por në veçanti bukuria e tij është kurora e puplave në kokë. Jeton në pyjet e ujëdhësive të Azisë Juglindore.

Pëllumbi mbretëror

Kurorën e ke posi krahnezë,
Që të tillë s'e ka askush,
T'gjitha zoçkat sa i ndez,
Beso pëllumbo, bëhen prush!

Mbi shpinë tënde ka pak kafe,
Mos ta derdhi nusja jote?
Lëri t'ëmbra ato llafe,
S'ka t'paguar n'sy t'kësaj bote!

Kurorëvesa sheqer n'shkop
Që e lëpijnë nxënësit në shkollë,
Një , dy, tre me hajde hop,
Pse ma bëre Pëllumb me dorë?!

E ku shkove që s'më more
Fluturim në kaq shumë kthesa?
Larg në Azinë Juglindore,
Ku mund t'humbësh në aq
ujdhesa!

Si përkrenare ajo kurorë
E ushtarëve në Antikë,
A s'ishe postier në shi e borë
Duke lidhur mik me mik?!

Të gjithë më thonë të lumtë dora,
Që bashkove mbretëritë n'botë,
Ndaj dhe emri e kurora
Nuk më mbetën ashtu kot!

Pinguini mbretëror

Pinguinja thërret me klithma
n'dashuri,
I dashuri përgjigjet mjalt në karneval,
Ngrenë kokat e ulin te dy n'harmoni,
Gamë e saj zgjerohet ëmbël n'ritual.

Ulen, çiftëzohen ta kenë t'vetmën vezë,
I besohet burrit deri të çelë zoçka,
Në shputa ai e ruan nga ndonjë
eskimez,
I thuhet pastaj mamit, merre se t'qanë
loçka!

Mkoje mami, mkoje, se është i uritur,
Boll qëndrova anash deri erdhi n'jetë,
Ruaje tani ruaje me peshqi në det!

E një gjë të tillë ai mëzi ka pritur,
Ta di sa gëzohet për mamin e vet,
Ë-ë qan me t'madhe kur ai ty të pretë.

Rëndë e ke Pingo t'jetosh n'Antartik,
Ole t'u thëret n'grishje rrezeve të
diellit,
Rëndë tepër rëndë si n'honin skëterrik,
I ftohtë është shikimi nën kupë të zezë
të qiellit.

Ah ç'notues, del nga uji si gjyle topi,
Në këmbë rri si nuse, ushtar në kufi,
Të gjithë me ato valle ç'i plasi, ç'i kopi,
Ani bukurosh, ani, avangardi bardhë
e zi.

Rend në marsh nga hallet e sevda,
Të gjithë vizitorët t'i takosh si miq,
Ikën e nuk trembet nga ari polari.

Kuku për të dasmë bëjmë në akullnaja,
Ulet e shikon ai i bardhi ogiç,
Të gjithë ne ia marrim të plasë ziliqari!



Familja SPHENISCIDAE,
Lloji *Aptenodytes forsteri*,
EMPEROR PENGUIN,
PINGUINI MBRETROR,
gjatësia 115cm, gjinitë e njejtë, pjesërisht
shtegëtar.

Është më i madhi ndër pinguinët,
me gjatësi 90-115cm. Trupin e ka të
mbuluar me pendë të dendura dhe të
yndyrshme për të penguar depërtimin
e ujit në lëkurë. Gati gjatë gjith kohës
noton dhe zhytet duke gjuajtur peshqi,
kryekëmborë etj. Trupi i tij i përngjan
thesit. Është karakteristike se femra
bën vetëm një vezë, të cilën e ruan
mashkulli. Nuk bën fole. Mashkulli
vezën e vë në shputë të këmbëve dhe
qëndron mbi të 64 ditë. Dhe kështu ai
e humb gadi gjysmën e peshës së trupit
të tij, për ta zëvendësuar atë pasi të jet
kthyer e ëma e të voglit. Vetëm pas
çeljes femra kthehet te zogu i saj. Jeton
në brezin polar të Antartikut.



Familja LARIDAE,
Lloji *Larus ridibundus*,
BLACK-HEADED GULL,
PULËBARDHA E ZAKONSHME,
gjatësia 41cm, gjinitë e njejtë, shtegëtar.

Është e madhe deri 41 cm, me ngjyrë të bardhë, krahë të përhitur, kokë me sqep të kuq dhe këmbë të kuqe. Në mes të gishtërinjve ka pëlhurë për notim. Jeton në dete, liqene, kënetë dhe afër lumenjeve. Ushqehet me kandrra, larva të tyre, krimba, etj. Femra në çerdhen e saj bën 3 vezë, të ngjyrosura, që i ngroh me mashkullin për 20-23 ditë. Pulëbardha është e përhapur në Shqipëri, Kosovë dhe në tërë Evropën. Nga viset veriore shtegëton në Mesdhe.

Pulëbardha

Dimrit vjen te ne pa tutë
Mantelbardha e uruar,
Të ftohtit nervat ia zbut
Sa herë është i egërsuar.

Si fëmijën me t'mirë e merr,
Me klithma përreth lumit,
I hedh sipër pak sheqer
Edhe borës së fundit.

Nga kalaja nis e thërret
Në ballë të himnit pranveror:
-Mbaju dimër, s'ke çka pret,
Mos po do mimoza n'dorë?!

Moj bija e konakut,
Që deti ty të ftonë,
Mysafire n'ballë t'oxhakut
Sa herë vjen n'qytetin tonë!

Buzë e këmbë të kuqe,
Pse i fsheh nga ne në lumë?
Si t'je rritur mos bën huqe,
Të çojmë nuse diku n'Krumë!

Ti s'e di sa i sjell gëzime
Prizerenit, Shadërvanit,
Ti nuk je veç Pula ime,
Je e Gentit dhe Arianit.

Pulëegra

Pulëegra pika-pika
Doli malit të shëtitë,
Kërkon shoqe, kërkon çika,
Ç'të bëjë vetëm ditë për ditë?!

Këtu në Alpet shqiptare
Nuk ka shokë as shoqe tjera,
Do së paku të heqë valle
Sa ta çelë syrin pranvera!

Gjel i egër u hidhërua,
Si shkon dita pa dashnore,
Do së paku të ketë grua,
T'i merrë t'vegjlit dorë për dorë!

Me dyrbi zonjushën pa,
Zemra seç iu mbush gëzim,
Po Shqiponja mbi u ra,
Që te dy ndërruan drejtim!

Kot e thërriste lis më lis,
Këngë e tij helm e vrer,
-Kjo Zogushë s'e ka për fis
Të shkojë nuse për të tjerë?!

N'Pirineje vallë u trete,
Në atë Spanjë për mbret të marrë?
Moj fisnike jak në vete,
Ymer agën e ke n'Sharr!

U takuan krejt rastësisht
Tanushe me aga,
Fryhej Gjeli n'gushë e bisht
Si ta kish' Gjeldetin vëlla!

Vunë kurorë ditën e verzës,
Dhe festuan me shpendët tjerë,
Ngritën çerdhe n'Gllajnishtë
t'Breznes,
Plot vogëlushë të kenë këtë verë!



Familja PHASIANIDAE,
Lloji *Tetrao tetrix*,
BLACK GROUSE,
PULË E EGËR (gjel i egër bishtlirë),
gjatësia 55cm, gjinitë e ndryshme, jo shtegëtar.

Kjo pulë e egër jeton në fundet e pyjeve dhe shkurrave, nganjëherë e shohim në degë të lisit dhe ndonjëherë duke ndejur në hu. Zakonisht ushqehet me sythat e drujve, gjat verës ushqehet edhe me insekte. Në pranverë mashkulli luan vallen e tij garuaese në një cop pazhiku të quajtur "lek". Ata ngriten në ajër duke i rrahur krahët dhe kështu lëshojnë zë joshës. Femra e viziton lekun, bashkohet me mashkullin e pastaj inkubon vetëm, në fole. Foleja, një grop në tokë e fshehur nga vegetacione të shpeshta. Eshtë i përhapur në Euroazi dhe atë prej Britanisë e deri në Siberi. E hasim edhe tek ne në Malin Sharr, Koritnik, dhe Malet e Shqipërisë.



Familja OTIDIDAE,
Lloji *Otis tarda*,
GREAT BUSTARD,
PULA ME MJEKËR,
gjatësia 100cm, gjinitë e ndryshme, jo
shtegëtar.

Qafa dhe këmbët e gjata i japin pulës me mjekër pamje interesante dhe atë në habitatin e kullosave të gjëra. Leviz dhe ec ngadale, nuk fluturon shpesh. Në pranverë meshkujt në grupe i luajnë dhe e joshin femrën, në një vend të veçant ceremonial. Femra i lëshon vezët dhe i inkubon ato pa ndihmën e mashkullit. Dieta e tyre përbëhet nga bimët, insektet dhe krijesat tjera të imta. Folenë e bën një gropë në tokë, shpesh e fsheh në të korra dhe bar të gjat. Shumohet në Spanjë, Marok, Europën Lindore, Azinë Qendrore dhe Lindore. Dimrat i kalon në jug të këtyre vendeve.

Pula e madhe e livadheve

Pa shih se ç'katonë ma hijeshoi livadhin,
Uh ç'qafë e bukur hidhet përmbi bar,
Lëre ore lëre, pa shih Gjelomadhin,
Avangardë e gështenjave që piquen në zjarr!

Edhe përmbi lule paska lule tjera,
Mahnitin me klithma kur dalin n'shëti,
Ato qafëgjatat të bukura si vera,
Dhunti e natyrës që shtrihet n'pakufi.

Edhe zoçkat tua prapa kur t'gërgasin,
Edhe sinfonitë ndërrohën në fytirë,
Lëngu u shkon notave për ngjyrat përmbi ngjyrë,

Ih nga zë i tyre edhe lulet plasin,
Vete tufa qiellit si një mjalt i fryrë,
Ah bardhë e kaftë këqyre more këqyr!

Dhe livadhi mbetet me gishta në gojë,
Edhe ritualet janë në pambarim,
Vetëm kur i sheh Gjelat si bëjnë lojë,
Ehe sa përvëlohet vërtet syri im!

Dhunti mbi dhuntitë moj e lumja nënë,
Endet Pulë e madhe për pak dashuri,
Gjeli shpalon pendët si sonda në hënë,
Eh çfarë gjoks i fryrë zambaku mrekulli!

Lumi unë për ty pambuk i plasaritur
I lëshon krahët prapa dashi në shpërthim,
Ik o rivalgjori se dhëndri të fshinë!

Sa para t'kushtonë kjo lojë e papritur,
A s'na thua Gjelko në parakalim,
Jeta është e ëmbël vërtetë kur ka gëzim!



Pulat e mia

Pulat e mia të fëmijërisë,
O jo s'ju thërras kotnasikoti,
Eni njëherë në log të pleqërisë,
T'i kënaqi ëndrrat si dikur moti!

Ishte kënaqësi t'ju pritja te koshi
Deri kur bënit atë vezë të uruar,
Ik- më thoshin- po vjen ai Zijoshi,
Keq më sulmonte ai Gjel i mallkuar!

Urra-urra-bërtitnim për verzës,
Rendnim malit si shoqëri
kreshnike,
Motrat këndonin këngët lirike!

O ç'bukuri ngado rreth Breznes,
Tikërr-tikërr erdhi pranvera
mike,
Ishte për mua një festë simpatike!

Në mal me krande ndizej dhe zjarri,
Është kënaqësi pranë tij të qëndrosh,
Është vullkan lavash nga buron
malli,
Nënës në dorë lule t'i çosh!

Dora e saj sa m'ledhatonte,
Rrokesha n'grykë me atë mamush,
Ah sa më donte, sa më uronte,
Të dyja faqet m'i bënte prush!

E n'grykë i thoja –Sa shumë të dua!
Verëza nënë erdhi, ke morra e
pleshta?!
Oh sa shumë lutte ta marrë
shëndetin!

Gomari i çoi bir pleshtat në përrua,
Lule të pretë ty shkolla e vjeshta,
Ah moshë e vjetër sot ç'ma shtjerr
detin!



Familja UPUPIDAE,
Lloji *Upupa epops*,
HOOPOE,
PUPËZA,

*gjatësia 29cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.*

Në kokë ka pendë të gjata në formë të kurorës dhe sqep të gjatë dhe të hollë. Pendët e trupit kanë ngjyrë ndryshku, ndërsa krahët dhe bishti ngjyrë të zezë me lara të bardha. Ushqehet me kandrra dhe larvat e tyre. Femra bën në çerdhen e saj 6-7 vezë të cilët i vëndos në zgavër të një trungu, ngrohja e të cilave zgjat 16-20 ditë. Është e përhapur në Shqipëri, Kosovë dhe posaçërisht në Evropën Veriperëndimore.

Shtegëton në vjeshtë dhe kthehet në prill. Nese e hasim pupëzën duke u shumuar në jug të Saharasë duhet ditur se ata janë zogjë të veqant.

Pupëza

Kush nuk të qetë ty koka,
Kokën ia blofsha ndër gur
t'mullirit,
Kurorë e artë t'peshonë me oka,
Penda jote fijë e kallirit.

Që sa kohë Pëllumbi mbretëror
Dorën tënde ta kërkoj,
T'jeni çifti më përrallor,
N'guidë t'zogjve pararojë?!

Moj flokëartë u bëre dyll
Për fjalë t'ëmbra t'kureshtarit,
Shpërblim kandrra do kesh
n'pyll,
Plot bubrreca në majë t'malit!

-Të shkoj nuse larg n'Azi,
Tek ujëdhesat pambarim,
I them shkuesit faqezi,
Për princ kam Pupëzorin tim!

Në panel po t'isha ftuar,
Këtë mirë ruaje vath në vesh,
Moti ju kisha bashkuar,
Sikur mbretin me mbretëreshë!

Kudo gjendesh nëpër botë,
Shpesh të shoh dhe në Opojë,
Çerdhja jote mjalt në gotë,
Sa herë emrin ta marr n'gojë.

Pipitët pingrojnë

Pipitët pandërprerë pingrojnë,
Përditë, përnatë, përherë,
Piu-piu përformojnë,
Përplot prije, plot pranverë.

Pipitët pupazi pupërrohen,
Përqëndrohen përrrenjve,
përformojnë,
Pipiritkat pranojnë, përturpërohen,
Prapë pranë Pipitëve përfundojnë!

Prite pranëvete Pipirite,
Prite-prite pelegrinin,
Prit e prit përrrenjtë pëlcite,
Përrurove përmallimin!

Përtej panjave Pipitushet
Përformancën përtërinë,
Përvëlohen popo prushet,
Pse përlojnë Pipitinë!

Pe Palush Pipitushet,
Panelin plotepërplot pelin?
Presin pranë Pipitmbushët,
Presin papanë pelegrin!

Papa Pipitër papa,
Papa Pipitushe pa pra,
Papa Pipitmama,
Papa, papa, papa!!!



Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Anthus trivialis*,
TREE PIPIT,
PIPITI I LISIT,
gjatësia 14-16cm, gjinitë e njejta,
pjesërisht shtegëtar.

Zakonisht shumohet në pyje të hapura. Verës shtegëtojnë në Europë, ndërsa dimrit në Afrikë. I përngjan pipitit të livadhit, por ky lloj sqepin e ka më të trash.



Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Anthus gustavi*,
RED-THROATED PIPIT,
PIPITI GUSH-KUQ,
gjatësia 14-15cm, gjinitë e njejta,
shtegëtar.

Shumohet rrallë në male të zhveshura dhe tundra në Europën më veriore, në moçalishte në zona shelgu, gjithashtu edhe në pyje me druj mështekne. Dimrin e kalojnë në Afrikë dhe Lindjen e Mesme.

Pipiti gushëkuq

Prite koxha gjatë deri hyre në poezi,
Iu dhe fletëve të m'i sjellësh inspirimet?
Prandaj nuk vonove o Pipit i ri,
I solle vargjet,rimat, zbukurimet.

Ta them shkoqur, je më i bukuri ndër të
tjerë,
I ke ato lara të bëra si me dorë,
Grahi krahëve sa herë sheh Skifterë,
Ulërijnë ata si ujqit në dëborë!

Shtroja këngës n'dega o i pabehonë,
Është e udhës gusha të shkëlqejë,
Kënga jote t'ushtojë tejpertej!

Ulesh e çohesh sa herë cicërron,
Qe besa kurrë nuk të gënjej,
I këndshëm je sa herë të ushqej!



Pipiti i kuqërremtë

Pllajnikun ndonjëherë e ke vizituar-
I the te Zasoja një tjetri Pipit?
Pllaja e artë e Nikut shumë lart ka
qëlluar,
I do të gjithë zogjtë të shkojnë në vizitë.

Te Pllava e pyete Pipitin e lisit:
I ke merak degët e Lisit të Kingjës,
I ke merak a jo o zogu i fisit,
Kur i këndon mamit, dadës edhe
inxhës?!

U shtron pyetje të gjithëve me radhë,
Qëllimi yt t'qëndrojnë në Opojë,
Ëndrrën ua lexon si zambak të bardhë,
Rrallë ka të tillë që nuk kyqen n'lojë!

E mbi të gjitha penda jote e kaftë,
M'i radhit bukur vargjet nëpër rima,
Të dua i kuqërremtë, e keqja mos të
ngaftë,
Është se sot rrëmbyesit i futa në trina!

Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Anthus campestris*,
TAWNY PIPIT,
PIPITI I KUQËRREMË,
15-18 gjinitë e njejtë, shtegëtar.

Shumohet rrallë në kodër rëre, toka
të hapura rëre, gropa zhavorri dhe në
vënde të hapura në Europën jugore,
gjithashtu edhe në male të shkreta.
Dimrat i kalojnë në Afrikë.



Familja MOTACILLIDAE,

Lloji *Anthus trivialis*,

TREE PIPIT,

PIPITI I LISIT,

14-16cm, gjinitë e njejta, shtegëtar.

Shumohet në pyje të hapura. Shpesh e hasim në plantacione halore. Dimrin e kalojnë në Afrikën Veriore.

Pipiti i lisit

Pse të quajnë Pipit i lisit,
I ke merak degët e tij?
Prandaj nga lart i fishkëllen misit,
Ia merr ëmbël, ajo të të vijë!

Të duhet kohë ta bësh për vete,
Ë-ja të hiqet nga alfabeti,
Të ulesh e çohesh me marifete,
E Bukura e Dheut të shkelë në derë
mbreti!

Lisi për ty është pika e vrojtimit,
I sheh rrëmbyesit se si përfliten,
Sa shpejt të tjerët dikah vërviten!

Ata ia mbathin rrugës së shpëtimit,
Vetëm nga ata të mos kollofiten,
E unë për ju të mos mërzhitem!



Pipiti i livadhit

Pendlat i ke si të Harabelit,
I ke dhe larat e theksuara,
Prandaj ruaju prej Skifterit,
I ka thikat të lakuara!

Të gjithë Pipitët sa jeni,
I Ujit, i Lisit dhe ai Gushëkuq,
I Kuqërremti thotë dhe mua vëlla më
keni,
Lart në dega të mblidheni truq!

I Livadhit si lulet ju do,
Varur me gongxe përreth tij,
Ashtu bukur n'sinfoni,

Dhe t'ia merrni këngës dosido,
Iha të çuditet edhe bota,
Të plasin rrëmbyesit me qëllime
t'kota!

Familja MOTACILLIDAE,
Lloji *Anthus pretenses*,
MEADOW PIPIT,
PIPITI I LIVADHIT,
14.5cm, gjinitë e njejtë, pjesërisht
shtegëtar.

Zog ngjyrë kafe vija vija i cili jeton në kullota dhe kënetë. Pipiti i livadhit fluturon ngadale dhe i matur dhe lëshon zë angullues. Vrapon dhe hec në tokë të hapur, duke marrur insekte, krimba, dhe fara. Interpreton këngë duke fluturuar dhe lëshohet si me parashutë. Folenë e bën në formë filxhani me kullosë, kërcëj dhe e vëndos në një gropë në tokë. Është i përhapur prej Grenlandës e deri në Azinë Qendrore. Disa prej tyre shtegëtojnë në Afrikën Veriore.



Familja MOTACILLIDAE,

Lloji *Anthus spinoletta*,

WATER PIPIT,

PIPITI I UJIT,

15-17cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.

Shumohet në regjione malere, shpatije të zhveshura alpine dhe rrafshlarta. Shtegëtar i distancave të shkurtëra, gjat dimrit i gjejmë në ultësira në ujra të ëmbla dhe kënetë, gjithashtu i hasim edhe në fusha të vërshuara nga uji, sidomos në pranverë. Gjithashtu edhe në ujëderdhje të gjëra, por gjithmonë në ujra të ëmbla.

Pipiti i ujit

Prit e prit aty buzë lumit,
I pari krimb e hopa n'gojë,
Prit e prit e shko futja gjumit,
Ikin të gJORËT, me jetën nuk ka lojë!

Të vegjlit e tu duan diçka të hanë,
I ke të uritur, presin n'cicërrimë,
I hapin ata sqepa, secili thërret
mamanë,
Ububu Pipiti si shkon fluturimë!

Jepju nënë e dashur të gjithëve me
radhë,
Ë-ja si zanore mos t'i zbrëtë dy pika,
Rend dhe Pipit trimi t'u rriten djem e
çika

Ani kënga jote do shtohet e bardhë,
Vete nëpër male e deri në Dri,
E në djsersë e lagur kthehet n'poezi!

Porzana pikaloshe

Moj Porzanë,kapedanë,
Je e bukur sikur zanë,
Ato lara n'qafë e bisht,
Kush t'i bëri si me gisht?!

Moj Porzanë pikaloshe,
Zogë e bukur moçaloshe,
Larat n'bark cili piktor,
T'i bëri bukur si me dorë?!

Përreth lumit bishtpërpjetë,
Ecën, gjuan tepër shpejt,
Me atë sqep të vogël, t'verdhë,
Bukurinë n'duet e derdh.

Mos vallë jeni bija motre,
Të një zjarri , të një votre,
Me Porzanën zogë të re,
Që shton hijen përmbi dhe?!

Këmbët tua përplot sharka,
Kur noton si t'ecën barka,
I shkon lumit n'katër anë,
N'sa kontinente je Porzanë?

Zogë Porzanën që braktise,
Ç'ide patën kompromise?
Dhe pse dukeni dy tezake,
Ajo shkoi u bë fthillake!

Mos n'Brazil t'gjuajtën me llafe,
Pse mbi shpinë bart pakëz kafe,
Ky artikull ta mbushë Evropën,
N'lara tua sytë të ngopën!

Ç'mecenë n'lara patën hise,
Që na prishe, na harlise?
Kush moj tjetër veç natyrës,
Që firmosi përmes ngjyrës!



Familja RALLIDAE,
Lloji *Porzana porzana*,
SPOTTED CRAKE,
PORZANA PIKALOSHE,
19-22cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.

Kryesisht shumohet në pellgje të lagura dhe në livadhe me barishta me gjemba (rrin larg kallamishteve). Vështirë që merr turr, ik pa e vërjetur në shqirë të ulët. Te na arrinë kur shtegëton nga veriu.



Përmbi Brezne

Genti: Përmbi
Brezne, Kryemollopoje,
Atje n'Rrafshina, ku shihet bota,
Një Bilbili ç'i shpëtoi goje,
Derdhi mbi ne një thes me nota!

Ariani: Ai për ne thur maksima,
Me zilkat e deleve në harmoni,
Dizajne t'buta, nuanca t'ima.
Kush dirigjon më mirë se ai?!

Ariani e Genti

Arianmbari fjalëmargaritari,
Vërtet si ari këndon ario,
Kujdes moj skile se t'vretë i pari,
Dhuratë a këshillë për ty moj bijo?!

Mos e mëko mangun me mëngë
t'këndesit,
Si Nasradini që hëngri me qyrk,
Mekem për teket tua t'mëngjesit,
Kur m'teket këngën se vret moj qyrrkë!

Genti si mbret s't'i falë kusuret,
Ai moj sillet ashtu si di vetë,
Largohu nga këtu me ato poturet,
Ik moj ik, mbi Brezne të vretë!

Kënga kotecin e mbush me nota,
Zgjoheh zogjtë si bleta në zgjua,
The qafën skile me sjelljet e kota,
Këngën si verën dhe shkollën e dua!



Çafkëlori i Cetit

Çafka jote çafkë e shprehur
Ashtu shkundet në këndim,
Faqe botës vek i ngrehur
Ëmbëlsirë për shpirtin tim.

Këngës merria n'kopësht me lule,
Ë-ja lë të qajë n'bregdet,
Lule m'lule këngë me vule,
Obobo sa ëmbël thërret!

Rend e thuaja në ograjë,
I ke notat zjarr për zemër,
Ih ato si t'mbushin vaj,
Cet o Cet me t'bukurin emër!

Eja, t'pres në poezi,
Ti aty e ke folenë,
Ikim s'bashku n'Mal të Ri,
T'ia marrim për mëmëdhenë!

Familja SYLVIIDAE,
Lloji *Cettia cetti*,
CETTI'S WARBLER,
QAFKËLORI I CETIT,
14cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.

Qafkëlor i vogël galiq, kjo specje të humb para syve në kallamishte dhe barishte tjera të gjata ku ushqehet me insekte. Këngën e kan të mpreht dhe eksplozive. Folenë e ndërton në formë filgjani të thellë kaba, formësuar me bari dhe atë e vëndos në vegetacione të ulëta ujishteje. Është i përhapur në Europë, Afrikën Veriore, Lindjen e Mesme dhe Azinë Qendrore. Popullacioni i Lindjes së Mesme dhe Azisë Qendrore, shtegëtojnë në Indinë Veri-Perëndimore.



Familja SYLVIIDAE,
Lloji *Sylvia borin*,
GARDEN WARBLER,
QAFKËLORE E KOPSHTIT,
13-14cm, gjinitë e njejtë, pjesërisht
shtegëtar.

Shumohet në pyje të rralluara, në zabele dhe parqe zabelishtesh, gjithashtu edhe në parqe të mëdha me lisa të gjatë dhe me driza të pasura vegjetacioni. Dimrin e kalojnë në Afrikën tropikale. Shumë i matur aty ku jeton, shumë pak duket. Folenë e ndërton ulët në shkurre apo në bar të dendur.

Çafkëlori i kopshtit

Çarshia jote e shëtisë është kopshti,
Aty ke dardha, ke molla e fik,
Fare në krye nuk të ha mokshti,
Është se flokët t'u treten o mik!

Kënga jote është si mjalti me arra,
Është këngë që rrallë ndihet ndër zogj,
Lëre ore lëre, po gishtat luaja para,
Obobo ç'na poqi, obobo ç'na dogji!

Rende nga fiku në kokërra ulliri,
I ke merak ato, me lezet i ha,
Ike pastaj në maja kalliri,
Medet sa u kënaqe, bobo sa e sa!

Iha si ia merr bukur pastaj,
Kënga vetiu del nga goja,
O thua ja në fushën e paskajë,
Për nder vëlla e motër kënga edhe loja!

Shtruar shkon edhe i ngazëllyer,
Të ndjekin Skiftëret mëngjes për
mëngjes,
I dashuri im mos do jesh i ngjyer
Tërë në të kuqë, ndaj të kesh kujdes?!

Çafkëlori këngëgjatë(Çafkëlori iSavit)

Çafkëlor i kaftë oh sa je i butë,
Ashtu gështenjë e pjekur vjeshte,
Fare zërin të lutem mos e këput,
Është i ëmbël vërtet si lëng pjeshke!

Këtu eja e merr ulli e fik,
Ëmbëlsirë vilet të presin në vresht,
Lëre po unë të zgjodha për mik,
Obobo si ia thua bukur ndër kreshtë!

Rend e merria me nota të buta,
Ih sa gjatë këngën e çon,
Ih bre burrë gati me minuta,
Si Gjeli ilir, thua se harron!

Ashtu të dua me zë prej mbreti,
Vera erdhi e të bënë fole,
Ih sa të do ky shpirt poeti,
Të do si himnin për atëdhe!

Qukapiku i zi

Tak e tik, tak e tik
Çdo mëngjes dimër e verë,
Kjo e jotja gjimnastikë,
Zgjon nga gjumi zogi të tjerë,

Me atë gjuhën tënde t'gjatë
I nxjerr larvat në thellësi,
Për ty janë arra e mjalat,
O tufëkuq me kokën zi.

Sqepit të fortë o laroshak
Ulja zërin kur folenë ndreq,
I kam të ëmbël si kajmak,
Në udhë t'ëndrrave dy bineq!

Rrobat çdo ditë ndërroi te shpia,
Se mos t'i grinë e zeza molcë,
T'i hekuros vetë dashuria,
Të mos trokasë ndonjë divorc!

Kudo n'Evropë me klithma trime,
Me tikërre të gjata urë,
Me pendë t'larme n'mollën time,
Je ylber n'miniaturë.

Me ato kthetra si n'tastatura,
Ekspres lëvizje mbi trungje sjell,
Vallëzimi juaj me gra e burra,
Bën demonstrim që sytë t'i ndjellë!



Familja PICIDAE,
Lloji *Dryocopus martius*,
BLACK WOODPECKER,
QUKAPIKU I ZI,
40-46cm, gjinitë e njehta, pjesërisht
shtegëtar.

Folenë e ndërtojnë në pyje të vjetra, shpesh në pisha dhe pyje të përziera, por edhe në ahishte. Është i përhapur në Europën veri-perëndimore. Specje e kujdesshme por edhe shumë kureshtar. Zgavra e folesë në fomë ovale dhe atë me një madhësi prej: 9X12cm.



Familja PICIDAE,
Lloji *Picus viridis*,
GREEN WOODPECKER,
QUKAPIKU I GJELBËR (Zogi i Smajlit)
32cm, gjinitë e ndryshme, jo shtegëtar.

Fluturon vullshëm dhe papritur nga toka në një grumbull drurësh ose nga një fole milingonash në një livadh. Pjesa e pasme është ngjyrë e verdhë e shndritshme, kurse pjesa e sipërme e kurrizit ngjyrë jeshile. Të vegjlit kanë njolla të zeza në qafën dhe kraharorin me ngjyrë të bardhë. Jetojnë në pyje të hapur gjethegjërë dhe në parqe, më rallë edhe në pyje halore dhe në pyje të dendura. Foletë i vendos në zgavrat e trungjeve të pemëve. Femra lëshon 5-7 vezë që i ngroh për 15-17 ditë. Të vegjlit fluturojnë pas tre javësh. Ushqehet kryesisht me larva, milingona, ose insektet që i kapin duke hapur vrima në dru. Lëshojnë zë të fortë dhe të qartë, me gërvishje hundore të tipit "kju kju kju kjukjukju" ose një "kjukjukjukju" më e mprehtë.

Qukapiku gjelbërosh

Qëndron në kopsht shumë krenar,
Ushtron sqepin tënd të fortë,
Këcintar i dorës së parë,
Ani krimbat se kanë mort!

Petku yt o Gjelbërosh,
I ndjell sytë aty mbi dardhë,
Kop e kop qëllon trimosh,
Ushqim nxjerr krimbat e bardhë.

Gjallon duke u zvarritur,
Edhe dimrit pa përtësë,
Lëndon trungjet i mërzitur,
Bah, kjo borë t'plaku për besë!

Ëmbëlsirë kjo penda jote,
Rend nga pema n'pemën tjetër,
O bukurosh i kësaj bote
Shtoji t'rënat n'mollë të vjetër!

Qukapiku pika-pika

Qëllon ashpër në atë lis,
Ububu si me çekan,
Krimba lyp, e ke për fis,
Aman Piko babaxhan!

Përkrenarja kuq në majë,
I shkon shpinës tënde t'bardhë,
Klithma jote gëzim a vaj,
Ushton degëve aty n'dardhë?!

Pa shih vija t'zeza shpinës,
I qëndisin flatrat vallë?
Kremte bëjnë aty Rudinës,
Ato zoçka që vijnë vërdallë?!

Papa,mami! Papolushët,
I thërrasin prindët si në lojë,
Klithmat ndalin vogëlushët,
Atëherë larvat kur mbërrijnë n'gojë!

Qukapiku shpinëbardhë

Deri vonë çukite n'mollë,
Rendje trungut poshtë-përpetë,
Erdhi shoqja belëhollë,
Ndërroi ca fjalë që i duhen n'jetë:

Deri kur të pres unë ty,
Rend e thuaj bukurosh,
Oh m'u shtjerrën këta sy,
Ciulloj për ty djalosh?!

Ora vajti koxha vonë,
Piku ktheu një përgjigje:
Oj fisnike, oj katonë,
Sonte m'prit aty në brigje!

Lëre po u vesh sa bukur,
E u bë dhëndër i ri,
Ububu zi-bardhë si flutur,
Ciullojnë në dashuri!

O shpinëbardhi Qukapik,
T'gjitha pikat tua t'zeza,
Obobo të humbën frik,
Se këtë lojë e nisi verëza!



Familja PICIDAE,
Lloji *Dendrocopos leucotos*,
WHITE BACKED WOODPECKER
QUKAPIKU SHPINËBARDHË,
25-28cm, gjinitë e ndryshme, jo
shtegëtar.

Shumohet në pyje të lagëta dhe të përziera dhe atë shpesh pranë lumejve dhe liqeneve, vënde këto të cilët janë të pasura me trungje të vdekur (aspen, verri, mështekën); e zgjedhin vendin e qetë të pazhurmë, tanimë kjo specie është e rrezikuar. Ushqehet me insekte, duke i përfshirë larvat e brumbujve me brirë të gjatë. Mjaft mire i mobiluar por jo shumë i turpshëm. Gjat dimrit okupon terriore të gjëra. Fole në zgavër të drurit.



Familja PICIDAE,
Lloji *Dendrocopos major*,
GREAT SPOTTED WOODPECKER,
QUKAPIKU PIKA PIKA,
23cm, gjinitë e ndryshme, jo shtegëtar.

Ka trup të madhësisë mesatare me ngjyrë të larme, ndërsa mashkulli në zverk ka njolla të kuqe. Sqepin e ka të gjatë, të drejtë dhe të fortë për çukitje në lëvoret e drunjve dhe ate me qëllim të zbulimit të kandrrave dhe të larvave të tyre, me të cilat ushqehet. Kandrrat i mbledh me gjuhën e gjatë të tij. Këmbët i ka të përshtatshme për zvarritje në drunj, me dy gishtërinj përpara dhe dy të tjerë prapa. Çerdhet i ndërton në zgavrat e drunjve. Aty femra bën 5-6 vezë, të cilat i ngroh për 12-13 ditë. Është shumë i rëndësishëm, ngaqë bën shfarosjen e kandrrave dhe të larvave të tyre në pemishte dhe në pyje të ndryshme. Është i përhapur në vendin tonë dhe në tërë Evropën.

Qukapiku pika- pika(larosh i madh)

Qëllon ashpër në atë lis,
Ububu si me çekan,
Krimba lyp, e ke për fis,
Aman Piko babaxhan!

Përkrenarja kuq në majë,
I shkon shpinës t'endë t'bardhë,
Klithma jote gëzim a vaj,
Ushton degëve aty n'dardhë?!

Pa shih vija t'zeza shpinës,
I qëndisin flatrat vallë?
Kremte bëjnë aty Rudinës,
Ato zoçka që vijinë vërdallë?!

Papa,mami! Papalushët,
I thërrasin prindët si në lojë,
Klithmat ndalin vogëlushët,
Atëherë larvat kur mbërrijnë n'gojë!

Qukapiku shpinëbardhë

Deri vonë çukite n'mollë,
Rendje trungut poshtë-përpjetë,
Erdhi shoqja belëhollë,
Ndërroi ca fjalë që i duhen n'jetë:

Deri kur të pres unë ty,
Rend e thuaj bukursh,
Oh m'u shtjerrën këta sy,
Ciuллоj për ty djalosh?!

Ora vajti koxha vonë,
Piku ktheu një përgjigje:
Oj fisnike, oj katonë,
Sonte m'prit aty në brigje!

Lëre po u vesh sa bukur,
E u bë dhëndër i ri,
Ububu zi-bardhë si flutur,
Ciuллоjnë në dashuri!

O shpinëbardhi Qukapik,
T'gjitha pikat tua t'zeza,
Obobo të humbën frik,
Se këtë lojë e nisi verëza!

Qyqja

Kuku Qyqe, kuku-kuku,
Gjithnjë n'shpirit e veshur zi,
Mos vallë kështu të pëlqen luku,
T'mbetesh përrallë në histori?!

Kush n'sipërfaqe moj të nxori,
Nga shekuj t'errët si heroinë,
Mos Kadareja në letra t'solli,
Të shohësh dritë moj Doruntinë?!

Apo vallë besa shqiptare
Me Konstandinin ty të pruri,
Mos dashuria o moj manare
Stresin n'mend disi e vuri?!

Erdhe ta vizitosh Arbërinë,
Nga Bohemia si rrëmujë,
Ta trishtoni në prag shtëpinë,
Nënë e bijë në një statujë?!

Dhe kur nga mami u njoftove
Se t'kanë vdekur nëntë vëllezërit
tu,
Metamorfozë e gjora pësove,
U ktheve n'Qyqe me ku-ku?!

Qan e qan dhe vetëm qan,
Asnjë vëlla nuk i përgjigjet,
Derën kufi n'mes e kanë,
Zemrat kallen, bota digjet!

Dhe lokja ime n'fëmijëri
Për një Fatime m'pati treguar,
Ti Doruntinë a s'ishe ti,
Në paralizë e përvëlur?!

Kuku-kuku përmbi Opojë,
Kuku-kuku edhe mbi Blaq,
Mbylle moj njëherë atë gojë,
T'munda Qyqe, plaq moj plaq!



Familja CUCULIDAE,
Lloji *Cuculus canorus*,
CUCKOO,
QYQJA,
33cm, gjinitë e njëta, shtegëtar.

Ka trup me madhësi mesatare 33-37 cm. Pendët e pjesës së përparme të trupit kanë ngjyrë hiri të hapur, ndërsa pjesa e pasme e mbyllët. Në tërë trupin vërehen njolla të tërthorta. Ka krahë të gjatë e të mprehtë, ndërsa bishtin e gjatë e të zgjeruar (pahitëse). Është karakteristikë e saj se nuk ndërton asnjëherë çerdhe të vetën, por vezët i bën në çerdhe të huaja. Në maj ose qershor femra lëshon 15-20 vezë në tokë, pastaj me gojë i mbart në çerdhe të përshtatshme për ngrohje. Ngrohja zgjat 12 ditë. Mashkulli i qyqes lëshon zë karakteristik të ndarë, kuk-kuu, kuk-kuu... Ajo kapet për degë me dy gishta përpara dhe dy prapa. Ka aftësi edhe të zvarritjes. Është shumë e dobishme, ngaqë ushqehet me kandrra. Jeton në Shqipëri, Kosovë, në tërë Evropën dhe në Australi.



Qyqja në akrostik

Cërr-cërr mbi cung cyt a cimbon,
Udhëkryqet pahit me bishtin e gjatë,
Cilin nga meshkujt Qyqe kërkon,
Ulur t'ia thoni me haki kat?!

Lëshuar ke vezët diku në tokë,
Ububu me gojë i bart n'çerdhe t'huaj,
Sa t'vegjël presin atë babënllok
Cucla t'u blejë sakaq më thuaj?!

Ah sa kukat Qyqani sharkë,
Nëna bart krimbat drekë edhe darkë,
Oh sa i kënaqa, pse burrë s'u kyqe?

Rendin zogi tjerë t'u shohin n'krekë,
Uh s'guxon kush me dorë t'u prekë,
Sall vocat thërrasin-T'munda moj Qyqe!



Qyrylyku i vogël

Sqepin e gjatë e ke sa një mashë,
Të duhet nuse t'i marrësh vetullat?
Jo ore jo se unë jam vashë,
Me të kthej peshqit në tavë si
petullat!

Kur vashë na je, pse taka ke,
A nuk më thua o Qyrylyk,
Të dukesh nuse me kokën n're,
Mos vallë ne hamë kashtë edhe
byk?!

Vërtetë na qenke djalë i pabindur,
Për peshq në lumë më duhen pra,
Mos vetëm Rosa na qenka lindur,
Unë t'i trazoj, ajo t'i ha?!

Familja CHARADRIIFORMES, Lloji
Actitis hypoleucos,
SANDPIPER,
QYRYLYKU I VOGËL,
18-20cm, gjinitë e njejtë, shtegëtar.

Shumohet afër ujit dhe ate në sipërfaqe të lagëta, i preferon brigjet e ashpra gurore, në të shumten e rasteve e hasim në liqene dhe lumejë me tajgë, gjithashtu i hasim edhe në brigje, në arqipelage, rrallë herë i shohim në Europën jugore. Shtegëton vetem ose në grupe të vogla, shpesh shtegëtojnë natën, ku dëgjohen thirrjet e tyre. Folenë e ndërton në vegjetacion, zakonisht në pyll afër ujit.



Familja SCOLOPACIDAE,
Lloji *Tringa toranusa*,
REDSHANK,
QYRYLIKU KËMBËQIRIZRE,
28cm, gjinitë e njejta, shtegëtar.

Qendrojnë drejtë në këmbët e gjata dhe kokë përpet, në këtë mënyrë ky zog alarmues i brigjeve, shpejtë i dikton armiqtë e bezdëshëm duke iu afrua. Sqepi, këmbët e kuqe dhe trupi ngjyrë kafe i mundësojnë që të kamuflohet shumë mire. Në pranverë jeton në livadhe, kullota dhe kënetë. Në këto vende i rrit të vegjlit duke i ushqyer me insekte dhe invertebror tjer. Folenë e ndërton në baltë duke e shtypur me trupin e saj, të maskuar në kërcëj të gjat dhe bimë. Dimrat i kalojnë nëpër brigje në pjesën më të madhe të Europës, Afrikës, Indisë dhe Azisë jug-lindore.

Qyrylyku këmbëqerizre

Qëndron detit si zotëri,
Yll o yll me sqep të kuq,
Rend guranave brijëmbrijë,
Yllo munda s'të shkonë huq!

Leht sa leht i azganisesh
Yllkës tënde me këmbë t'gjata,
Krahët ngritur i vardisesh,
Ububu me serenata.

Kështu e zbut me rituale,
Ëmbëlsirën e paparë,
Medet zonja Qyryklale
Bjerr çdo brengë detit me valë.

Ëmbëlsirë e top sheqere
Qyrylykja do lëshojë zogj,
Edhe ti lazdran me sherre,
Rend pas saj se e ke borgji!

I shëtit detit dhe pirgjeve,
Zonja jote zemërloçka,
Rend për skrraja zallit, brigjeve,
E ushqen një tufë me zoçka!

Rosat

Ariani: Sa e ëmbël Rosa kere
Nëpër ujëra shkon e qetë,
Është e dugët si ykere
Që për syrin ka lezet.


Genti: Qafë të gjelbër Kuqlla ka,
Si kur piqet vetë kakaçka,
Përqesh dhelprën me ga-ga,
-S'vij atje se m'shan naniçka!

Ariani: Edhe Rosa sqepëlugë
Me atë sqepin koxha t'gjatë,
Kruan krahët si t'ketë zhugë
Gëlltit peshqit sikur mjalt!

Genti: Më e bukura Marsatore
M'i ka krahët larë mbi larë,
Çdo gatim i shkon për dore,
Por mbi t'gjitha peshqit n'skarë!

Ariani: Rosa e egër kaftë e zi
Me ga-ga e çudit botën,
Sjell shumë gaz e lumturi,
Kur me burrin luan shotën.

Gjyshi: T'gjitha bëjnë parakalim
Para se të çiftëzohen,
Shkrihen n'dritë të syrit tim,
Oh sa mirë që fokusohen!



Familja ANATIDAE,
Lloji *Anas platyrhynchos*,
MALLARD,
ROSË E EGËR,
58cm, gjimëtë e ndryshme, pjesërisht
shtegëtar.

Rosë e ujit e cila nuk trembet nga prania e njerëzve (por jo në Kosovë) dhe ndryshimi i habitatit. Rosën e egër e gjejmë në gjith ujrat e tokës, ujra të pakt ose të shumtë. Shumë i pelqejnë ujrat me plot vegjetacion. Derisa uji i kalon nëpër sqep, kështu aty ngelin ushqime te imta si: fara, gjethe, insekte dhe krimba të cilët nga tendosja dhe një paisje në formë krëhëri i mundësojnë ta kryej këtë proces. Folenë e ndërton në një gropë në tokë apo edhe në një kodërz të vogël siq janë pemët e ulëta, të mbështjellura me kërcejë, gjethe, pendla dhe pupla. Shumohet në pjesën më të madhe të Amerikës Veriore dhe Euroazisë. Dimrat i kalon në jug të Meksikës, Afrikën Veriore dhe Azinë jug-lindore.



Familja SYLVIDAE,
Lloji *Sylvia atricapilla*,
BLACK CAP,
RRADAK ZIU,

14cm, gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Kënga e bollshme e këtij zogu shpesh dëgjohet nga lisat e lartë, duke i dhënë një kontrast ngjyrave të trupit të tij. Ushqehet me insekte dhe mana. Fole në form filxhani e formësuar me lesh dhe bar, e vendosur posht drizës. Eshhtë i përhapur në pjesën më të madhe të Europës, gjithashtu edhe në Afrikën Veriore, Lindjen e Mesme dhe disa pjesë të Azisë Qendrore. Dimrat i kalon në Europën jug-perëndimore dhe deri në Afrikën Ekuadoriale.

Rradakziu çafkëlor

Çafka jote gëzim o verë,
Ashtu t' shkonë n'rradak të zezë,
Fishkëllen ëmbël në pranverë,
Është një këngë që malet ndez.

Kështu rrëmbyesit plasin nga
inati,
Është një këngë me violinë,
Luaja gishtat, n'peshojë mirë
mati,
O kokëbukur, jetën ma përtërin!

Rend me këngë nga unë,
Rradakzi,
I ke notat si dardha verore,
Rrallë kush mund të këndojë si ti,
Ashtu ëmbël sa të shkonë
përdore!

Dalavera seç po merret n'flakë,
Atje larg te Ura me gurë,
Kënga jote lule me zambak,
Zëri yt se ç'të bënë mamur!

Ih në Rrenc as mund të besojnë,
Ububu thonë i bukur sa s'ka,
I ke notat në shpirt që
ngacmojnë,
Medet këto dyja si motër e vëlla!

Skifterët

Skifteri si Skifter
Në sy këngëtarët merr,
Të gjithë i bën përshesh,
Tërlikun ta veshë!

Skifteri si Skifter,
Rebel e kriminel,
Zogjtë në fyt i pret,
Futën e zezë ta qetë!

Skifterit këmbëkuq
Dhe Skifterit të vogël,
Puna s'u shkon huq,
Kur klithin në kodër!

Skifteri si Skifter
Sy e mendjesherr,
Kthetrat verdhë a zi,
Mishin ta pjekë n'tepsi!

Skifteri i drurit
Ha zogjtë me rabush,
Se i shtrohet hurit
Sa herë zihet n'fushë!

Të gjithë kur janë tok
Me Huta e Gjeraqina,
Trishtimi të rrokë
Për gjahun në Rrihna!

-T'hidhërohet Shqiponja-
Një varg m'telefonoi-
-Ajo është e zonja
Rebelët t'i nënshtrojë!

Ajo me ato fleta
Rrëmbyesit ndanë n'dysh,
Nis me zoçka t'veta,
Si ulkonjë me këlyshë!



Familja FALCONIDAE,
Lloji *Falco vespertinus*,
RED-FOOTED FALCON,
SKIFTERI KËMBËKUQ,
gjatësia 22-35cm, gjinitë e ndryshme,
shtegëtar.

Skifteri është grabitës i vogël (22-35 cm). Në anën shpinore pendët kanë ngjyrë të verdhë në të zezë, ndërsa ana barkore ngjyrë të kuqe dhe me njolla të mbyllëta. Ushqehet me minj të fushës e kandrra për çka është shumë i dobishëm. Femra bën 5-7 vezë me ngjyrë të verdhë dhe me pika, kurse inkubimi i tyre zgjat 28-30 ditë. Është i përhapur në Shqipëri, Kosovë, në tërë Evropën, Azi dhe Afrikë.



Familja FALCONIDAE,
Lloji *Falco tinnunculus*,
KESTREL,
SKIFTERI KTHETRAZI (sokol),
gjatësia 31-37cm, gjinitë e ndryshme, jo
shtegëtar.

Eshtë i përhapur në hapësira të gjëra, në fusha, rrafshnalta, afër aeroporteve, pranë rrugëve automobilistike, arave të mbjella, shkurrishte, kënetat dhe ligatina me druj dhe lisa, gjithashtu e hasim edhe zona me mëshstekna dhe shelg. Ushqehet me insekte, flutura. Folenë e formëson në lis, shpesh e hasim në fole të vjetra të zogjve tjerë, në ndërtesa, në zgavra apo qoshe të ngrohta.

Skifteri kthetrazi

Ka pika rreth kurrizit,
I kap zogjtë në befasi,
Faqja e tij, faqja murrizit!
Skifter aga kthetrazi!

Turp pse ha dhe këngëtarët
E ua rrëzon këngën përdhe,
Rëndë e kanë lisat e malet,
I lëshojnë lotët shi ndër re!

Fluturon e rri në një vend,
Ashtu fokuson gjahun në fushë,
Qëllon dhe e bart n'kreshta me
dushk!

E pesë të vegjlit presin në atë kënd,
Ziverdhë nëpër shpinë e kuq nën
gushë,
Ik o sqepdyll se t'vrava me pushkë!



Familja FALCONIDAE,
Lloji *Falco naumanni*,
LESSER KESTREL,
SKIFTERI KTHETRAVERDHË,
gjatësia 27- 33cm, gjinitë e ndryshme,
shtegëtar.

Kryesisht është vizitor i verës. Shumohet në koloni në qytete, shkëmbinjë, gërmadha, etj. Zakonisht në lartësi të ulta mbidetare. Gjat shtegëtimit janë të shoqërueshëm. Ushqehen me insekte, zakonisht i zënë në tokë, madje edhe ecin derisa e zenë prenë. Folenë e bëjnë në zgavër apo tek një e qarë e shkëmbit, në ndërtesa të vjetra, nuk mbledhin material për ta formësuar folenë.



Familja FALCONIDAE,
Lloji *Falco columbarius*,
MERLIN,
SKIFTERI I VOGËL,
27cm, gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Eshtë zog agresiv, skifter që fluturon shumë shpejtë me një aftësi jashtzakonisht gjuetie. Jeton në vende të hapura siq janë shkurret, kënetat, kullotat, dhe brigjet e ulëta detare. Skifteri i vogël gjuan duke fluturuar.

Fluturon posht mu mbi sipërfaqe të tokës duke i shfrytëzuar lisat dhe kreshtat si mburojë nga ndonjë sulm i papritur. Preja e tyre janë zogjtë që fluturojnë, por gjithashtu edhe lëshohet poshtë për ndonjë krijesë tokësore siq është miu. Folenë e bën në një zgavër peme. Dimrat i kalon sa më në jug të Amerikës, Afrikës Veriore, Indisë Veriore dhe Vietnamit Jugor. Femrat janë më të mëdha se meshkujt.

Skifteri i vogël

Sa bukur dukesh i gështenjtë mbi
shpinë,
Kokë e gushë kaftë e zi m'i ke,
I bukur, po shpirtin ma bën pelin,
Fshehur këngën e ndërpret mbi dhe.

Të duan e të ushtrojnë për gjuetar,
Edhe zonjat të vënë mushema mbi
kokë,
Rendin me ty si me një zagar,
Ikën ti me ta t'rrëzosh zogj në tokë.

Iha minjtë sa e kanë mërzi,
Vetëm fshihen e s'dalin në sipërfaqe,
Obobo vetëm qajnë e lotët u shkojnë
për faqe.

Goglas shkon Skifteri e i nxjerr
përmbi,
Ëhë edhe këngën ua bën copa kokaqe,
Lulet nisin gjamën bashkë me
manushaqe!



Ariani e Genti për Sorrat

Ariani: Sa t'mërzitshme janë këto sorra
Kur e bëjnë qiellin zi,
Fillon shiu e pastaj bora
Mbyllen rrugët, mbetesh n'shpi!

Genti: Me to Galat me Galanë
Dorë për dore heqin valle,
Çilen udhët Arian,
Njerëzit ecin se kanë halle!



Familja CORVIDAE,
Lloji *Pyrrhocorax graculus*,
ALPINE CHOUGH,
STERQOKA E MALIT,
gjatësia 38cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

Krahët e gjerë të stërqokës së malit të hapur nga ana e jashtme, i pamundësojnë të fluturojë në mënyrë të përkryer. Kryesisht ushqehet me insekte, kermilla, dhe fruta, gjithashtu edhe rrëmon plehrat për t'i gjetur gjësende të vogla ushqimore që kan mbetur nga turistët. Është specje e shoqërueshme, jeton në tufa dhe mbajnë lidhje të ngushta me partnerët e tyre. Foleja përbëhet nga shumë shkopinjë dhe rrënjë të thata, të vëndosura në një të qarë shkëmbi apo në shpellë. Janë të përhapura në Spanjë, Shqipëri, Kosovë, Afrikë veri-perëndimore, popullacioni i veriut shtegëton.

Stërqoka e malit

Sterrë e zezë je moj Stërqokë,
Të gjitha shoqet veshur në zi,
Ë-ja juaj peshon me okë,
Re e zezë që shkarkon shi.

Qull të bërë nga ata lot
Obobo atje në mal,
Krokroket tuaja në këtë botë
A s'janë vaje mbi ushtarë?!

E sytë e tyre pse ua nxirrni,
Mesazhin në këngë a s'ua lanë,
Aty stop moj Stërqokanë!

Lozni sa të doni veç mos virrni,
Ikni nga të vrrarët n'katër anë,
Ta dini, ka kush i qan!

Sorra

Kur më merrte motra Vale
Drekë ta çonim nëpër ara,
Vallë çka solle-kureshtare-
Ishe sorrë ti më e para?!

Ara plot kallinj t'rrëzuar,
N'drapër korrej pandërprerë,
Ti dinake e ushtruar
Zgjidhje bukën menjëherë!

Copa-copa bofqëllëkun,
Bëje trosha djath të ri,
Po të zura , luan qyqekun-
Shfrynte lodhur bujk i zi!

Ish atje- Kur thërriste njeriu,
Ju me Galat varg e vijë,
Si një tufë që ka bariu
N'mal përzier dhenë e dhijë!

Bashkë me motrën bukën solla
Dhe e vara n'kumbull t're,
M'shau babi pse s'qëllova
Se pa drekë argatin le!

Të them Sorrë me sy t'përlotur
T'zë e t'theri mori zekë!
Edhe pse me shoqet rrotull
Vërtet bëre galadrekë!

Kurrë më s't'lypi dhëmb të ri,
Për atë vjetrin që m'ra n'lug,
Me atë sqep-më thanë si fëmijë-
Sytë t'i nxjerrë për një copë bukë!



Familja CORVIDAE,
Lloji *Corvus corone cornix*,
HOODED CROW,
SORRA,
44-51cm, gjinitë e ndryshme, jo
shtegëtar.

Shumohet në pyje të hapura, ligatina e moqale, në grumbuj lisash në ferma dhe në parqe të qyteteve. Jeton në shumë vende të Europës, por shumë sorra finlandeze dhe ruse gjat dimrit shtegëtojnë në Suedi dhe në shtetet e Detit Verior. Ushqehen me omnivore, zogjve tjerë u pushtojnë strofullat, ushqehen me kërmë, insekte dhe invertebrerë tjerë në fusha dhe brigje deti, gjithashtu ushqehen edhe me peshqë të vegjël, midhje, mana, fara, etj. Folenë e ndërton lart në lis me shqopishte të rregulluar mire.



Familja ACCIPITRIDAE,
Lloji *Aquila chrysaetos*,
GOLDEN EAGLE,
SHQIPONJA E ARTË (E MALEVE),
gjatësia 80-93cm, krahët e hapur
190-225cm, gjinitë e njejta, pjesërisht
shtegëtar.

Eshtë adaptuar të gjuaj në pejsazhe të gjëra në lartësi të larta mbidetare, është shqiponjë e fortë dhe mjeshtër i fluturimit, shpesh e shohim duke u lëshuar ngul gjat erave dhe shtërngatave dhe atë për kënaqësi absolute. Metoda tipike e gjuetisë së saj është të fluturojë shpejtë dhe mbi sipërfaqe të tokës duke iu afruar presë dhe kështu i bjen mbi të pjerrtazi.

Shqiponja e artë e kap prehtë me këmbët e hapura. Preja kryesore e saj janë sisorët dhe ata si: lepujt, tusha e malit dhe shumë zogjë tjerë, madje gjat dimrit edhe kërmat janë ushqime për mbijetesën e tyre. Shqiponja e artë zakonisht është e heshtur, por herë pas here e lëshon një angullimë (lehje) thirrjeje. Foleja është një grumbull shqopinjësh dhe atë të rregulluar mirë, e vendosur në shkëmb ose edhe në lis. Eshtë e përhapur në Amerikën Veriore, Euroazi, Afrikën Veriore dhe Lindjen e Mesme. Popullacioni i veriut shtegëton gjat dimrit larg në hemisferën jugore dhe atë deri në Himalaje dhe Kinë. Femra është më e madhe se mashkulli.

Stërqoka sqepkuqe

S'të ka hije asnjë krrokamë
Ty Stërqokë me buzë të kuqe,
Ë-ja jote fillon gjamë,
Rend e para soropuqe!

Qëndron fushave me plot shoqe,
O si silleni kur heqni valle,
Kur shkon qiellit me ato kërraqe,
Ashtu errën ato male!

Stop poet, mos shkruaj veç zi,
Qëndis pakëz metafora!
E neve në shpendëri,
Pse na quajnë pra koka-kola?!

Krahë e këmbë aty në bokë,
Uh flamuri kuq e zi,
Qyqja-Qyqes moj Stërqokë,
E Shqiponja ku të rri?!



Familja CORVIDAE,
Lloji *Pyrrhocorax pyrrhocorax*
CHOUGH,
STERQOKA SQEPKUQE,
gjatësia 38cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

Shumohet nëpër male të larta në lartësi prej 1200-3000m, ndoshta në disa male edhe më lart se kaq. Nuk frikohen nga zhurma dhe levizja e njerëzve dhe nuk janë të turpshme. Janë të shoqërueshme në habitatet e tyre por përjashtim bën periudha e shumimit, shpesh grupet perzihen me stërqokat e malit, ku më rrallë i hasim bashkarisht duke folenizuar. Folenë e ndërtojnë në shkëmb apo edhe në shpellë, në të qara apo edhe në zgavra të ndërtesave. Janë të përhapura në Spanjë, Shqipëri, Kosovë, Afrikë veri-perëndimore, popullacioni i veriut shtegëton.



Familja STRUTHIONIDAE,
Lloji *Struthio camelus*,
AFRICAN OSTRICH,
STRUCI AFRIKAN,
gjatësia 250cm, gjinitë e njejta, jo
shategëtar.

Është i vetmi lloj i këtij rendi dhe shpendi më i madh i kohës së sotme, i gjatë 2.75 m dhe i rëndë deri në 90 kg. Ka kokë të vogël dhe qafë të gjatë, trup të madh dhe të fuqishëm, këmbë të gjata dhe të mbuluara me luspa të brirzuara për mbrojtje nga rëra, ngaqë jeton në viset shkretinore të Afrikës dhe Arabisë. Gjymtyrët e pasme kanë vetëm dy gishta. Janë vrapues shumë të mirë, e tejkalojnë edhe kalin vrapues arab. Ushqehet zakonisht me bimë, fara, kandrra dhe brejtës. Mashkulli ka vetëm një femër (monogam), e cila bën 15 kokrra vezë. Veza është e gjatë deri në 17 cm dhe e rëndë deri në 1,5 kg. Mbi vezë qëndrojnë me ndërrime për 40 ditë, mashkulli qëndron natën, femra ditën.

Struci afrikan

Burrë i rëndë kur shkon sheshit,
Me krahë t'hapur mrekulli,
Bishtin sikur shtëllungë e leshit,
Qafëkuq e pendëlzi.

Mendja t'bëhet bozë e kllinë
Kur merr ai të vrapojë,
Një majmun i rri mbi shpinë,
I grah posi kauboj!

Hidhet n'shqelma me rivalë,
Mendja që s'ta merrë,
Karatist i dorës s'parë,
Ky Gjigantogjel!

Është i vetmi monogam
Që kalon veç me një grua,
Sa ka zonja n'katër anë
-Asnjë tjetër- thotë- s'e dua!

-Mos më merrni për kodosh
Dashuria jonë kur ndez,
Jo me zonjën s'më shkon bosh,
Rezulton me pesëmbëdhjetë
vezë!

A e dini si kllaçiten
Vezët tona në fole?
Unë rri natën, ajo ditën,
Plot gëzim e plot hare!

Kur të mbushen dyzet ditë,
Struçka zogjtë do i lëshojë,
Pesëmbëdhjetë t'vegjël dalin
n'dritë,
Si refera me pip n'gojë!

Vrapues t'shkathët pa fre në vrap
Kur ushtrohen a janë n'rrezik,
Ia kalojnë kalit arab
Këta gjigantë atje n'Afrikë!

Shapka e madhe e ujit

Shtuar ia merr me cicërrima të holla,
Ashtu fryhesh gushës e deri në bisht,
Pa shiko moj zogo kush të pretë te molla,
Këngëtari Shapkua ty ta bënë me gisht!

Ah ato varga shpinës përplot pika,
Edhe gushës tjerat zi e bardhë përzier,
Medet Shapko vajza, medet Shapko çika,
Ata bandillusha të thërrasin në qiell!

Dhë ti u përgjigjesh me sqepin e gjatë,
E bën në formë këndi, ku thërret dashuria,
Bah, të vjenë ngat gushëziu çokolatë,
Ububu plot zoçka do të kesh te shpia!

Kush nuk t'i lakmon ato thirrjet tua,
U bëftë copë e grimë e ilaç mos gjetë,
Rend e merrja ëmbël se më pëlqen mua,
Obobo kur fryhesh , bukuria vetë!

Sharkat nëpër trup syrin e bëjnë copa,
Jaranat e tu ringun e pëlqejnë,
Athua moj goco ato zemërgropa
E përcjellin boksën e çfarë do rrëfejnë?!

Ububu dhe zoçkat na u rritën pak,
Jetojnë nëpër ujëra e nuk dalin dot,
I thonë njëra-tjetrës me zërin kajmak
Të vrapojmë pas mamit më të mirë në botë!



Familja CHARADRIIFORMES,
Lloji *Gallinago media*,
GREAT SNIPE,
SHAPKA E MADHE E UJIT,
gjatësia 33-35cm, gjinitë e njejtë, shtegëtar.

Zakonisht shihen kur bie muzgu, në kohën kur fluturojnë nga streha e tyre e fshehtë në pyll. Ngjajnë me shapkën e ujit (*Gallinago gallinago*), por janë shumë më të mëdha në trup dhe më të rënda në peshë. Kanë sqep të fortë dhe vija të tërthorta e të mbyllta nëpër kokë. Puplat janë një përzierje e bukur e ngjyrave kafe, e verdhë dhe gri. Kanë sy shumë të mëdhenj çka është e pazakontë për shpendët e tokës. Fluturimi i tyre është i shpejtë dhe i fuqishëm. Krahët i kanë të gjerë dhe me majë. Jetojnë në pyje të lagështa, moçale të hapura, lëndina me shkurre, dushkaja, pyje të përziera, kanale dhe toka moçalore me shkurre të shpërndara. Foletë i kanë zakonisht në tokë. Shumimi në rajon vërtetohet vetëm në raste sporadike. Ushqehen kryesisht me krimba. Zëri i ngjan zakonisht një fishkëllime të mprehtë.



Familja ACCIPITRIDAE,
Lloji *Gyps fulvus*,
GRIFFON VULTURE,
SHKABA,

gjerësia 260cm, gjinitë e njejta, pjesërisht shtëgëtar.

Ka kokë dhe qafë të mbuluar me pendë të shkurtra ngjyrë të bardhë. Është mjaft e madhe, e gjatë 1-1,2m, ndërsa e gjerë 2,60m, me këmbë të fuqishme, por kthetra të topitura. Ushqehet me këрма të ndryshme të gjitarëve. Femra bën një vezë, të cilën e ngrohin së bashku me mashkullin për 48-50 ditë. Është e përhapur kryesisht në Shqipëri, Kosovë, Maqedoni, në tërë Evropën, Azi dhe Afrikë.

Shkaba

Shumë e bukur dukesh në flamur,
Kokë e qafë pendë margaritare,
Atje n'thepa më e rreptë se kurrë,
Bredh në luftëra që të jesh krenare!

Atje n'çerdhe bën veç një vezë,,
Dytë e nxeni bashkë për pesëdhjetë ditë,
Yll i natës në qiellin që ndez
Kur vjen n'jetë zoçka juaj n'dritë.

Rend moj Shkabë me krahët e shtrirë
E shqiptarët krenohen me ty,
Në këtë tokë të jakut e mjaltit!

A s'ishe ngadhnyese mbi armik të
nxirë,
Rendje drejt dhe shpoje n'sy,
E Marigo ia shkoi hujin artit;

Në Shqipëri maleve me borë,
Ë-ë qajnë nga frika zogj të tjerë,
Fushëkuqi në mes të mbanë simbol,
Luaje vallen kokëbardha maliher!

Ashtu dhe mbete nuse n'histori,
Motra ime e Pavarësisë në Vlorë,
Ule kokën shih sa djem të rinj,
Ranë për atëdhe me flamur në dorë!

Ishin burra me klithmat e tua,
Në luftë shkuan me këngën e trimit,
Tani rrinë të heshtur në përmendore!

Oj qafëbardhë në flamur drangua,
Nënat duruan dhe peshën e kimit,
Është nder për to loti në fitore!

Shkurta

Tëk-tëk-tëk tri herë shpejt
Çfarë të ndodhi, çfarë të gjeti,
Zonja Shkurtë vallë kë e thërret,
Mos divorc të shpalli mbreti?!

Është hidhëruar ai me mua,
Pse ia lashë kaçën në lojë,
Qëndron vetëm atje n'përrua,
E kthen kokën, s'flet me gojë!

Tëk-tëk-tëk kështu shpesh
I thërret zogjtë që koloviten,
I ndjell ëmbël si bareshë,
Gjatë kullotjes t'mos mërzhiten?!

Oh sa bukur i ushqen,
Deri t'bëhen për martesë,
Çdo insekt që n'tokë e gjen,
Ua ndan në pjesa-pjesë!

Tëk-tëk-tëk kush të thërret
Ashtu shpesh e hiç pa nge?
U pendua baba Mbret,
Do ta nisë një lojë të re.

Zonja Shkurtë sa krushq pate,
Atë vit kur u martove,
Në ç'restorant moj u rropate,
Në banket me kë vallëzove?

Thoshte Mbreti hani, pini,
Sonte lë t'jehojë sefaja,
Ç'bën i forti ai zinxhini,
Do çuditet fukaraja!

Kujdes lotët e vejshës,
Sa janë tinguj të kambanës,
Shkojnë si lumi malit, fushës,
Rrinë n'Theknushe të Bresanës,



Familja PHASIANIDAE,

Lloji *Coturnix coturnix*,

QUAIL,

SHKURTË,

gjatësia 18cm, gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Kjo specje është njëri prej zogjve më të vegjël në botë i kësaj familjeje. Zëri i tij karakteristik konsiderohet të përbëhet prej tri notave të tingullit lëngëzor, që dëgjohet natën edhe ditën. Kur shtegëton në jug, atëherë e tregon aftësinë e fluturimit të gjatë. Shkurta ushqehet në sipërfaqe të tokës, kryesisht ushqehet me fara, sytha të bimëve, filiza dhe gjethë. Folenë e bën në një gropë të cekë në tokë, e hap me këmbët e saj dhe e formëson duke e shtypur me trupin e vet. Është e përhapur dhe shumëhet prej Europës e deri në Siberinë Qendrore, Mongoli dhe Iran, Indi Veriore, Afrikë dhe Madagaskar. Zogjtë e Euroazisë gjatë dimrit shtegëtojnë sa më në jug të Afrikës Qendrore dhe Indisë.



Familja ACCIPITERIDAE,
Lloji *Circus pygargus*, **MONTAGU'S
HARRIER, SHQIPJA E
BALLTAQEVE**, gjatësia 39-50cm,
gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Vizitor gjat verës, dimrit shtegëtojnë
në Afrikë. Shumohen në fusha të
hapura, ligatina, lëndina përgjat
fushave të mbjellura, shkurrishte të
shkurtëra. Ushqehet me sisor të vegjël
dhe zogj, hardhuca, insekte. Folenë e
bën në tokë.

Shqipja e balltaqeve

Shqipe me këmbë e kthetra të kuqe,
Qëllon nga bregu me atë kokën
pëllumb,
I kap zogjtë, s'i lë të bëjnë huqe,
Prandaj sqep i vogël i godet si plumb!

Jo mori, larg duart nga këngëtarët e
bukur,
Ata kënaqin veshin tim vazhdimisht,
E po ata krahët e tyre sikur flutur
Boll i ndoqe Shqipe baltave gabimisht.

Ata tinza teje ma heqin mërzinë përditë,
Llullën tënde mos e ndal n' verandë,
Ta di mirë Balltaqe nisja e kllaçit,
Ata minjtë t'pushojnë pa ty si
n' Sarandë!

Qepju Laraskave siç e ke zanat,
Edhe ato janë soj i grabitçarëve,
Vetëm ato shqyeji e bëri sallatë,
E hiqjau flamën, të lutem manareve!

Shqipja e fushës

Shoqe-shoqe kollomoqe,
Qëndron ti dhe Shqipja e kënetës,
Ih sa t'vogla, por skërmoqe,
Prandaj zogjtë ia shtroni vetes.

Jeni t'bukura si Gugaçe
Ani se jeni kriminele,
E ato zogat shih sa hutaqe
Fushës ikin nga ti rebele!

Ushtojnë përrenjtë nga zë i
mekur,
Shumë nga to qajnë sikur fëmija,
Ëhë copëtohet më trup i vdekur,
S'ndihet zhurma e këngeve t'mia!



Familja ACCIPITERIDAE,
Lloji *Circus cyaneus*,
HEN HARRIER,
SHQIPJA E FUSHËS,
gjerësia 39-50cm, gjinitë e ndryshme, shtegëtar.

Kjo specje është tipike shqipja e fushës, gjuan prenë duke fluturuar me shpejtësi shumë mbi tokë, fluturon rrëshqitshëm. Krahët zakonisht i mban në formë të shkronjes "V". Kjo metodë i mundëson këtij zogu ta zë zogun tjetër të vogël apo të gjymtuar, brejtësit e vegjël apo insektet. Këtë specje mund ta hasim në keneta, ligatina, stepe kullotash, dhe dunat ranore. Folenë e ndërton në tokë me shqopishte të shkurtëra dhe kallame. Shumohet në pjesën më të madhe të Amerikës dhe Euroazisë. Dimrat i kalon në jug të Amerikës Qendrore, Afrikë Veriore dhe Azi jug-lindore. Femra është më e madhe se mashkulli.



Familja ACCIPITERIDAE,
Lloji *Circaetus gallicus*,
SHORT-TOED EAGLE,
SHQIPONJA GJARPËRNGRËNËSE,
gjatësia 62-69cm, gjinitë e ndryshme,
shtegëtar.

Vizitor i verës. Dimrat i kalon në Afrikë. Eshtë zog i rrallë, 4000 qifte në regjion, shumicën e tyre e hasim në jugperëndim. Shumohet kryesisht në vendet të thata malore dhe pyje të shpërndara, në veri gjithashtu i hasim në lugina lumejsh, pyje. Ushqehet me reptile. Folenë e ngre në lis.

Shqiponja gjarpërngrënëse

Ikën qiellit dhe këlthet,
Për dashnor zemra i digjet,
Se pa ty Shëiponji mbret
Thahen kënetat, thahen brigjet!

Hapin sqepat, hapin krahët,
Rituali gjatë vazhdon,
Sa krenar Shqiponji mbahet,
Vezët n'çerdhe pse i shton.

Nis prolog e monolog
Me ato klithma n'fole t'vet,
Dialog me epilog
Kaçubeti poshtë i zbret!

Kja-vjau n'gjueti,
Gjarpërinjtë n'dasëm grish
Jeni t'vegjël zogj të mi,
Tash mamaja ju sjell mish!



Shqipja e kënetës

Shqipe e vogël, por sqepkërryle,
Qëllon ashpër edhe pret,
I ka këmbët si t'një pule,
Por ka thonjtë thikë e vërtetë!

Ju s'e dini sa është kënaqësi
Ashtu t'përgjosh heshtur
n'kënetë,
E pret hardhucën a miun e zi,
Kap bretkocat mendjelehta.

Është e bukur posi pëllumb,
Ndërsa këngën ma zë n'thua,
E marr pushkën dhe ruaj te shpia!

Ta di Shqipe t'vras me plumb,
Është mirë t'çaj në zoçkat e tua
Se sa t'qajnë zoçkat e mia!

Familja ACCIPITERIDAE,
Lloji *Circus aeruginosus*,
MARSH HARRIER,
SHQIPJA E KËNETËS,
gjatësia 43-55cm, gjinitë e ndryshme,
shtegëtar.

Shumohet në ujra të ëmbla dhe të cekta, lumejsh, liqenesh. Përveq qe shtegëton në jug dhe perëndim, gjat dimrit shtegëton edhe në Afrikë. Ushqehet me sisor të vegjël, zogjë, insekte. Folenë e bënë në shtratin e kallamishteve të gjata.



Familja ACCIPITERIDAE,
Lloji *Aquila pomarina*,
LESSER SPOTTED EAGLE,
SHQIPONJA E VOGËL E ROSAVE,
gjatësia 55-65cm, gjinitë e njejta,
shtegëtar.

Vizitor gjat verës dhe ate duke filluar prej prillit e deri në shtator, dimrit zakonisht shtegëtojnë drejt Turqisë dhe Lindjes së Mesme. Shumohen në pyje dhe zabele të hapura. Ushqehen me sisor të vegjël, amfibe, me disa zogjë dhe insekte. Folenë e ndërton në lis.

Shqipja e vogël e Rosave

Shtrohet në kënetë pa t'voglin zë,
Qemet në ëndrrat e shumta t'pritjes,
I vete mendja " S'po luan gjë!",
Prandaj fillon zjarr i mërzitjes.

Obobo ç'është kjo zhurmë në kënetë,
Një Rosë po vjen me ga-ga-ga,
Aman mamushi t'vegjlit i thërret
E kjo do hidhet rrufe mbi ta.

Rendni bija, rendni- ajo u thotë,
Oho plot nga to nja gjashtë a shtatë,
Se nuk jeni loke në votër!

Ajo sqepkërrylja jo s'përgjon kot,
Veç njërën nga to e bën sallatë,
E tjerat mbesin mangut pa 'i motër!



Vallja e Shqiponjave

Vështroj thepave valle të Shiponjave
 Ah si e gjuajnë gjahun nga shoqja në shoqe,
 Llupë e syrit sheh shkathtësinë e zonjave
 Eh ç'akrobaci nga ato skërmoqe!

E në qiell luajnë me prenë si me top,
 Shtyhen cila do ua çoj zoçkave dhuratë,
 Qepin përthonjsh të ngratin me hopa-hop,
 I sheh syri bukur, po lotët s'ndaleën gjatë!

Perandorakja kokën e bardhë si borë,
 Obobo të Artës penda i shkëlqen,
 Njëherë s'u ndalet simboli në flamur!

Ah vallja e bukur si luhet dorë më dorë,
 Vetëm lë të hidhet se shpirtin ma rrëmben,
 E nga kënaqësia mos të ndahem kurrë!




Shqiponja e maleve

Shumë e rrezikshme pas kecape n'mal,
Që janë kopatur e rrinë n'Kopaça,
I leh si qen me klithmat zjarr,
Përfundojnë n'kthetra ata lazdraça!

Oj Shqiponjë mali, Shqiponjë e artë,
Një sulm të tillë cjeptë se durojnë,
Ata t'vërsulen me brirë të kaftë,
E dinë se t'vegjlit ndihmë po kërkojnë.

Merre me t'mirë pakëz vetveten,
Atje në thepa , larg në Pikëllimë,
Lëre të qetë kopenë n'blegërimë!

Edhe bariu ka qifte t'veten,
Varg t'i lëshon saçmet mbi shpinë,
E ç'të bëjnë zogjtë pa sokëllimë?!



Shqiponja perandorake

Moj Shqiponjë perandorake,
Më e bukura ndër Shqiponja,
Qafa jote pak fthllake,
Kokëbardhë si loke zonja.

Rri në dyer t'perandorive
Ballëhapur e krenare,
T'u klithë ashpër historive
Nëpër shekuj n'luftë barbare.

Çerdhja jote në muze
Nëpër vula e nëpër letra,
Për luftarë e për atëdhe,
Moralmadhe n'kohë të vjetra!

Familja ACCIPITRIDAE,
Lloji *Aquila heliaca*,
IMPERIAL EAGLE,
SHQIPONJA PERANDORAKE,
gjatësia 70-83cm, krahët e hapur
175-205cm, gjinitë e njehta, pjesërisht
shtegëtar.

Eshtë specje e rrallë dhe zakonisht
shumohet në Europën Lindor dhe ate
jug-lindore, në pyje dhe stepa apo edhe
në fusha të gjëra, gjithashtu shumohet
edhe në pyje të larta mbidetare.
Ushqehet me sisor dhe zogjë. Folenë e
ndërton në lis.



Familja AEGITHALIDAE,
Lloji *Aegithalos caudatus*,
LONG-TAILED TIT,
TRISHTILI BISHTGJATË,
gjatësia 14cm, gjinitë e njejta, jo
shtegëtar.

Zakonisht është zog aktiv dhe shumë kureshtar, ky zog i shkathët zakonisht duket në tufa të vogla dhe atë nëpër maje të pemëve. Zogu lëshon vazhdimisht nota me zë të hollë “zee-zee-zee”, thirrje eksplozive duke hulumtuar insekte dhe fara. Folenë e ndërton në formë kubeje me hyrje anësore, e ndertuar me materiale të ndryshme duke përfshirë myshkun, leshin, dhe rrjetën e marimangës të mbuluar me likene, e mbështjellur me pendla dhe shpesh e hasim në shkurre gjembaqe. Është i përhapur prej Euroazisë e deri në Japoni.

Trishtili bishtgjatë

Ta dua sa shumë atë bishtin e gjatë,
Resht kokës larat bardhë e zi,
Ih për ato flatra sa ta çojnë inat,
Shumë e bukur gusha e tëra
n’verdhësi.

Trishtil,ato zoçka vallë kur i rrite?
I bëre këmbë e dorë,i qite në dritë,
Lë po në ato dega vezë tjera kllloçite,
Sa shpesh shtohesh, dhjetë herë në vit!

Bah dhe ato nota cicërrimë e butë,
I luan n’violinë edhe kur ka borë,
Shtruar ia merr ballkonit pa tutë,
T’i di hallet tua edhe kur je n’zor.

Gjallojnë dhe Skifterët voglush në
Zabel,
Ai syri i tyre të sheh si n’dylbi,
Ta shkurtojnë bishtin e ta bëjnë cubel,
Ëndrra kaq e bukur të kthehet në zi!



Trishtili i kaltër

Të shoh o Trishtil duke mbledhur
koka,
Radhitur ke vijat si në qiell vere,
Iha gushëverdho kur të shoh në boka,
Shtohet poezia si mjalti n'koshere!

T'i dua dhe zoçkat sqephapur n'fole,
I kanë cicërrimat lutje për uri,
Lëri ato ndeja te Ara e re,
I lypin insektet që të ketë qetësi!

Kaltërosh i vogël sa herë t'vjenë në
mollë,
Aty të qëndrosh për një kohë të gjatë,
Lërmi disa nota që t'i marr në shkollë,
T'i vë n'partitura n'simfoni të shtatë!

Ëmbëlsirë do jenë për vargjet në rima,
Rimat nëpër strofa me kokën n'hava,
Ose akrostikët kënaqen në tingëllima,
Shihe vjershën nuse që merr temena!

Familja AEGITHALIDAE,
Lloji *Parus caeruleus*,
BLUE TIT,
TRISHTILI I KALTËR,
gjatësia 11.5cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

Eshtë e mirënjohur si zog i kopshteve, trishtili i kaltërt gjithashtu është i përhapur në pyje, zabele e kodrina. Ushqehet me insekte, fara e fruta. Folenë e bën me myshk, kullosë, e lidh me fije bari dhe pendla, në një zgavër të një lisi apo muri, apo edhe në një kuti folenizimi prej druri. Eshtë i përhapur në Europë, disa pjesë të Afrikës Veriore dhe Lindjes së Mesme. Eshtë gjithmonë i gatshëm të gjurmojë ushqime të freskëta, gjithashtu vërtetohet se për shumim mund t'i përdor kutit folenizuese dhe kështu mund të konstatojmë se trishtili i kaltërt na paraqitet si zog që shpesh i frekuenton kopshtet.



Familja AEGITHALIDAE,

Lloji *Parus montanus*,

WILLOW TIT,

TRISHTILI I MALEVE,

gjatësia 11.5cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

Shumohet në pyje halore, shpesh në lartësi të mëdha lisash dhe në lartësi pyjesh me mëshstekna, gjithashtu e hasim edhe në pyjet e Europës perëndimore dhe asaj Qendrore në vise më të ulta në pyje gjethrënese të përziera me meshtekna, ah dhe shelg, i hasim përgjat lumejve, në shkurre dhe në kënetat më drujë. Gjat dimrit nuk është parë në hambare ushqyes. Folenë e ndërton në trung të hollë e të kalbur.

Trishtili i maleve

Trishtili i maleve

Sot ka rënë në hall.

Stop u thotë valleve

E stuhisë dy fjalë:

Ushto Zabel, ushto,

Dimëron Trishtili,

Borën mos e shto,

Do fiket kandili!

Të ftohtët mos i zbrit,

Në minus njëzet,

Ani se ka dritë,

Fare nuk ka jetë!

Vëllain Harabel,

Të voglin Trumcak,

I shoh zhelemel

E ushqim aspak!

Korbat i thejnë boçat

Piku tikrren zi,

E di ç'na thonë doçat:

Mblidhni rraquet n'shpi!

Shton borë e stuhi,

Ul temperaturën,

Unë me tri-li-li

Trishtoj katrahurën!

Nga bora vajet s'ndihen,

E qite me tavan,

Veç oxhaqet shihen

Duke pirë duhan!

Trishtili i madh i murrmë

Pse më ndjek xhaxha,
Rrugës kur shëtis,
Kjo dëborë që ra,
Shpirtin ma molis.

Me fjalë më përgdhel,
Të ftohtë bën rrugë,
O në dorë më merr,
O më qit ca bukë!

S'e kam me shaka,
Mëzi dola n'dritë,
Dua diçka t'ha,
Ta shpëtoj këtë shpirt!

Sa bëj të afrohem,
Ti shkon fluturim,
Me ty si t' shoqërohem,
O Murrashi im?!

Xhaxhi të ofron
Gjithçka në shtëpi,
Dua këtë zezonë,
Ta kalosh disi!

Sa te kjo shitore
Para plot dëborë,
Çka të bjerë përdore,
Gllabëro o i gjorë!

O Trishtil murraku,
Dimri është i gjatë,
Duku te konaku,
Ke petulla e mjal!

Veç ma fal pranverën
Me nota e lara,
Hapur e mbaj derën
Për ty o lum lala!



Familja AEGITHALIDAE,
Lloji *Parus lugubris*,
SOMBRE TIT,
TRISHTILI I MADH I MURMË,
gjatësia 13-14cm, gjinitë e njejtë, jo shtegëtar.

Shumohet në pyje gjethrënësë në shpatije malore apo edhe më ulët, në terrene gurore me lisa dhe shkurre, shpesh e hasim edhe në plantazhe të pemëve. Është zog vëndor. Ka sjellje joimponuese.



Familja AEGITHALIDAE,
Lloji *Parus palustris*,
MARSH TIT,
TRISHTILI I VOGËL I MURMË,
gjatësia 11.5-13cm, gjinitë e njejta, jo
shtegëtar.

Shumohet në pyje me lisa të trashë të cilët tanimë po kalben, gjithashtu shumohet edhe në kopshte dhe parqe të mëdhenjë me lisa dhe pemë të vjetra. Është zog vëndor. Gjat dimrit mund të shihen në hambare apo tabela ushqyese. Nuk frikohen. Janë më dominant se trishtili i maleve. Folenë e ndërton në zgavër (të cilën e ka bërë trishtili i malit, në kutija folenizimi apo edhe zgavra artificiale, etj.)

Trishtili i vogël i murrmë

Trishtil i malit, i vogli murrak.
Rënkon nga bora e nga uria,
I le bjeshkë e male e erdhe pak,
Shërim t'gjeshtë në pemët e mia?!

Tani del xhaxhi e të ushqenë,
I ke ato klithma plot vaj e lutje,
Lemza e shkretë sa të rrëmbenë,
Idol të kam, mos shko tutje!

Vrau dimri e vrau bora,
Ofshamat tua gjëmojnë si mal,
Gropose n'zemër këdo o djalë!

Ëma e jote iku si sorra,
Larg teje vajti në tjetër fshat,
Ombrellë për ty që s'e ke ngat!

Shërim do gjeshtë këtu lum jarani,
Mysafira kam nga dy dinokë,
Ububu Genti e Ariani,
Rrotull shkojnë shpishë të ulesh
n'tokë!

Aman Trishtil kënaqu n'ballkon,
Këngën ta dua kur t'vjenë
pranvera,
Ububu Nexha të fokuson,
Inati t'shkoj, hapur t'rri dera!

Medet poeti ato oktava,
Ashtu t'i vë mirë nëpër rima,
Lavroje këngën me nota t'ima!

E nëse një ditë bëra të shava,
Vazhdoje këngën, janë fjalë të
kota,
Edhe përmbys po vajti bota!



Trishtili i zi

Të gjithë o voc të quajnë kokëzijos,
Radhitur ke pikat si notat
n'pentagram,
Ia shkon hujin dimrit përmbi kosh,
Shtrenjtë t'kushtonë kënga Trishtilo
babaxhan!

Ti riprodhohesh dhjetë herë në vit,
Ia marrin ëmbël dhjetë voca te molla,
Lum bën natyra që shtohesh përditë,
Mbrenda dy jave me nota të holla!

Ato lara t'zeza barkut edhe shpinës,
Dhuratë për syrin dimër edhe verë,
I ruaj si perla në shpirt e zemër!

Yshti si plakat rrëmbyes të shkinës,
Nuk kanë fytyrë ata të mjerë,
Është turpi i turpit ta nxijnë këtë
emër!

Familja PARIDAE,
Lloji *Parus ater*,
COAL TIT,
TRISHTILI I ZI,
*gjatësia 11cm, gjinitë e njejta, jo
shtegëtar.*

Gjendet gjithandej llojeve të ndryshme të pyjeve, ushqehet me insekte dhe ate prej një maje tek një maje tjetër lisi, por shpesh vjen në nivele të tokë për të folenizuar. Fole në formë filxhani dhe ate nga myshku, e vëndosur në një zgavër të lisit, trungut apo në pìrg. Është i përhapur në pjesën më të madhe të Europës, disa pjesë të Afrikës veri-perëndimore, Lindjes së Mesme, Siberisë, Azisë Qendrore dhe asaj Lindore.



Familja PARIDAE,
Lloji *Panurus biarmicus*,
BEARDED REEDLING,
TRISHTILI ME MUSTAQE, *gjatësia*
14-15.5cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

I vetmi zog në Europë që e prezanton familjen babler, por të afërmit e tij në numër më të madh i gjejmë në Afrikë dhe Azi. Shumohen në koloni përgjat shtratit të kallamishteve në brigjet e liqeneve, ligatinave dhe moqaleve. Shumicën e rasteve jan vendor por të shpërndarë, gjat vjeshtes tubohen në grupe dhe kështu përmby liqene dhe moqale bëjnë ekzibicione joshëse, disa prej tyre shtegëtojnë më në jug. Kur marin dimra të ftohtë zvoglohet numri i tyre. Ushqehen me insekte dhe fara të kallameve. Folenë e ndërtojnë në kallamishte.

Trishtili me mustaqe

Ti kur këndon mbi Kuklibeg,
Rëndon gjumi ndër shtëpia,
I thërret njerëzit aty n' breg:
Shkoni mblidhni n' bjeshkë qershia!

Të gjithë zgjohen si përherë,
I lajnë sytë të heqin gjumë,
Lum po bëjnë për ty o verë,
Me gëzim po shkojnë në punë!

E atje në Bjeshkë të Sharrit
Mbledhin kokërrat me kujdes,
Ububu Trishtil i malit
Sa na gëzon për çdo mëngjes.

T'quajnë Trishtil me mustaqe,
Anash larat pse t'rrinë zi,
Qulle këngën aty n'baqe,
Edhe vargu do si ti!



Trishtili me napkë

Ti mbi Kapre çfarë na thua:
Rendin vocat n'Koligjon!
I ke fshehur zoçkat n'përrua,
Shkojnë t'i shohin babaxhan!

T'i duan ato loçkat tua,
I duan me napkë mbi kokë,
Luajnë me ta për ty e mua,
Mandej vërejnë mos t'bien
n'tokë!

E ashtu t'kënaqur kthehen n'shpi,
Nesër atyre u çojnë insekte,
Ata i hanë si peksimete.

Prandaj dhe gajle hiq mos kij,
Këngën vazhdoje hiq pa përtrim,
Ëndrra sa kënaqet në vargun tim!

Familja PARIDAE,
Lloji *Parus cristatus*,
CRESTED TIT,
TRISHTILI ME ÇAFKË,
gjatësia 11.5cm, gjinitë e njejta, jo
shtegëtar.

Zog i cili identifikohet me napën e tij të but maja maja, këngën tre notëshe. Trishtili me napkë është zog të cilin e hasim në pyjet halore. Shumicën e vitit ushqehet me gjethe pishe dhe ate në maje të lisit që është shumë vështirë për ta vërejtur. Ushqehet me insekte, fara dhe mana. Folenë e ndërton në zgavër të drurit të kalbur, qe zogu vet e zgavron me sqepin e tij. Është i përhapur në Spanjë dhe gjithandej Europës deri në Azinë Qendrore.



Familja PARIDAE,
Lloji *Parus major*,
GREAT TIT,
TRISHTILI I MADH,
gjatësia 14cm, gjinitë e njejta, jo shtegëtar.

Më i madhi dhe më i guximshmi se shumica e trishtilave tjerë, ky zog jeton në pyjet gjethrënese apo edhe në ata të përzier, ferma, parqe, dhe sipërfaqe gjysmë të përziera. Pas harabelit ky është zog që e shohim më shpesh në oborret dhe kopshtet tona. E paralajmëron prezencën e tij me një zë të bujshëm dhe të përsëritshëm. Dijeta e tij përbëhet nga insektet dhe frutat. Gjat dimrit edhe me fara nëpër hambare dhe tabela ushqyese, sidomos luledielli. Folenë e ndërton me bari të mire dhe e vendos në zgavër të drurit apo murit apo edhe në kuti folenizuese. Është i përhapur në Europë, Afrikën veri-perëndimore, pjesë të Siberisë dhe Azisë Qendrore, subkontinentin e Indisë dhe në Azinë jug-lindore.

Trishtili i madh

Zallamahi e kësaj bote,
Obobo ç'të thau ç'të teri,
Gongje peme kënga jote
Uthull bëhet nga Skifteri!

Pa shih larat bardhë e zi,
Anës kokës , anës shpinës,
Rendin barkut viza-vijë,
Ulur ëmbël n'sfond t'verdhinës.

Syrin mbyllur nuk ta dua,
Madje kënga le t'jehojë,
Ashtu ëmbël atje n'lis!

Jo rrëmbyesit s'janë drangua,
O prit se thonjtë ua shkurtoj,
Rrafsh dhe sqepin ua bëj pis!

Trumcaku

Të shoh të kaftë mbi shpinë o
vogëlush,
Rend shumë shpejt nga dega në
degë,
Ulur nëpër pemë sa një gogëlush,
Medet zë i ëmbël shijën sikur shegë!

Cik-caket ndër mezhda fare s'kanë
të ndalë,
Ashtu zvarritur shkon dimër edhe
verë,
Këtu në Sharr borën e bën përrallë,
Uh edhe dimrit këndon
pandërprerë!

Kënga jote i bukuri bishtpërpyetë
Ë-në e bën uthull, pikat ia ngrin,
Ndërsa mua jetën me orë ma
përtërin!

Dorën zgjatma ore të të jap rryshfet,
Oh ke grur e mel për çdo cicërrimë,
Ndërro melosin, ndërro, rima ulërin!



Familja TROGLODYTIDAE,
Lloji *Troglodytes troglodytes*,
WREN,
TRUMCAKU,
gjatësia 8cm, gjinitë e njejtë, jo shtegëtar.

Ky zog i imt, me sqep të hollë dhe me mënyrën e fshehtë të sjelljes së tij, e hasim në pyje, zabele, ferma, kullota dhe kopshte. Shihet i vetmuar mbase gjithmonë është i zënë duke kërkuar insekte në vënde të koklavitura. Kënga eksploduese e këtij zogu të mahnit nëse e krahason me trupin e tij të vogël. Folenë në formë kubeje të formësuar me bari, gjethe dhe myshk, me hyrje anësore e vëndos në një të çarë apo diku nën strehë. Është i përhapur gjithandej hemisferës veriore. Amerikanët i thonë "trumcaku i veriut".



Familja COLUMBIDAE,

Lloji *Streptopelia turtur*,

TURTLE DOVE,

TURITULLI,

gjatësia 28cm, gjinitë e njejtë, shtegëtar.

Është më i vogël se pëllumbi i egër, i gjatë 28 cm, me pendë ngjyrë hiri në të verdhë. Në të dy anët e qafës ka zbkurime. E ngjashme me të është *S. decaocta* (kumria), që ka ngjyrë hiri dhe një larë në fund të qafës. Femra bën dy vezë dhe pas 14-16 dite çelin të vegjlit. Ushqehet me kandrra, krimba, larva dhe gjëra tjera, me të cilat ushqehet njeriu. Janë të përhapur në Evropë, ndërsa Lloji i dytë është më i përhapur në Shqipëri, Kosovë dhe në tërë Ballkanin.

Turtulli

Turr-turr, turr-turr,
Thërret Turtulli Pëllumb të egër,
Eja t' shkojmë njëherë në Zhur,
O të ikim diku n' Zhegër?!

Pendës së hirtë me ngjyrë t' verdhë
Anës së qafës pika i rrinë,
Ah ç' model arti natyra derdh,
Kur n' fluturim merr arratinë!

Artin natyra e shtron n' tryezë,
Kur rri mbi çerdhe, të kënaqet xhani,
Sa bukur dukesh përmbi dy vezë,
Dhe pas dy jave kur t' thërrasin mami!

N' fillim u jep qumështin nga goja,
Pas pak dhe krimba për çdo mëngjes,
Ushqeni t' vegjlit, filloi më loja,
Turtull zotëria i ndan n' dy pjesë!

Ah Turtulleshë, moj Turtulleshë,
Kënga e jote mbet' sinonim,
Të t' quaj Kumri a Pëllumbeshë,
Mos po gabon ky shpirti im?!



Turtullesha

Plot Pëllumba e Kumria
Dhe Bilbila e Mëllenja,
Janë tubuar sot te shpia,
Ia thonë ëmbël plot me ndjenja,

Bashkë me ta dhe Turtullesha
E çon zërin në këtë kor,
Në stinë t'luleve mbretëresha
Shih e para po heq horë!

S'i shpërfill normat e ngurta,
Të asnjë kohe n'estetikë,
Gjithë me nota të purpurta
Fton Turtullin në piknik!

S'mund t'ia bëni mendjen klinë,
Se vetë zysha kështu e do,
Është e para n'orkestrinë,
Koerografe po se po.

Zyshta është shumë transparente,
Për të gjithë edhe për ju,
Ligjëron e nuk qet bente,
Ylberinë është n'qiellin blu.

Po i ka dhe dy kunata
Një Kumri e Pëllumbeshë,
Që s'i ndan dita e nata,
Me këtë nuse Turtulleshë.

Sikur veglat muzikore
Janë një trio n'harmoni,
Guguftu janë të një dore,
Vetëm që ua kem' zili.

Sot mbi dega ja mban orë,
Herët- herët në mëngjes,
I përcjell fëmijët për shkollë,
Plot me pesa thotë ju pres!



Tre shokët

Turtulli, Pëllumbi e Kumroshi
Të tre një ditë u bënë shokë,
Shikojnë ëmbël lart nga koshi,
Çfarë u gjuaj unë në tokë.

Arianitit i qesh fytyra:
Paj këta qenkan te tre njësoj!
Kur plasi kënga me tri ngjyra:
Tha se ndoshta po gaboj!

Nis Turtulli me plot turra
Dhe Kumroshi e Pëllumb i ri,
Genti tha: -Po këta tre burra
Mirë ia thonë n'polifoni!

Ky kolazh në kamuflazh
Është i bukur si një vashë,
Vetëm vargu në bagazh
Mund ta mbajë në avantazh!

Thëllëza e malit

Sa margaritarë i ke në qafë,
Thuaje lum Thëllëza e malit,
Zemra ime shpesh m'bën baf,
T'i përgëdheli për qejf t'djalit.

Dukesh aristokrate
Me atë qafën sikur brymë,
Dhëlptra e Shqipja me zanate
Nuk të lënë të marrësh frymë!

Me ko-ko a i rrit vezët
Në atë gurishtë pandërprerë?
Në babine thirri dhe tezet
Kur të bëhesh me të tjerë!

Trembëdhjetë zogj në dritë që
qite,
U bën nani atje te lumi?
Si në djep urimin prite,
Nga këto vargje t'i merrë gjumi.

Pupla t'dendura ngjyra-ngjyra
Seriozja e syrit tim,
Kështu do thuash ruhet fytyra
Që t'më mbajnë për sinonim!

Ko-ko-kotë s'i ndale kurrë,
Edhe këngën me jehonë
Të përcjellin zogj e burrë,
Atje n'përrua mori zonjë.

Me kënaqësi motrës së vogël
Thëllëzë mali të gjithë i themi,
Edhe pse është sa një gogël,
Kur gugat Thëllëzë i themi!



Familja PHASIANIDAE,
Lloji *Perdix perdix*,
GREY PARTRIDGE,
THËLLËZA E FUSHËS,
gjatësia 32cm, gjinitë dallojnë shumë pak,
jo shtegëtar.

Jeton në grupe. Specia është gati e ngjashme me thëllëzat e tjera. Shpend tipik i vendeve malore të pjerrëta me orientim nga jugu, maleve të zhveshura, me bimësi të pakët. Folëvizimi ndodh nga fundi i prillit deri në qershor. Femra lëshon 8-14 vezë dhe periudha e inkubacionit zgjat 24-26 ditë. Të vegjlit janë të aftë për fluturime të shkurtra në moshën 7-10 ditore dhe të aftë të fluturojnë plotësisht pas 50-60 ditësh. Ushqehet me bimë dhe insekte. Thirrjet tokësore janë zakonisht tinguj shumë të fortë grykorë, në seri të shkurtra e të çrregullta që ndërpriten nga një seri “ ç-çek-pe-ti-çek”.



Familja CHARADRIIDAE, Lloji

Charadrius dubius,

LITTLE RINGED PLOVER,

VRAPONJËSI I VOGËL,

gjatësia 32cm, gjinitë dallojnë shumë pak, pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në toka të zhveshura, vënde ranore dhe në terrene me shumë zhavorr dhe ate afër ujrave të ëmbël, psh.lumejve, liqeneve apo ishujve, shpesh i hasim në gropa uji dhe zhavorri ku njeriu e ka eksploatua materialin e lumejve. Verës e vizitojnë Europën dhe dimrojnë në Afrikë. Zakonisht në të shumten e vëndeve duket vetem, por ka mundësi që të shihen edhe në grupe të vogla gjat shtegëtimit. Ushqehen me insekte. Folenë në gropë të cekët apo edhe në tokë të zhveshur.

Vrapuesi i vogël

Vrap shkon detit vogëlush,
Rend ashtu si n'maratonë,
Ato goca papalush,
Po të presin deri vonë!

Uh se ç'bukuri derdh,
Eh se ç'dhëndër i ri,
Sytë e zi me rreth të verdhë
I ke anash mrekulli!

I ke larat zi e bardhë,
Vërtet sqepin sikur mashë,
Oh për vetullat tua vashë!

Gushën ma ke sikur dardhë,
Ëmbëlsirë që ndjell gocat,
Lëre vrapin, lëri vocat!

Verduni (Finqi i gjelbër)

Finq i gjelbër, Verdun lisi,
I ke farat shumë merak,
Në pranverë kush ia nisi,
Qullet kopshti me kajmak!

I ke notat gjithnjë t'plota,
I ke notat shumë të zjarra,
Muzikë bën me ato t'ngrohta,
Ia merr dhe netëve t'gjata.

Gjelbërosh, Verdun i vogël,
Edhe mua më mbush gëzim,
Lirshëm merrja n'kopshtin tim!

Bre sa ashpër bërtet n'kodër,
Ë-ja pse ra në pikëllim,
Rend mbi ty Skifteri trim?!



Familja FRINIGILLIDAE,
Lloji *Carduelis chloris*,
GREENFINCH,
VERDUNI,
gjatësia 13cm, ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Verduni (gjelbroshi) zakonisht shihet në kopshte dhe fusha. Meshkujt sillen mbi lisa, sidomos në pranverë. Kënga e tyre muzikale këmben nota të gjata dhe të ashpra, i imiton finchat tjere. Përbërja e dietës së tyre është: fara, mana dhe insekte. Fole kaba në formë filxhani, e formësuar me kërcejë të barishtave dhe materiale tjera të bimëve, e vëndosur në shkurrë, dëlli apo lis. Është i përhapur prej Europës dhe Afrikës Veriore e deri në Azinë Perëndimore. Gjat dimrit mund të shtegëtoj diku në jug të këtyre vëndeve. Gjat dimrave të ashpër frekuentojnë edhe në kopshte.



Familja SITTIDAE,
Lloji *Sitta tephronota*,
ROCK NUTHATCH,
ZVARRITËSI I SHKREPAVE,
gjatësia 14-15.5cm, gjinitë e njejta,
pjesërisht shtegëtar.

Shumohet në terrene gurore (shpesh i vetmuar) me shkurre të shpërndara dhe lisa të ndryshëm. Folenë e bën në të qarë të shkëmbit, të formësuar me baltë, të mbyllur, dhe pëmes një tuneli mund të arrij deri tek vezët ose tek të vegjlit e tij.

Zvarritësi i shkrepave

Zvarritu ashtu shpejt të çuditet bota,
Vazhdo nëpër shkropa pandërprerë,
Atje çerdhen e kurdís me nota,
Rreth e m'rreth me bar si përherë.

I ke ca pika përmbi shpinë të hirtë,
Të dukesh larosh me atë sqep të zi,
Ë-ja nuk ngutet me lotët o shpirt,
Sall ti ruaju nga ajo Skifteri!

Ih sa shpejt sillesh nëpër dega,
Ih sa shpejt ecën nëpër lis,
Merria zog-o me lahutë si gega,
I ke t'ëmbla kreshniku pa plis!

Shtrije këngën në Xërxe pëmbi mal,
Kokën kujdes nga dada Gjeraqinë,
Rend e merrja plot potencial,
E mos qit pluhur si mëzati përmbi shpinë!

Popo n'çerdhe cicërrojnë zoçkat te Nërgura,
Ata Zvarritushë që rrinë duke pritur,
Vetëm ti ushqej me krimba babura,
E unë të kënaqem duke i soditur!

Zvarritësi krahëkuq

Zvarrë shkon zvarrë te Sofra e lepurit,
Vapë a ftohtë ti nuk ke të ndalë,
Ah me kthetra ç'art i të qepurit
Rrallëkush mund si ju zvarritës,rrallë!

I ke krahët e kuq si trëndafilat,
Të ndezur që t'i shohësh pritrat,
Është se të përcjellin debilat,
Sa shpejt ata mund t'i fikin dritat.

Ikën sa shpejt gurëve poshtë e përpjetë,
Kalaja e Prizereni krahëhapur mbesin,
Rend o Pëllumbth këndeje se na mbush
jetë,
As mos harro të vegjëlit që gojëhapur
presin!

Hutave,Gjeraqinave shpesh t'u kesh
kujdes,
Është rrezik se ata të mbajnë në sy,
Këngën ta ndalin ore atë mëngjes,
Uh kot pastaj ç'të bëjë krahëkuq pa ty?!

Qaj për krahët e kuq me zë fëmije,
Ylli ynë i shuar përmbi Prizeren,
Nisja e çerdhen me zogj tjerë përtërije,
I marr nën kujdes dhe pse ti s'më vëren!



Familja SITTIDAE,
Lloji *Tichodroma muraria*,
WALLCREEPER,
ZVARRITËSI KRAHËKUQ,
gjatësia 17cm, gjinitë e ndryshme,
pjesërisht shtegëtar.

Megjith përvojën ndaj këtij zogu mund të them se kjo specje vallëzon nëpër shkëmbijë duke kërkuar insekte me sqepin e tij të hollë dhe të gjatë. Gjat dimrit rrin i vetmuar në shkëmbë dhe tërë ditën kërcen andej këndeje në kërkim të insekteve. Folenë e ndërton në një të qarë të shkëmbit, ku e formëson nga rrënjët, myshku dhe kullosa, mandej e mbështjell me lesh dhe fije floku. Është i përhapur prej Europës e deri në Azinë Lindore. Zog thatanik, fluturon shpejt, mund të krahasohet me fluturimin e fluturës. Edhe tek ne është i rrezikuar për zhdukje.



Familja PARADISAEIDAE,
Lloji *Cicinnurus regius*,
PARADISE BIRDS,
ZOGJTE E PARAJSES,
gjatësia 28cm, gjinitë e ndryshme, jo
shtegëtar.

Zog me ngjyra ta forta, mashkulli i këtij Lloji të shumtën e kohës nuk bije në sy, fshihet në ultësirat e pyjeve tropikale. Kur është aktiv kërcen andej e kënde, prej një dege në tjetrën, pas insekteve, manave dhe frutave tjera të preferuara. Për ta zënë femrën, e gjen një dru te veçant për të iu vardisur duke vallëzuar, duke i hapur pendlat e tij, duke e ngritur bishtin e pendrave dhe duke lëshuar tinguj të ndryshëm ngazëllyes. Pas qiftimit, femra follenizon vetëm. Folenë e ndërton në formë filxhani në një zgavër të një lisi. Është i përhapur në ultësirat e Guinesë së Re.

Zogjtë e parajsës

Zogjtë e parajsës mahnitin përtej mase,
Obobo ç'mëndafsh i endur bardhë e
verdhë si shtregë,
Gjallojnë n'kontinente nëpër xhungla
vrasëse,
Të pyesin piktorët për pikturat n'degë!

Ëhë ç'vallëzim blu në sy e gushë
t'shpalosur
Endet dashuria ylber e ngjyer në dega,
Puls i zemrës matet nga art i vulosur,
Aman dashuri n'sa kokrra derdhet
shëga?!

Rendni me ato antena e gusha si ballon
,
Alo, Zogj parajse në zemër më bëni fole,
Ja tek më keni, zbritni plot hare!

Saherë shpirti im juve u shoqëron,
Ë-ë më shkojnë lotët pse rrini n'Guine,
S'e thatë cilin kat parajse keni për
atëdhe?!

Zboraksi

Nga kopsht i qershive në të
vishnjeve,
Si n'pallatin operistik,
Kurrë s't'u ndal hovi i grishjeve
Zborakesi simpatik!

Nga një pemë në tjetrën pemë
Si në qytetin poetik,
Dikë pret e nuk të vjenë,
Pse s'e thua i vogli mik?!

Zëri yt si një zile
Që nga mëngjesi nuk ndalet,
Syri jo s'të sheh me hile,
Më beso t'i kuptoj hallet!

E dashura ime sot më iku,
Të vegjlit dikah tretën,
Shpresat oh keq m'i fiku,
Në pemë mbeta qyqe vetëm!

Vuajtjet, thirrjet s'i mban karta,
Partiturat marrin flakë,
Notat janë tepër të zjarrrta,
Sa kam frikë mos bien n'lak!

Ja mor zog , zog zogushi
Dy vogëlushë vijnë me kamerë,
Nuk janë ngushtë për zë vejushi,
Po për pendët si ylber!



Familja FRINIGILLIDAE,
Lloji *Fringilla coelebs*,
CHAFFINCH,
ZBORAKSI,
gjatësia 15cm, ndryshon nga gjinia,
pjesërisht shtegëtar.

Zboraksi është zog i pyllnajave, gjithashtu adaptohet edhe në kopshte. Qafinqi ushqehet në tokë, gjat dimrit shpesh grumbullohen në tufë, duke u ushqyer me fara, fruta dhe insekte. Dimrit vjen edhe nëpër oborre për të kërkuar ushqim. Folenë e thur në formë filxhani të mbuluar me myshk, kryesisht e ndërtuar në degë të lisit apo edhe nëpër shkurra. Është i përhapur në Europë, në Afrikën Veriore, në Lindjen e Mesme dhe Siberi. Një numër i vogël gjat dimrit janë vizitor të Afrikës Veriore dhe Indisë. Në pranverë e nis këngën i pari dhe ate që në agun e mëngjesit.



Familja FINGILLIDAE,
Lloji *Serinus serinus*,
SERIN,
ZOG BARI SQEPSHKURTËR (zherri),
gjatësia 12cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Zog bari sqepshkurtër është finq i shpejtë me vija të gjelbërta e të verdha, është zog që pjesën e madhe të vitit nuk bie shumë në sy. Në pranverë mashkulli bën fluturime me lëshime spirale me një këngë të gjallë vërshtëllues duk lëshura një zë zhergimor dhe ate e bën vetëm për hatër të femrës – zhërrrrrrrrrrrrrrrr. Tagjia e zhërrit është: fara të imta në sipërfaqe të tokës. Folenë e vogël e thur me bari, rrënjë dhe myshk, e lidh me rrjetë marimange me fije të perimeve në formë filxhani të vëndosur në lis apo shkurrë. Më tepër është i përhapur në Europën Kontinentale, nëpër ishujt e detit Mesdhe, Afrikës Veriore dhe Turqisë.

Zhërri

Sqep të shkurtër ka Zhërri,
Qafë e kokë për trupi ngjitur,
E ndonjëherë vërshtëllen te verri,
Por gjatë vitit syve shqitur!

Shkon pingul, formon spirale,
Këngën lëshon me vërshtëllimë,
Ububu si baskitare,
Rend i gjallë në fluturimë!

Tagji e Zhërrit janë farat,
Rend i merr, me to ushqehet,
I ha dhe në çerdhe pastaj prehet!

Zhërri çerdhën e bën nga barërat,
Është se e thur nga myshku jeshil,
Rrënjë e marimangë për izolues të mirë!

Zhërri zhurmon Zhurin

Zhërri Zharrit zhurmon,
Zhërr-zhërr, zhërrit zhuli,
Zhërrrokëngën zhërrnçe zhvillon,
Zhurmon Zhegra, zhurmon Zhuri!

Zhërri Zhegurëve zhdrypet,
Zhbiron, zhvat, zhargitet,
Zhyhet, zhveshet, zhytet,
Zhërri zhelan zhuritet!

Zhërri zhdap, Zhërri zhgënjejhet,
Zhërri zhurmen zhërrnçe zhvillon,
Zhërri zhgërryhet, Zhërri zhdehet,
Zhërri zhvillimet zhbiron!

Zhërri zhargonet zhgreh,
Zhërri zhongler zhubravitet,
Zhërri zhërrisht zhegun zhdeh,
Zhërri zhdredh, zhbini, zhuzhitet!

Zhërri zharrin zhdap, zhaparit,
Zhërri zhabarin zhuburrëron,
Zhërri zhërrët zhdeh, zhuravit,
Zhurjançe Zhurit zhuzhon!



Zhytësi

Ciu-ciu alarmon,
I rri gati gjahut n'breg,
Në lumë kokën ëmbël lëshon,
Cullët t'i gostitë për drekë!

Loja luhet për çdo ditë
Ububu me pupazi,
S'ka si bëhet ndryshe shpirt,
Cullët lypin krimba n'shpi!

I ka n'çerdhe si llokum,
Nis ngadalë ua zbraz thesin,
Ciullojnë vocat:-Mami t'presim!

Lart çon flatrat, kthehet n'lumë,
Ulet-çohet me zë mbytës,
S'ka si mos ta quajnë Zhytës!

Familja CINCLIDAE,

Lloji *Cinclus cinclus*,

**DIPPER,
ZHYTËSI,**

*gjatësia 18cm, gjinit e njejt, pjesërisht
shtegëtar.*

Kjo specje ushqehet dhe shumohet në rrjedha të shpejta rrëkeshë, sidomos në vënde kodrinore. Zakonisht hec, madje ndonjëherë edhe noton nën ujë, duke e ndjekur prenë, që përbëhet nga larvat e insekteve dhe krustaceve. Emri i tij rrjedh nga levizjet e tij të shpeshta "bobbing". Folenë e ndërton në formë sferë të madhe me hyrje anësore, e ndërtuar nën rënjën e ujit dhe e formësuar nga myshku, bari dhe gjethet. Është i përhapur kryesisht në regjione kodrinoro-malore të Euroazisë dhe Afrikës veriperëndimore.



Familja BRAMBLING,
Lloji *Fringilla montifringilla*,
BRAMBLING,
ZBORAKSI I MALIT,
gjatësia 15cm, ndryshon nga gjinia,
shtegëtar.

Eshtë zog tepër bredhës, gjat dimrit qendron në Europën Qendrore dhe Jugore, por gjat acarit të dimrit fluturon edhe në oborre të shtëpive. Shumica prej tyre mbesin në Skandinavinë Jugore. Eshtë zog i fshehtë. Kryesisht ushqehet me fara, por gjat verës gjithashtu ushqehet edhe me insekte, gjat dimrit shpesh ushqehet me gështenja të ahut. Folenë zakonisht e nderton në degë të lisit, kryesisht në mëshkë të bredh. Eshtë i përhapur në pjesën më të madhe të Europës.

Zboraksi zbut zemërimin

Zgalemi zallishtës zbut,
Zboraksi zbraz zumaren,
Zana Zamirën zatet,
Zeshkanën ziliqaren!

Zboraksi Zabelin zaption,
Zvarritësit Zinovës zvarriten,
Zgalemi zikrahët zbulon,
Zana e Zamira zbaviten!

Ziju-ziju zerdellie,
Zijafetin zbardh zotërote,
Zana zbriti zagushie,
Zuri zemër zagoriote!

Zuri zoga zambakun,
Zambaku zogushën zdriti,
Zëbutin, zëpakun
Zana zemrës zbriti!

Zagorsi zbërthen zanafillën,
Zana zagorasin zerdellis,
Zboraksi zgjon Zamirën:
-Zgrape zotriun e Zadrimisë!

Zvarritësi zërr-zërr zërriti,
Zboraksi zurlnoi Zabelin,
Zbritën Zana e zagoriti,
Zamira zgjodhi Zenelin!

Zurle e zamare zallamahi,
Zgjuan zogj e zoga Zgatarit,
Zdirgjen zonja e zoteri,
Zymi zbrapset zararit!

Zgalemi ziliqar
Zgërvallet, zbraz zvetnimin,
Zvarritësit zdirgjen zvarrë,
Zboraksi zbut zemërimin!



Vjeshta e gjyshit

Kush ju ligështoi gjethe të forta,
T'i lini degët sot një nga një,
Mos mjegullzeza e ma marrtë
mortja,
U tha të zbritni pa t'voglin zë?!

Vallë cila gocë në makiazh
Fytyrën jeshile ua bëri t'verdhë,
Mos vjeshta e tretë do n'avantazh
Gjithë para dimrit mllëfin ta
derdhë?!

Ç'rrojtat vallë paq ua bëri kokën
E kreshtës së kaftë aty n'Zabel,
Mos vallë vetë dimri e shtroi tokën
Me borë të bardhë për zi e tmerr?!

Nuk janë këngëtarët të ma qajnë
hallin,
Nuk është pranvera t'më dhurojë lule,
Këta zogjvajtore shpirtin ma kallin,
T'lutem fërfëllizë zërin pak ule!

Struku në thinja të vetërrëfimit,
Mendimit plak një udhë të mbarë,
Një mirë se erdhe t'i them sot dimrit
Me perla t'bukura për zogjtë
shtegtarë!!!



Zhytësi i vogëlth laraman

Zhytu-zhytu o vogëlush,
Yrysh n'skrraja, yrysh n'lumë,
Ta dua gushën e bardhë shumë,
Është e bukur papalush!

Sa mirë t'shkojnë vijat në shpinë,
I ke sytë vërtet kalësh,
Ih ç'të thotë ajo mbretëreshë:
Vaj medet sa mirë të rrinë!

Obobo se ç'ritual,
Gagariteni, pastaj zhyteni,
Ëmbëlsirën n'sheqer mbyteni,
Lum bëjnë zemrat sa një mal!

Thellë shkon ujërave bir i mbretit,
Loboj unë me poezi,
Ata peshq t'i mbledhësh ti.
Rrontetont nga fund i detit!

Ariani ta do kreshtën,
Medet Genti sytë sa shumë,
Arben babi të do n'lumë,
Nexho gjyshi ty dhe vjeshtën!

Dialog brezash

Babaloku i madh sa i fortë që je,
Ashtu me këtë moshë puna të bënë
dritë,
Bravo lok i dashur për moshën që ke,
Amanet për brezat ta mbjellim në
shpirt.

Lopatën në duar sa shumë që heq
borë,
Obobo ky dimër sa fort na mërziti,
Këtë mund ta bëjë edhe me një dorë,
Ububu o bira, mos po ju koriti!

Isha shumë i vyeshëm kur isha i ri,
Me dhenë e dhijë gjithnjë mbi
Zaplluxhe,
Ah moshë e re sa më fton në lugje!

Dhe një ditë ika larg për Gjermani,
Në veriun e ftohtë paj si shumë
shqiptarë,
Ë-ja me dy pika nuk kishte të ndalë!

Mbete gjysh atje deri n'pension,
Erdhe të qëndrosh me ne në pleqëri?!
Si mos të vij këtu Gent e Arian,
Ikën ajo e shkreta nga kjo dashuri!!!

Nëse ajo fshihet diku në kala,
E marrim, e rrahim gjysho ne të tre?!
Bile do e kallim e do bëjmë bela,
I themi të kthehet në atë moshë të re!

Një gëzim i zëshëm oborrin mbuloi,
Ah sa qeshen nipat ëmbël me lezet,
Kitte pemët gjyshi e qeshte dhe vetë.

Ëmbël-ëmbël jeta si lumi të shkojë,
Vetëm brezat gjyshit t'i rriten të lirë,
Eh zogj binjakë e shtrenjta ëmbëlsirë!



Legjendat e liqeneve

Leqelurë legjendat sillen n'majë të malit,
Ilirisht flasin si motrat në kuvend,
Qafëbardhat dy, Bjeshkëve të Sharrit,
Enden sikur zana që të lënë pa mend.

Nis hapat përrallorë legjenda e parë,
I troket në derë demit n'fund t'liqenit,
I forti ujanës mbahet shumë krenar:
Kush me mua s'matet nga dema të vendit!

Ububu një demi n'kokë i vunë çengela,
Qëlloi ky fantazmën të klithë n'gjak e larë,
Dhe liqeni t'skuqet nga demi i vrarë!

Eh krenaria tretet luginave të mjera,
Lëreni moj zana t'bërlyket mal më mal,
Ihumburi të zhduket personazh në përrallë!

Qëndiset sa bukur dhe legjendë e dytë,
Ecën përpjetë bjeshkës një dash mashallah,
Niset me plot dele ky ogçi shyt,
I bënë dyzet qengja që ngjajnë në baba!

Imigrojnë nga fusha e arrijnë në majë,
Zi u bë liqeni se aty u mbytën,
Ih legjendë e dytë pse u mbushe vaj,
Prapa shpine tinëz ende ata zhyten!

Se taraku ishte i një Romë Çamerit,
Edhe delet pollën dyzet qengja t'zi,
Këtë e thonë legjendat që pak kush e di!

Ujit Liqenkuqit dhe t'Ziut të mjerit,
Fuqishëm dëgjohen blegërima të forta:
Ik- i thonë kufirit- se këtu të merrë mortja!



Gardalina në oborr të shkollës

Sa mirë aparati i Nexhë profesorit
Sot po shënon këtë Gardalinë,
Që i thotë t' shoqit në mes të oborrit
Ku je Gardalush se m' shtove mërzinë?!

Pastaj diçka i pëshpërit në vesh
Kur i sheh nxënësit që hyjnë në mësim:
Njëri sy më qan e tjetri më qesh,
Pse ca kalojnë e ca bien n' provim!

Budallaqja ime mos u bëj merak,
Lotët që kopsiten vetëm zi që mdjellin,
Kujdes se ndonjëri mos të hedhë në lak,
Ka tipa të tillë dhe me gur që sjellin.

Të gjithë janë të mirë asnjëri s' ngacmon,
Vetëm telefonat që më shtinë n' fokuse,
Thërmia të çipsit çdonjëri m' afron,
Kur janë me buzëkuqet që do i bëjnë për nuse!

Atëherë bukuroshe mirë kllloqiti vezët,
T' mbushet Gardalina shkolla gjer te dera,
Mblidhi në babine hallat edhe tezet
Se veç me një lule jo nuk çel pranvera.



Në Shoqatën për Mbrojtjen e Zogje dhe Ambientit

Shquhet Shoqata për Mbrojtjen e Zogje në Kosovë,
Obobo shkëlqeu fati i qiellit të lirë për ta,
Qëllon në teleskop Nexhoprofesori mbi Zinovë,
Afirmohen poetë, kërkues e nipa me baba!

Teleskopi afron ylber krahësh n'rituale,
Anekënd Kosovës për zogj e zoçka mike,
Portretojnë poetët këngët nëpër male,
Ëmbëlsirë për t'vegjlit n'albumet zoologjike!

Ruhet ambienti, shfarosja e cicërrimave,
Medet kush i vret Skifterët grabitçarë,
Bah, mungon klithma arave e bashtinave,
Rëndë t'u thaftë dora amatori gjuetarë!

Obobo për Pëllumba s'humbet baraspesha,
Je ore në mend nga këndi i kalasë,
Të gjitha Gjeraqinat e Hutat janë mikesha,

Jetën njëjtë e duan në gji të mamasë!
E përplot Shoqata i dalin zot kësaj pune,
Nëpër tërë Evropën e rruzullin tokësor,
E ne u bashkangjitemi Dri e përtej Bune,
Zërin t'ua ruajmë për shumë vizitorë!

O nipa të vegjël, binjakët e gjyshit,
Gjendeni mbi Opojë në Bjeshkët e Sharrit,
Vënëroni këngët dhe t'lehurat e këlyshit,
Edhe tufë me dele rudinave të malit!

Nëse doni zogj , do i shihni bjeshkës,
Ëmbëlsirë për veshët kudo n'vendi tim,
Kosova s'duron çerret e Shkineshkës,
Obobo do i mbrojmë me plot perkushtim!

Jemi të kësaj bote në Gadishullin Ilirik,
Oshëtimë të këngëve na e vrau një doç,
Vetëm t'jetë liria n'dheun pellazgjik,
Ëndërr e kahmotshme për njerëz edhe zogj!



Alo Albatroskë!

Ani Albatroskë , ani,
Atero andej Adriatikun-
Apeloi alegro Ariani-
Ajo adhuron atje ashikun!

Ashtu aktorja Albatrose,
Ankthin anulove atlete,
Atje anash alarmove,
Abuzove alamet adete!

Aplikove atë alibi,
Afirmove agun aktore;
Alo, alegro apo alergji,
Albatroskë ambasadore?!

Alo, avitu allafrenga aventurë,
Ajo afroi asisoji amanetin!
Alo, allaturka agsholi abazhur,
Ata arriten ashtu afshlezetin!

Aman Albatroçkat adhurojnë
alfabetin,
Albatroska afron abëcënë n'abetare,
Alba Albatroskë alarmoi anadetin,
Adriatik , amza atdhetare!

Albatrosi adhuron Arbërinë,
Artë, Anamale, Artanë,
Albatrosi adhuron Albaninë,
Anadetet anëmbanë.

Çafka e zezë

Shet lavdi kjo hellonkëkuqe
Dhe me sqepin sikur duq,
Duket n'kthetra me papuqe,
Thirrja e saj s'i shkon huq.

Mblidhuni shoqe të gjitha n'lojë,
Përreth eni dhe zogj të tjerë,
Dimri bëhet i ftohtë n'Opojë,
Ta ndajmë fatin sa është verë?!"

Fiq-fiq- fiq, zogoliq,
Këtë merre, këtë hiq,
Ti Laraskë e Harabel,
Dilni nga loja menjëherë!

Dhe ti Sorrë e Qukapik,
Çdo lloj Korbi e Gala tjera,
Do të rrini n'mot të ligë
Kur t'bjerë borë e të fryjë era!

Mua me shoqet më pret deti
Ku mbretëron e nxehta klimë,
Juve moj u marrtë shëndeti,
Lamtumirë e ftohta stinë!

Qafka t'zeza me këmbë t'kuqe,
Me sqeporet sikur prush,
Kur kalojnë mbi fshatin Buqe,
Duken vresht i zi me rrush!

Dallëndyshja e bardhë e detit

Deti është vendlindja jote,
Ardhur shtatit je katonë,
Lloji yt në sy t'kësaj bote
Është pikturë e varur n'dhomë.


Në kokë mban mafes të zi,
Dukesh perri e vërtetë,
Yll gëzimi n'kaltërsi
Shih se ç'varg dashnorësh t'pretë.

Ja tek vjen krushku i parë
Ai kokëforti dalldëzi
Edhe pse përvëlur n'mall,
Bëhet kinse gjë s'po di.

Ashtu ëmbël pastaj sillet,
Rënë në derte e në halle:
Dhembja moj në shpirt më
mbillet,
Është momenti t'heqim valle!

E afër çerdhes ja erdha unë,
Do filmoj, ta kënaqi xhanin,
Eh çfarë zoçka si llokum,
T'gjitha klithin-Presim mamin!

Ishin t'ëmbra kopja jote,
Top modeli i kësaj bote!



Duam, duam Dardaninë

Doli dallëndyshja Dalaverës,
Druhet dashnorëve, djallëzisë,
Dalldi dalldisur dallaverës,
Drejtëz drejtuar dashurisë.

Dallëndyshja detit del,
Depërton dallgëve, demonstron,
Duron dalldin derbeder,
Detin, Durrësin dekoron.

Dale-dale dalldo djali,
Djersët dolën dëshpëruar,
Dale-dale dalldo djalli,
Dytësive dëshiruar!

Dejka dredhon drejt Delvinës,
Dejkani derdhet dyshifruar,
Dynden dehur drejt djerrinës,

Dora-dorës dashuruar!
Denoncojnë dashurinë
Delmeri e delmerja,
Dehur derdhën dollinë,
Dalld e Dyshe dallaverja!

Deti dergjet Delmacisë,
Dallëndyshet Durrësit, Devollit,
Dejkat derdhen Dardanisë,
Dirigjojnë dylbinë Demollit!

Doli djelmëria Drenicës,
Derdhi dufin, demonstroi,
Drangë dushmanës dangallicës
Deklaratën deklamoi:

Duam Drinat, duam detin,
Duam-duam Dardaninë,
Dunavës derdhia dertin,
Dije duam Delmacinë!

Dashuria prindërore

Lokja i tha motrës- Vajzo, Bijëzo,
 Bajëzo!
 Babi i tha lokes-Nënëzo,Hënëzo,
 Vjeshtëzo!
 Mami i tha motrës-Çupëzo,
 Vashëzo,Pupëzo!
 Motra i tha mamit-Nënëzo,
 Zemërzo,Loçkëzo!
 Unë i thashë motrës-
 Motërzo,Verzëso,Lulëzo!
 Ajo më tha mua-Të dua vëllaçko, të
 dua
 Si Pëllumb e Guguftua!

Fejesa e Finqit

Finqi flatrat forcoi,
 Fluturoi flladit, fierishtave,
 Finqen fidaneve fikësoi,
 Fët ferrave, ferrishtave:

Festa filloi fisnike,
 Fshati fushës feston,
 Fërfëlliza Finqmike,
 Fundpërrenjve firon.

Finqe, fishkulloje frikën,
 Fuftoje festës farefisn,
 Fishkulloje frikthi fëdigën,
 Fikëso Finqokun, filizin!

Filluan fejesat, fërkimet,
 Fatin final fermentoje,
 Favorizoji fishkëllimet,
 Furrikun folesë frekuentoje!

Ferexha fundgushe fërfërin,
 Feks favorshëm festivaleve,
 Finqoku filizave fëshfërin,
 Fije-fije fton fundmaleve!

Fazanët fushën fqijnë,
 Festa fët e fët filloi,
 Fyelli fatlum ftoi fqinjtë,
 Finqja fundja fuqizoi.

Fejesa firmoset n'fletore,
 Finqokun finok frymëzove,
 Fjalimet forcohen n'foltore:
 Finqe, ferishtet full fitove!

Fluturat furishëm fluturojnë,
 Fishkëllyesit festojnë fundverrit,
 Finqja e Finoku falënderojnë:
 Faleminderit, faleminderit!

Fabula e gjyshit (Laraska dhe dhelpra)

Laraska: -Lëri ato përrallat tua,
Ashtu që më vjen vërdallë,
Rend diku atje në përrua,
Ani t'hiqet i shkreti mall!

S'ke çka pret dhe shikon orën,
Korb nuk jam , firmosi vulën,
Atij t'ziu ia hodhe forën,
E ra djathi e nxiu fabulën!

Dhelpra lojën e la remi,
Edhe ty do qitë n'kosh,
Lart po u ngjit, do kishte mund!

Praj Laraskë, takim mund t'kemi,
Ruaju se barkun e kam bosh,
Akoma përralla s'ka marrë fund!

Fishkëllyesit çafkëlorë

Fishkëllimë apo këngë Çafkëlorë,
I mahnitni të gjithë kalimtarët,
Shtruar ia merrni o gushëdëborë,
Kënga juaj të zgjonë nga varret.

Llampa të ndezura në errësirë
Yje të këngës do ju shpallim,
Eni-eni o ju të mirë,
Se në kopsht ma hiqni mallin!

Ih sa shumë fishkëllyes që jeni,
Të gjithë bukur ia merrni,
Çafkën të kërleshur e keni.

Ah n'varreza kur të veni,
Fare ore mos u çjerrni,
Është një loke n'shpirt e breni!

Këngë-këngë vetëm këngë
Ë-ja s'di nga shkoi, nga bredhi,
Lëre loke gjithë atë brengë,
Obobo liria erdhi!

Ra dëshmor ai djali yt,
Është se lotët derdhet prore,
Ty dhe ne malli na mbyl,
Është i t'gjithëve n'përmendore!

Kënga e këtyre në pranverë
Është një lule që këndeje ktheu,
Në varreza çfarë rrëfeu:

Gatitu djali rri përherë,
Është dëshmor i këtij atëdheu,
Se ai prehet n'gji Anteu!

Gorozhupi gdhihet gaitu

Gorozhupi graviton gurishtës,
Grabitësi gurkufirit gozhdohet,
Gorozhupi grupohet gllajnishtës,
Gushëkuq gdhihet, gulçohet!

Gllabëruesi galan granaton,
Gorozhupi gaitu gdhihet,
Grandiozën gacë garanton,
Gllabëruesi grihet-grihet!

Gorozhupi guranës gojiset:
Grahuni grabitësve gërrxhelë,
Gurëve grimësohet,gremiset,
Grandiozja gufon Gradaçelë!

Galat gllabëruesit glasosën,
Gorozhupazit gllabëruesit groposën,
Grifsha e Gushëkuqe grimosen,
Gardalinat Gostilit gararosen!

Genti gërget Gushëkuqet,
Genti Gardalinat gërget,
Gushëkuqja goxha gërmuqet,
Gardalina gërxcave gërthet:

Gogëlushi Gento, gogëlush,
Grahi galopçe gërdallit,
Gagaritu gegçe gegërush,
Grabiti gocat Gostivarit!

Gakthja galaktikën galdon,
Goca Gentin gerget,
Gushëkuqja Gentin gllabëron,
Gërshetohen gajde, gërnetë!

Gjeli i detit

Të të quaj Halabak,
Emrin mos po ta shëmtoj,
Bukurinë e ke për hak
Kur fryn pendët si palloi.

Si rrëshiq i farkatarit
Fryhesh-fryhesh e s'pëlcet,
Në gushë rruaza t'qelibarit,
I mban t'kuqe me lezet.

Koka jote me ngjyrë blu
Mbi sqep mban cyc koporani,
Unë fishkëllo, ti kurrllullu,
Kënaqen fëmijët lum jarani!

Jeni t'kuqë e jeni t'zinj,
Jeni t'bardhë e jeni t'artë,
Rituali s'ka kufi
Kur shpërthen nga klithmë e zjarhtë.

Mirë kur fryhesh o zotërote
Dhe kur bën ngapak sfilatë,
Në gjoks ç'lypi mjekra jote
Fije penjsh për salltanat?!

Kur ti fryhesh ia thërret lezetit,
Mjalt të valles hidhe, gjuaje,
Ç'të thotë ndryshe Pulë e detit:
Vetëm luaje mona luaje!

Ke të drejtë t'fryhesh Biban
Dhe t'bërtetë siç bërtet mbreti,
Ke haremin n'katër anë
Rrontetont me Pula deti!

Gjineshtra ulëruese

Gjendesh gjëkund Gjineshtër,
Ia thua si gjinkalla mbi kaktus,
Në ke problem me atë thjeshtër,
E po thirrë urgjentisht atë Gjinush!

Shtruar ia ka ai me të tjera,
Të gjitha i sillen vërdallë,
Rëndë e ka t'i ikën vera,
Ato ecin si zonja nëpër përrallë.

Ulërin ai si ujku në Rrihna,
Lë e merr dashurinë nëpër gojë,
Ëhë do qaj dikur se po i kruhet
shpina,
Ruajna Zot, u bë horë në Opojë!

U bë prush i gjori pizeveng,
E thjeshtri si babai ngado shkon,
Sorollatet diku edhe ai në aheng,
E ëndrra e Gjineshtres kaktus që
shpon!

Jeta diell, shi e borë!

Ndonjëherë vitet pikojnë shi
Për mundimet kaq të zeza,
Ndonjëherë janë mjalt në gji
Për kaq lule që lëmë n'breza!

Për thinjat që zihen në kokë
Vitet shkojnë si lumë me lot,
Të lumtë gjysh që jeton tok,
Me stërnipat në këtë botë!

Ata zhurmojnë si këngëtarët,
Që të kënaqin aty n'mollë,
Nesër i blejnë abetaret,
Nuk do ndalen as në shkollë!

Rinia është pranverë e jetës,
Pleqëria vjeshta e saj,
Margaritarët e të shkretës
I mbledh dimri, të mbushë vaj!

Këngëtarët kremtojnë kreshtave

Kudo këndojnë këngëtarët,
Kundrojnë Kryemollopjojnë,
Klithin Krahthatët, , kryeparët,
Kudo këcejnë klliçojën!

Ku kënaqen krenarët kaçurrelë,
Kunqarrit, Krajës, Kuqlinave?
Krahapur Kolibrat kokërmelë,
Kalërojnë Kanadës, krahinave!

Ku katandisen kryeneqët,
kolopuçët,
Karmës, Kungës, Kobajës?
Kryesojnë Krahdyllët, Krahkuqët,
Kullat kalamenden Karvastajës!

Kukuvajka “ku-ku-të”,
komponon,
Kuklibegut, Kukit- ku-ku?!
Katundeve keqja konfirmon:
Këngëvajën katandisa kuturu!

Kreshtave kremtojnë këngëtarët,
Krenohen kryelart Kanarinat,
Këngët kënaqin kalimtarët,
Kënaqin krojet , kulmet, Kuqlinat.

Kuqalashi këndon kastile
krekave,
Kazuari kikboks kruan kokën,
Kuqla kaçkaritet kërrusur
kënetave,
Kivi kivçe kërkon kokrrën!

Kënga e këngëtarëve krem-kremi,
Këngë kajmake Krua Kadie,
Kaçave këngën kap kalemi,
Kruaju kamate, kromë kredie!

Këngët këndohen kaç kollaj,
Krushës, Kaçanikut, Kërçovës,
Këndshëm krisin Karmës
n’Kobajë,
Kolovaten kaluar Kosovës!

Këngëshkëmbin ka Kavaja,
Kruja ka kaheër kryetrimin,
Këngëtarët Karvastaja,
Kukësi Kolesjonin, kufirin.

Këngën ka Kaçaniku,
Katrahurën ka Kërçova,
Kufirin ka kreshniku,
Kërnomet ka Kosova!

Kanarina

Kanarinë këngëtare me krahët e kaltër,
Ato pendlat tua të kaltra mbi shpinë,
Na mahnit me to e këngës t'i kem'
hatër,
Aman ç'blu i errët bishtin kur e
shtrinë!

Ritual i këndshëm dashurinë kërkon
I bukur në klithma me kokën përpjetë,
Na thuaj moj Rina çerdhja a
t'mungonë,
A u bërë gati t'vijjë të tjerët n'jetë?!

E po kënga jote shpirtit m'i çon mall,
Bukurija jote syrin ma mbush vrima,
Unë i dal përpara qiellit n'ylberina.

Këndo bukuroshe ,këngës jepi valë,
Ububu dhe t'vegjilit kur nisin në
Rrihna,
Rend me ta nga une Rina Kanarina

Laraska (Grizhla)

Lara-lara zëri yt në Brrut,
A erdhe t'i frikësosh zogjtë në
oborr?
Rend nga këtu se t'qëlloj me
kërrutë,
A merr vesh moj e bëra horë?!

Se ikën në Shajne edhe atje të
shajnë,
Ke atë bishtin si helikopter,
Atje për kriminele të mbajnë,
Vrasëse moj që mendja s'ta merr!

Ruaje veten moj në fshatra tjera,
Atje t'ndjekin fëmijët me llastik,
Soj i Korbit që kurrë s'more vesh!

Ëhë, qan moj Larasko mjera?
S'ka vend këtu për asnjë armik,
Edhe pse na viziton si shpesh!

Laraska e dhelpra

Një Laraskë zbret n' tabelë rruge
Dhe mendohet nga t'ia mbajë,
Vjen një dhelprë , një bijë zhuge
I afrohet, mbushet vaj.

Ç'më shikon soj dinake,
Drejt mund t'shkosh për Prizren,
Në të majtë ke Rosë divjake,
Në të djathtë bari me dhenë.

Dhelpra ngadalë lëviz bishtin,
Pyet Laraskën-Ç'lyp n' tabelë?
Ik moj skile ta luajnë gishtin,
Unë pres zoçkat t'piqenë n'hell!

Lahutarët lavdojnë Lezhën

Lauresha ledheve laskurohet,
Lauri livadheve lemeritet,
Lakohet lanetja, lavdohet,
Lauri loje leçitet!

Larashkat laradashas lartësohen,
Larashët lakadredhas leverdisen,
Lëre,lajlëulet lazdrohen,
Lënduar Larashët lajkatisen.

Lamtumirë loçka Laureshë,
Luaj lezetshëm lisnajave,
Lebetitu, lajthitu lëneshë,
Luhatu lëpushave, lugajave!

Lezin leqelurë lotoje,
Lënoru lendinave , lëviz,
Laprakut ligësinë lajmëroje,
Lala laviret leçit!

Larëzat Liqenet e Lurës lakmojnë,
Laradashët lëshohen laçishtave,
Larëzakët Larëzave lakojnë,
Laradashkat lënorene lugishtave!

Laraskat leckosen lajthishtave,
Laraskët lemeriten Lëpushën,
Lëre leftericën lugishtave,
Laviren laskarushën!

Lahutarët Lezhën lavdërojnë,
Lartëmadhërinë, Lampadarin,
Laureshat lirshëm ligjërojnë,
Lajtmotivin, Legjendarin!

Lejlekët lulekuqet lajmërojnë,
Lartësojnë lyrshëm lapidarët,
Luzma lotësh lehtësojnë,
Lëndimet lëmojnë letrarët!

Leci leksionet lanson,
Lexuesit lezetshëm lexojnë,
Lëndën lulishtes lakon,
Librave lulet lulëzojnë!

Mjellma

Mori vesë e pavesvese,
Që s'i dole burrit bese,
Kështjellë e fortë e një martese,
Kokën lart si kulm ndërtese.

Qafëgastare mori nuse,
Sytë i mbylle në fokuse,
Ëndrrat si kallinj i shtron,
Qumështi i zogut s'të mungonë.

Burri yt ai kapedan
Fare s'duket egërshan,
T'çonë liqenit anë e mbanë,
Njëherë n'vit të shtojë mjellmanë!

Kokën rrallë në ujë kur zhyt,
Si tërë botën ta përmbytë,
Flamur paqeje, çili sytë,
Po t'përkrahësh, s'ke të dytë.

Por ca zoçka derbedere
Që përfliten përgjatë vere,
Xhelozojnë si teveqe,
Se na qenke pak dembele!

Ti s'je rebele me vervele,
Ndaj i plas ato delmere,
Je e ëmbël karamele,
Akulllore në zheg vere!

Zemërbardhë moj e shpirtbutë
Dhe si njerë do sillleshe urtë,
Je si mjeshtër i përtej mjeshtrit
Gjithë me peshq do ruaje
thjeshtrit!

Asnjëherë mbi ujë s'u ndale
Si anije humanitare,
Lundron qetë e pazavalle,
Muzikantët plase fare!

T'futën n'rreshta me balet,
Dy a tri a shtatë a tetë,
T'gjitha sallat bën rrëmujë,
Me krah t'bukur përmbi ujë!

Dhe piktorët bën mamur,
Sytë t'i vjerrin në pikturë,
Baroneshë moj në liqene
Zambakbardha parisienne!

Brenga jote e përtej moteve
Simfoni e shtatë e lotëve,
Derdhet helm në buzë të gotës,
Për pleqërinë në fund të botës!

Mori borë e dëbortë
Kënga jote e përmortë,
Në guidën me solfezhe
Bartet shekujve në kortezhe!

Llafazani në akrostik

Llafos Llafazani në Shkëmb të
Kavajës,
Aty ku Hutat bëjnë lumenj gjaku,
Fajkua i detit nga ana e Krajës
Afrohet Shkëmbit si plak oxhaku!

Zëre moj Hutë atë fjalëshumë,
Aty do jem beso saora,
Nëse të ikën ai zëllokum,
I prishim punët se i ke fora!

Ia thotë ëmbël, s'i trembet syri,
Gugat si pëllumb aty në gur,
Uh kur shtrin flatrat, duket flamur!

Rëndë është kësaj kënge t'i vihet
dryri,
Ia thotë bukur më mirë se kurrë,
T'lumtë Llafazan, vërtet je burrë!

Palloi

Palloi e ka bishtin si shtregë,
Si fustan i nuses në banket,
Ato ngjyra të ëmbla si shegë,
Kush t'i qëndisi o princ, o mbret?!

Kur shpalos bishtin si kurorë,
Si bjeshka dukesh përmbi fushë,
I kaltër, i kaltër nën krahëror,
I ëmbël, i ëmbël nën gushë!

Virrma jote ndihet larg,
Kur e thërret dashnoren në emër,
Poshtë e lart endesh në park,
Veç t'i kesh zoçkat për zemër.

Ai pallua i bardhë si bora
Kur ngërdheshet shpalon vesë,
Oh m'i lumtë, m'i lumtë kurora,
Duket lisi me krahnezë.

Ç'rituale bën e çfarë vallëzon
Me gjithë ato dega çuar,
Duke shkuar rrotullim
Pallojkën për ta mashtruar?!

Ato zemra që pëlçasin
Mjalt në dashuriçka,
I mësojnë zoçkat që t'u thërrasin
Naniçka-naniçka!

Pata e egër

N'mes t'liqenit kush ia thotë
Kaq ëmbël me grra-grra,
Pata e egër që shkon not,
Vetëm defin që s'e ka!

Përmby ujë si flotë detare,
Notojnë prapa zogj të tjerë,
Oh sa shumë këto manare
Plasin n'breg dhelapër të mjerë!

I shkojnë jargët kësaj të ngrate,
I përcjell me njërin sy,
Ç' të bëjë tani o zë pate
Kur s'jam ngat të gëzoj me ty?!

Pata e bukur me zë mbytës,
Afër pirrave ç'i rrëfen:
Ti si ne nuk di të zhytesh
Dhe po hyre në liqen!

Përmby ujë si motër Rika
Rrahu krahët shend e verë,
U çuan pika e stërpika,
U bë mjegull një copë herë.

Digju-digju shpirti im
Edhe shtrydhu si limon,
Pata bën parakalim,
Kundër meje lavdet shton!

A s'po del njëherë në breg
Se do ftohesh zonja Patë,
M'dhimbsët zëri yt si shegë,
M'dhimbsët qafa jote e gjatë?!

Na i marrshë t'ligat mori skile,
Dikujt tjetër shkundja morrat,
Puna jote gjithë me hile,
Unë si Korbi s'i ha forat!

Budallaqe,jak në mend,
Zë i gjerrë kështu më mbyt,
Mjek me emër jam n'këtë vend,
Të gjithë zogjtë i shëroj n'fyt!

Kot mundohesh e rropatesh
Duke pritur përmby brigje,
Kurrë me mua të mos matesh,
Mbylli shpresat në valixhe!

Petriti Fajkua

Pse e mban dhe emrin tjetër Sokol,
Endet nëpër libra çështja si pëllhurë,
Ti i vogli zog pa një fije shkollë
Rend ashtu maleve gjuetari pa kulturë!

I bën pesë vezë të verdha pika-pika,
Të vegjlit i lëshon për tridhjetë ditë,
Ishte dashuria për djem dhe çika,
Ani solli vocat si ti o Petrit!

Fajkua të thonë , besa dhe Skifter,
Ah në botë t'ushtrojnë t'sulmosh kuturu,
Jeta në Opojë vallë s'të pëlqen?!

Kuku bëjnë minjtë për ty maliher,
Urra-urra n'çerdhe të vegjlit e tu,
Ani soj i Shqipes, ani se rrëmben!

Pëllumbat e vegjëlisë

Pëllumba, sa u doja atje mbi kodër,
Ëmbël kur shkonit kupës së qiellit,
Llampë e ndezur për shpirtin e vogël,
U mbaja në sy me rrezet e diellit!

Mbahesha krenar pse ju kisha,
Bobo kur shtriheshit bukur mbi vezë,
Aman sa i lumtur atëherë isha,
Ta kthej fëmijërinë, m' shkojnë trupit
krahnezhë!

E juve të bardhëve në flamurin blu
Bota ju zgjodhi për simbol të rrallë,
Uububu ç' të shohësh postier special!

Kënaqja ëndrrat e vogla me ju,
Ulur n'botën time në baqe pse vallë?
Rendni edhe sot të më mbushni
mall!

Takllaça, Arapa, gjithëfarësh ju quaja,
E ëmbël ju ushqeja, asgjë s' u
mungonte,
Vetëm nga macja sa shumë atëherë
ndruaja,
Eh sa lotë më shkonin kur ajo
sulmonte!

Gjendja ndryshonte sa ditën, sa
natën,
Ëndrra dhe numri zvogëloheshin
ngapak,
Leht Skifteri ua kallte datën,
I vriste ato ëndrra tambël me kajmak!

Soj i prapë o ju i Gjeraqinave,
Ëjështa duke u thënë kështu ditë për
ditë,
Soj Petritash e Hutash që u zinte
pritë!

Ishte dashuria ime e lëndinave,
Me ju e lidhur ashtu vit për vit,
Edhe tani ëmbël që më zbret në
shpirt!

Rabecka e vogëlth

Rishtas erdhe Rabecka trime,
Ashtu e vogël si qengji në trina,
Bah çfarë çerdhe poezia ime,
E shtron qilimin me vjersha e
rimal!

Cucë e vogël Rabeckë simpatike
Kush s' të njehë oh sa shumë
gabon,
Ah sa të dua moj e vogla mike,
E pse Rabeckë Harabele t' thonë?!

Vërtet i përngjan, por ti je
Rabeckë,
O sugarja e tërë shpendërisë,
Gresë e vreshtave në sy të
njerëzisë!

Ëmbëltohet syri kur të shehë në
kreckë,
Lala akrostikeve të zbretë
poezisë,
Thuaja në sonete këngëve
t' nusërisë!

Shqiponja

Në flamur rri me dy kokë
Se këtu jam denbabadën,
Atëdheun tim e shoh gjithë tok
Dhe pse bota përherë zjen.

Këtu në majë të Bjeshkëve
t'Sharrit
E kam çerdhen në Pkëllimë,
I çoj t'fala Adem Jasharrit
Sa herë shpirti m'sokëllin.

Koha zbrazet tepër shpejt,
Vepra mbetet n'përjetësi,
O dëshmorë ju zgjodhet vetë,
Diell t'jeni për liri!

Dhe ne zogjtë jemi të lirë,
Këtë ua themi me zemër prore,
Kënga jonë s'është më e mirë
Se e juaja n'përmendore!

Syri ynë gjithmonë qan
Sikur qielli plot me re,
Për bonjakët që s'u kanë,
T'këndojnë bashkë me ju e ne.

Ngjyrës së flamurit i bie not,
Zhytem sa thellë në histori,
Ah kur dal ç'më mbysin lot:
"Vallë sa ishe Iliri!"

Shana e Shqiponjat

Shih Shqiponjat shkojnë Shullanit,
Shtruar sharpave shqyejnë
shtjerrkat,
Shahet Shana shkuar Shanit:
Shllap e shllup shkuan sheqerkat!

Shqepen Sharrit shterpat
shtëllunga,
Shtohet shiu, shtojzovallet,
Shlodhet Shana, shlodhet shtrunga,
Shtohen shtonat, Shana shmallet!

Shi-shi shkilja shëndetit,
Shtoja shtjerrkat Shanës, shtoja,
Shtoja shलगun Shanoshkretit,
Shtruar Shtojeve , shtoja-shtoja!

Shtjerrat shtohen shëngjergjeve,
Shqiponjat shikojnë shfrenuar,
Shana shtroerë sheh shलगjeve,
Shtjerrat shkatërrohen shëmtuar!

Sh-sh-sh! Shana shan,Shana
shfryhet:
Shtaga shpesh shkatërron shlligat!
Shana shtallave shkryer shtyhet:
Shttara shpejt shfaros shtrigat!

Shkupit shtohen shqiptarët,,
Shkineshka shtjerret, shkishërin,
Shtjerrkat shoqërojnë shigjetarët,
Shqiponjat Shqipërinë!

Vargmalet vërshojnë Vlorën

Vargan vajzash vërshojnë verës,
Vallet verake vrik vulosin,
Vezullojnë vezët vapës verzës,
Verolulet vetë vendosin.

Verduni Vlashnjës vëzhgoi,
Verrishtave vendin vëneron,
Vrapues voci vonë vështroi,
Vardis Vlashnjën,
vendënumëron!

Verduni vajti valanicës,
Vallen vetëm varfëroi,
Vrapuesi vajti Vërmicës,
Valëve vrapin vazhdoi!

Voglush Vremçi vëren vetmuar:
Vagabondat vjellin vrer!
Vajti Vrellës vallë varruar,
Vrave Vremçin vero- verë?!

Vajmedet Vremç e vajhalli,
Vajte vrikthi vallë Veleshtës?
Valë-valë vajti veç Vardari,
Vilet vareshin vërtet vreshtës!

Verduni Vjosës vërvitet,
Vapa valët vezullon,
Vonë valëve vërtitet,
Vallë Vremçin vajton?!

Viola vreshtës vilet vjel,
Valbona vete valë-valë,
Vende-vende vjeshta vjell,
Vremç vogëlushi vritet vallë?!

Vranët vajtën Vranishtës,
Vriten, varrosen virgjinat?
Vermoshit, Vrrakës, verrishtës,
Vuajtjet vajtojnë violinat!

Vëllëzëria vajti varrezave,
Vazolulesh vendosi varreve,
Viktoria vringëlloi vitezave,
Vrasjen vrançe vrastarëve!

Vrasje, vdekje, varre,
Viteve vendit vulose,
Viktoria vesoi vrastare,
Vajte Vranjës, vampirose!

Verduni vajti vërdallë,
Vithëkuqit, Voskopojës,
Vritën vistakët vallë,
Viçitrinës, Velipojës?!

Vargmalet vërshojnë Vlorën,
Valëkuqi verandës valvitet,
Vrullshëm vendosën vendoren,
Valdetet valleve vërviten!

Verduni vrringjas vajti valëve,
Vjedhtazi Vrrinit vazhdoi,
Vrapuesi vithiset vargmaleve,
Vendimin volum vërtetoi!

Te Rrasa e Shqipes

Te Rrasa e Shqipes mbi Bresanë
Zogjtë sa bukur ligjërojnë,
Kësaj mbretëreshe n'katër anë
Përditë t'fala sa i çojnë:

Moj Shqiponjë e Gurit t'Zi
Që klith tmerrshëm përmbi
Sharr,
Si duron n'zemër kufi,
N'trupin tënd pse t'hapet varr?!

Dy liqenet bukuri
Si dy Shqipet në flamur,
Njëri Kuq e tjetri Zi
Një kufi s'e durojnë kurrë!

Rekshi i Vogël e Rekshi i Madh
Gjithë me lot ta prishin midën,
Lulet qajnë përherë n'livadh,
Pse ua morën Iliridën!

Në dy anët shqip a s'flitet,
Në Tetovë e në Opojë?!
Pse kufi aty të qitet,
Dy legjenda a s'kanë gojë?!

PËRMBAJTJA

<i>Diomedea exulans</i> , ALBATROSS , ALBATROSI ,	8
<i>Riparia riparia</i> SAND MARTIN , BABILI I RËRËS (Dallëndyshja e lumit),	9
<i>Ptyonoprogne rupestris</i> , (Eurasian) CRAG MARTIN , BABILI I SKËRKËS ,	10
<i>Fulica atra</i> , (Eurasian) COOT , BAJZA ,	11
<i>Luscinia megarhynchos</i> , (Common) NIGHTINGALE , BILBILI	12
<i>Luscinia luscinia</i> , THRUSH NIGHTINGALE , BILBILI MËLLENJË ,	13
<i>Alcedo atthis</i> , (Common) KINGFISHER , BILBILI UJIT ,	14
<i>Motacilla alba</i> , WHITE/PIED WAGTAIL , BISHT LËKUNDËSI LARAMAN ,	15
<i>Motacilla cinerea</i> , GREY WAGTAIL , BISHT LËKUNDËSI I PËRHIMT ,	16
<i>Motacilla flava</i> , YELLOW WAGTAIL , BISHT LËKUNDËSI I VERDHË ,	17
<i>Nocifraga caryocatactes</i> , (Spotted) NUTCRACKER , BOCËTHYESI ,	18
<i>Bubo bubo</i> , EAGLE OWL , HUTI SHQIPONJË (BUFI),	19
<i>Emberiza schoeniclus</i> , (Common) REED BUNTING , CERLA E KALLAMISHTEVE , ..	21
<i>Caprimulgus europaeus</i> , (European) NIGHTJAR ,	22
<i>Vanellus vanellus</i> , (Northern) LAPWING , GICVILJA ,	23
<i>Sturnus vulgaris</i> , (Common) STARLING , CERLOI I ZI PIKALOSH ,	24
<i>Emberica cia</i> , ROCK BUNTING , CERLA E MALIT ,	25
<i>Emberica citrinella</i> , YELLOWHAMMER , CERLA VERDHASHE ,	26
<i>Carduelis spinus</i> , (Eurasian) SISKIN , CERLA DIMËRAKE ,	27
<i>Emberica cirlus</i> , CIRL BUNTING , CERLA GUSHËGJELBËR ,	28
<i>Nycticorax nycticorax</i> , NIGHT HERON , ÇAPKA E NATËS ,	29
<i>Ardea cinerea</i> , GREY HERON , ÇAPKA E PËRHIME ,	20
<i>Platalea leucorodia</i> , (Eurasian) SPOONBILL , ÇAPKA SQEPLUGË ,	31
<i>Ardeola rallodies</i> , SQUACCO HERON , ÇAPKA E VERDHË ,	32
<i>Egretta garceta</i> , LITTLE EGRET , ÇAPKA E BARDHË E VOGËL ,	33
<i>Chlidonias leucopterus</i> , WHITE-WINGED TERN , DALLËNDYSHE DETI KRAHËBARDHË , ..	34
<i>Cygnus olor</i> , MUTE SWAN , MJELMA ME XHUNGË ,	35
<i>Chlidonias niger</i> , BLACK TERN , DALLËNDYSHE DETI E ZEZË ,	37
<i>Hirunda rustica</i> , BARN SWALLOW , DALLËNDYSHJA E KOQEKUT ,	38
<i>Tachymarptis melba</i> , ALPINE SWIFT , DEJKA ALPINE ,	40
<i>Pandion haliaetus</i> , OSPREY , FAJKUA DETI ,	43
<i>Phasianus colchicus</i> , (Common) PHEASANT , FAZANI ,	44
<i>Carduelis carduelis</i> , (European) GOLDFINCH , GARDALINA ,	45
<i>Coccothraustes coccothraustes</i> , HAWFINCH , SQEPTRASHI ,	46
<i>Corvus monedula</i> , (Western) JACKDAW , GALA ,	47
<i>Botaurus stellaris</i> , (Great) BITTERN , GAKTHI ,	48
<i>Garullus glandarius</i> , (Eurasian) JAY , GRIFSHA ,	49
<i>Luscinia svecica</i> , BLUETHROAT , GUSHËKALTËRTI ,	50
<i>Erithacus rubecula</i> , (European) ROBIN , GUSHËKUQI ,	51
<i>Accipiter gentilis</i> , GOSHAWK , GJERAQINA ,	52
<i>Accipiter nisus</i> , (Eurasian) SPARROWHAWK , GJERAQINA E SHKURTËS ,	53
<i>Calidris ferruginea</i> , CURLEW SANDPIPER , GJELËZA GUSHËKUQE ,	54

<i>Pluvialis squatarola</i> , GREY PLOVER , GHELËZA PIKALOSHE,	55
<i>Tetrao urogallus</i> , CAPERCAILLIE , GJELI I MALIT,	56
<i>Phoenicurus phoenicurus</i> , (Common) REDSTART , GJOKS KUQI,	57
<i>Phoenicurus ochrorus</i> , BLACK REDSTART , GJOKSKUQI I ZI,	58
<i>Neophron percnopterus</i> , EGYPTIAN VULTURE , GJYP (KALI I QYQES),	59
<i>Passer domesticus</i> , HOUSE SPARROW , HARABELI I SHTËPISË,	60
<i>Passer montanus</i> , (Eurasian) TREE SPARROW , HARABELI I FUSHËS,	61
<i>Buteo buteo</i> , COMMON BUZZARD , HUTA,	62
<i>Otus scops</i> , (Eurasian) SCOPS OWL , HUTI I FUSHËS,	63
<i>Tyto alba</i> , BARN OWL , HUTI I KOQEKUT,	64
<i>Asio otus</i> , LONG-EARED OWL , HUTI VESH GJATË,	65
<i>Asio flammeus</i> , SHORT-EARED OWL , HUTI VESHKURTËR,	66
<i>Himantopus himantopus</i> , BLACK-WINGED STILT , KALORËSI,	67
<i>Phalacrocorax pygmeus</i> , PYGMY CORMORANT , KARABULLAKU I VOGËL,	68
<i>Cazuarius cazuarius</i> , CASSOWARY , KASUARI,	69
<i>Carduelis cannabina</i> , (Common) LINNET , KËRPNGRËNËSI,	70
<i>Aperuxowini australis</i> , BROWN KIWI , KIVI I MADH,	71
<i>Corvus corax</i> , (Common) RAVEN , KORBI,	72
<i>Corvus frugilegus</i> , ROOK , KORBI SQEPBARDHË,	73
<i>Colibri coruscans</i> , SPARKLING VIOLET-EAR , KOLIBRI,	74
<i>Remis pendulinus</i> , (Eurasian) PENDULINE TIT ,	75
<i>Phalacrocorax carbo</i> , (great) CORMORANT , KORMORANI,	78
<i>Podiceps cristatus</i> , GREAT CRESTED GREBE , KREDHARKU KURORË MADH,	79
<i>Bombycilla garrulus</i> , (Bohemian) WAXWING , KRAHDYLLI,	80
<i>Falco peregrinus</i> , PEREGRINE FALCON , KRAHËTHATI,	81
<i>Turdus iliacus</i> , REDWING , KRAHKUQI,	82
<i>Grus grus</i> , (Common) CRANE , KRILLA,	83
<i>Streptopelia decaocto</i> , (Eurasian) COLLARD DOVE , KUMRI ME QAFORË,	84
<i>Pyrrhula pyrrhula</i> , (Eurasian) BULLFINCH , KUQALASHI ÇAFKËZI,	85
<i>Anas strepera</i> , GADWALL , KUQLA QAFËGJELBËR,	86
<i>Pica pica</i> , (Common) MAGPIE , LARASKA BISHTGJATË,	87
<i>Haematopus ostralegus</i> , (Eurasian) OYSTERCATCHER , LARASKA E DETIT,	88
<i>Lanius nubicus</i> , MASKED SHRIKE , LARASHI BALLËBARDHË,	89
<i>Lanius minor</i> , LESSER GREY SHRIKE , LARASHI I VOGËL BALLZI,	90
<i>Lanius senator</i> , WOODCHAT SHRIKE , LARASHI KOKËKUQ,	91
<i>Lanius excubitor</i> , GREAT GREY SHRIKE , LARASHI I MADH I PËRHIM,	92
<i>Lanius collurio</i> , RED BACKED SHRIKE , LARASHI KURRIZKUQ,	93
<i>Alauda arvensis</i> , (Common) SKYLARK , LAURESHA,	94
<i>Galerida cristata</i> , CRESTED LARK , LAURESHA ME NAPKË,	95
<i>Eremophila alpestris</i> , Horned Lark (Shore Lark), LAURESHA E BRIGJEVE,	96
<i>Melanocorypha calandra</i> , CALANDRA LARK , LAURESHA MELANKOLIKE,	97
<i>Calandrella brachydactyla</i> , (Greater) SHORT-TOED LARK , LAURESHA KËMBSHKURT,	98
<i>Lullula arborea</i> , WOODLARK , LAURESHA E PYLLIT,	99
<i>Ciconia ciconia</i> , WHITE STORK , LEJLEKU I BARDHË,	100
<i>Ciconia nigra</i> , BLACK STORK , LEJLEKU I ZI,	102
<i>Saxicola torquata</i> , STONECHAT , LLAFAZANI I GURIT,	104
<i>Turdus merula</i> , BLACKBIRD , MËLLËNJA,	105
<i>Alcedo atthis</i> , KINGFISHER , BILBIL UJI,	106

<i>Moniticola saxatilis</i> , ROCK THRUSH, MËLLËJNA E GURIT ,	107
<i>Turdus philomelos</i> , SONG THRUSH, MËLLËNJA KËNGËTARE	108
<i>Turdus torquatus</i> , RING OUZEL, MËLLËNJA QAFORË ,	109
<i>Turdus viscivorus</i> , MISTLE THRUSH, TUSHA E MADHE E MALIT ,	110
<i>Crex crex</i> , CORNCRAKE, MBRETI I SHKURTËS ,	111
<i>Ficedula parva</i> , RED BREASTED FLYCATCHER, MIZAKAPËSI GUSHKUQË ,	112
<i>Muscicapa striata</i> , SPOTTED FLYCATCHER, MIZAKAPËSI I PËRHIMË ,	113
<i>Ficedula hypoleuca</i> , PIED FLYCATCHER, MIZAKAPËSI I ZI ,	114
<i>Oenanthe hispanica</i> , BLACK-EARED WHEATEAR, MURGËZA VESHZI ,	115
<i>Montfringilla nivalis</i> , SNOWFINCH, PAROSI I DËBORËS ,	116
<i>Anser anser</i> , GREYLAG GOOSE, PATA E EGËR ,	117
<i>Pelecanus crispus</i> , DALMATION PELICAN, PELIKANI DALLMATIN ,	118
<i>Ara ararauba</i> , BLUE AND YELLOW MACAW, PAPAGALLI ARA ,	119
<i>Columbia livia</i> , ROCK DOVE, PËLLUMBI I GURIT ,	120
<i>Columbia palumbus</i> , WOOD PIGEON, PËLLUMBI I PYLLIT (gugashi) ,	121
<i>Goura victoria</i> , KING PIGEON, PËLLUMBI MBRETEROR ,	122
<i>Aptenodytes forsteri</i> , EMPEROR PENGUIN, PINGUINI MBRETROR ,	123
<i>Larus ridibundus</i> , BLACK-HEADED GULL, PULËBARDHA E ZAKONSHME ,	124
<i>Tetrao tetrix</i> , BLACK GROUSE, PULË E EGËR (gjel i egër bishtlirë) ,	125
<i>Otis tarda</i> , GREAT BUSTARD, PULA ME MJEKËR ,	126
<i>Upupa epops</i> , HOPOE, PUPËZA ,	128
<i>Anthus trivialis</i> , TREE PIPIT, PIPITI I LISIT ,	129
<i>Anthus gustavi</i> , RED-THROATED PIPIT, PIPITI GUSH-KUQ ,	130
<i>Anthus campestris</i> , TAWNY PIPIT, PIPITI I KUQËRREMË ,	131
<i>Anthus trivialis</i> , TREE PIPIT, PIPITI I LISIT ,	132
<i>Anthus pretenses</i> , MEADOW PIPIT, PIPITI I LIVADHIT ,	133
<i>Anthus spinoletta</i> , WATER PIPIT, PIPITI I UJIT ,	134
<i>Porzana porzana</i> , SPOTTED CRAKE, PORZANA PIKALOSHE ,	135
<i>Cettia cetti</i> , CETTI'S WARBLER, QAFKËLORI I CETIT ,	137
<i>Sylvia borin</i> , GARDEN WARBLER, QAFKËLORE E KOPSHTIT ,	138
<i>Dryocopus martius</i> , BLACK WOODPECKER, QUKAPIKU I ZI ,	139
<i>Picus viridis</i> , GREEN WOODPECKER, QUKAPIKU I GJELBËRT (Zogi i Smajlit) .140	
<i>Dendrocopos leucotos</i> , WHITE BACKED WOODPECKER, QUKAPIKU SHPINËBARDHË , ..141	
<i>Dendrocopos major</i> , GREAT SPOTTED WOODPECKER, QUKAPIKU PIKA PIKA , 142	
<i>Cuculus canorus</i> , CUCKOO, QYQJA ,	143
<i>Actitis hypoleucos</i> , SANDPIPER, QYRYLYKU I VOGËL ,	145
<i>Tringa toranus</i> , REDSHANK, QYRYLIKU KËMBËQIRIZRE ,	146
<i>Anas platyrhynchos</i> , MALLARD, ROSË E EGËR ,	147
<i>Sylvia atricapilla</i> , BLACK CAP, RRADAK ZIU ,	148
<i>Falco vespertinus</i> , RED-FOOTED FALCON, SKIFTERI KËMBËKUQ ,	149
<i>Falco tinnunculus</i> , KESTREL, SKIFTERI KTHETRAZI (sokol) ,	150
<i>Falco naumanni</i> , LESSER KESTREL, SKIFTERI KTHETRAVERDHË ,	151
<i>Falco columbarius</i> , MERLIN, SKIFTERI I VOGËL ,	152
<i>Pyrrhocorax graculus</i> , ALPINE CHOUGH, STERQOKA E MALIT ,	154
<i>Covrus corone cornix</i> , HOODED CROW, SORRA ,	155
<i>Aquila chrysaetos</i> , GOLDEN EAGLE, SHQIPONJA E ARTË (E MALEVE) ,	156
<i>Pyrrhocorax pyrrhocorax</i> , CHOUGH, STERQOKA SQEPKUQE ,	157
<i>Struthio camelus</i> , AFRICAN OSTRICH, STRUCI AFRIKAN ,	158

<i>Gallinago media</i> , GREAT SNIPE, SHAPKA E MADHE E UJIT ,	159
<i>Gyps fulvus</i> , GRIFFON VULTURE, SHKABA ,.....	160
<i>Coturnix coturnix</i> , QUAIL, SHKURTË ,	161
<i>Circus pygargus</i> , MONTAGU'S HARRIER, SHQIPJA E BALLTAQEVE ,	162
<i>Circus cyaneus</i> , HEN HARRIER, SHQIPJA E FUSHËS ,.....	163
<i>Circus aeruginosus</i> , MARSH HARRIER, SHQIPJA E KËNETËS ,.....	165
<i>Aquila pomarina</i> , LESSER SPOTTED EAGLE, SHQIPONJA E VOGËL E ROSAVE ,.....	166
<i>Aquila heliaca</i> , IMPERIAL EAGLE, SHQIPONJA PERANDORAKE ,.....	169
<i>Aegithalos caudatus</i> , LONG-TAILED TIT, TRISHTILI BISHTGJATË ,.....	170
<i>Parus caeruleus</i> , BLUE TIT, TRISHTILI I KALTËR ,	171
<i>Parus montanus</i> , WILLOW TIT, TRISHTILI I MALEVE ,	172
<i>Parus lugubris</i> , SOMBRE TIT, TRISHTILI I MADH I MURMË ,.....	173
<i>Parus palustris</i> , MARSH TIT, TRISHTILI I VOGËL I MURMË ,	174
<i>Parus ater</i> , COAL TIT, TRISHTILI I ZI ,.....	175
<i>Panurus biarmicus</i> , BEARDED REEDLING, TRISHTILI ME MUSTAQE ,.....	176
<i>Parus cristatus</i> , CRESTED TIT, TRISHTILI ME ÇAFKË ,	177
<i>Parus major</i> , GREAT TIT, TRISHTILI I MADH ,	178
<i>Troglodytes troglodytes</i> , WREN, TRUMCAKU ,	179
<i>Streptopelia turtur</i> , TURTLE DOVE, TURITULLI ,	180
<i>Perdix perdix</i> , GREY PARTRIDGE, THËLLËZA E FUSHËS ,	183
<i>Charadrius dubius</i> , LITTLE RINGED PLOVER, VRAPONJËSI I VOGËL ,	184
<i>Carduelis chloris</i> , GREENFINCH, VERDUNI ,	185
<i>Sitta tephronota</i> , ROCK NUTHATCH, ZVARRITËSI I SHKREPAVE ,	186
<i>Tichodroma muraria</i> , WALLCREEPER, ZVARRITËSI KRAHËKUQ ,	187
<i>Cicinnurus regins</i> , PARADISE BIRDS, ZOGJTE E PARAJSSES ,	188
<i>Fringilla coelebs</i> , CHAFFINCH, ZBORAKSI ,	189
<i>Serinus serinus</i> , SERIN, ZOG BARI SQEP SHKURTËR (zherri) ,.....	190
<i>Cinclus cinclus</i> , DIPPER, ZHYTËSI ,	191
<i>Fringilla montifringilla</i> , BRAMBLING, ZBORAKSI I MALIT ,	192

Ministria e Mjedisit dhe Planifikimit Hapësinor Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK)



MISIONI: Agjencia për Mbrojtjen e Mjedisit të Kosovës (AMMK) është institucion qeveritarë i cili angazhohet që përmes monitorimit të integruar të mjedisit, sistemit efikas të informimit mjedisorë dhe raportimit të vazhdueshëm për gjendjen e mjedisit, të rritja kualitetin e ajrit, ujit, tokas dhe biodiversitetit, të promovojë shfrytëzimin e barimëve të ripërtëritshëm të energjisë dhe shfrytëzimin e qëndrueshëm të resursëve natyrorë me qëllim që të sigurojë një mjedis të shëndetshëm për generatat e tashme dhe të ardhshme në harmoni me progresin e zhvillimeve ekonomike dhe sociale.

VIZIONI: Monitorim, informim dhe raportim efikas mjedisorë, për një mjedis të shëndetshëm dhe mjete ekonomike të qëndrueshme.


Ahmeti, Brijuni, Kallit, Haxhiu, Nisani, et al. e Shënimi në Kosovë për Fildën e Modave të Rinisë
Kallit, XV, 2011. Përdituar: Republika e Kosovës
Tëlbash, 078 800 33 228
Fildën e Rinisë për Rininë
Wikipedia: ammk-kosovo

QENDRA EDUKATIVE MULTIDIDAKTIKE



Adresa: Rr. Agim Berisha nr. 12
(afër Gjimnazit), 20000 Prizren
Tel. +377 (0) 44 144 109
+377 (0) 44 335 851
+377 (0) 44 388 967
www.finchcentre.com
email: info@finchcentre.com

- Kurse të gjuhëve të huaja
- Kurse për mësimin e aplikacioneve kompjuterike
- Aftësimi dhe certifikimi për ECDL (European Computer Driving Licence)
- Ofrimi i mësimin në distancë - e-Learning
- Përkthime gjyqësore (anglisht, gjermanisht, frëngjisht, italisht, suedisht)
- Organizimi i kampingeve në natyrë



PËRVOJËNË E FITUAR MËSE E HARRO!



ISBN 978-9951-8651-8-0



9 789951 865180